- Zhvillimi i aftësive të reja dhe vlerësimi i punës së punëtorëve luajnë një rol të rëndësishëm në rritjen e performancës në punë.
- Krijimi i një ambienti motivues ku ofrohen kushte të mira në punë dhe punëtorët ndjejnë se puna e tyre është tërheqëse, interesante dhe sfiduese, rezulton me rritjen e kënaqësisë së punëtorëve në punë.

8. Referencat

1. Armstrong, Michael, "A Handbook of Human Resource Management Practice", Kogan Page Ltd, London and Philadelphia, 2006
2. Kasimati, K. & Manxhari, M., "Sjellje Organizative", Ilar, Tiranë, 2005
3. Kondalkar, V., "Organizational Behavior", New Age International(P)Ltd., Publishers, New Delhi, 2007
4. Kreitner, R. & Kinicki, A. "Sjellja Organizative", Marin Barleti, Tiranë, 2002
5. Laci, Shyri. "Menaxhimi", Albpaper, Tiranë, 2006
6. Nail, Thomas, "The John Adair Handbook of Management and Leadership", Thorogood Publishing Ltd., London, 2004
7. Nail, Thomas, "Adair on Teambuilding and Motivation" Thorogood Publishing Ltd., London, 2004
8. Ramosaj, Berim, "Menaxhmenti Kreativ dhe Liderhipi", Varta, Prishtinë, 2006

KUD 005

NAGRAĐIVANJE MENADŽERA

Anita Cucovic

Abstrakt

Posmatrajući savremene organizacije i uslove u kojima one posluju može se zapaziti da su najvažniji resurs organizacija ljudi sa svojim sposobnostima. To organizacijama omogućava uspješno ostvarivanje ciljeva. Govoreći o tim sposobnostima misli se na informisanost, inovativnost, kreativnost, što u stvari predstavlja karakteristike koje ih izdvajaju od drugih resursa u organizaciji. Usled toga se može reći da zaposleni predstavljaju najvažniji resurs u kreiranju dodatne vrijednosti preduzeća. Zato je potrebno voditi računa o stimulisanju kadrova, a prvenstveno menadžera koji su organizatori cjelokupne aktivnosti u organizacijama. Motivisani menadžer će definitivno uticati na prenošenje uticaja na svoje podređene i bolje će razumijevati njihove potrebe, bolje će ostvarivati ciljeve jer je tendencija da se postigne da menadžeri, kao i zaposleni, posmatraju ciljeve preduzeća kao svoje sopstvene.

Ključne riječi: Menadzment, nagrađivanje, beneficije, motivacija

Jel klasifikacija: J24, M11, M14, O15, E24

UVOD

Menadžment je proces oblikovanja i održavanja okruženja u kojemu pojedinci, radeći zajedno u skupinama ostvaruju odabrane ciljeve. To je zapravo proces postizanja željenih rezultata kroz efikasno korišćenje ljudskih i materijalnih resursa. Svakodnevno je suočen s brzim promjenama, kako unutrašnjim tako i spoljašnjim. U sklopu menadžmenta potrebno je voditi računa o spoljašnjem i unutrašnjem okruženju preduzeća. Spoljašnje okruženje predstavlja prilike i prijetnje za preduzeće, a unutrašnje okruženje slabosti i snage.

Menadžeri su ljudi koji rade na ključnim upravljačkim i izvršnim položajima u privatnim i državnim proizvodnim i uslužnim poduzećima. Oni u njima kreiraju i sprovode poslovnu politiku. Po pravilu su rukovodioci vitalnih službi preduzeća, u koje se ubrajaju proizvodnja, prodaja i nabavka, služba računovodstva i finansija, kadrovska služba, kao i služba istraživanja i razvoja.

=====

Menadžeri organizuju i koordiniraju izvršenje radnih zadataka, nadgledaju njihovo sprovođenje i motivišu zaposlene. Tim aktivnostima oni nastoje da udovolje ciljevima organizacije: održavanje i povećavanje proizvodnje i dobiti, zadovoljstvo promjenljive i sve specifičnije potrebe kupaca, uvođenje tehnoloških promjena u radni proces. Zbog organizacije izvršenja radnih zadataka menadžeri planiraju rad službi kojima upravljaju u skladu s definisanom strategijom poslovanja. Predlažu godišnje i mjesečne planove rada u kojima predviđaju potrebne aktivnosti i resurse.

Ipak, potrebno je znati da bi se ostvarili rezultati menadžera, da bi menadžeri djelovali što više u cilju ostvarenja ciljeva organizacije, potrebni su određeni stimulansi koji se mogu razlikovati po svojoj prirodi ispoljavanja.

1. POJAM MENADŽMENTA

Menadžment predstavlja univerzalno sredstvo, neophodno oruđe savremenog industrijskog svijeta. Svako preduzeće, svaki iole složeniji posao, ili ozbiljna aktivnost, zahtijevaju upravljanje da bi se doveli do odabranog cilja, odnosno da bi se efikasno završili. Upravljanje je fenomen današnjeg vremena, neophodnost savremenog života i rada. Upravljački pristup rješavanju raznovrsnih problema, osnovna je karakteristika modernog menadžmenta, bez koga je nemoguće efikasnije djelovanje, funkcionisanje i razvoj.

Menadžment treba posmatrati sa tri aspekta:

- **I aspekt** kaže da je menadžment proces usmjeravanja rada ljudi ka nekom cilju;
- **II aspekt** govori o menadžmentu kao zanimanju, odnosno o menadžerima koji se bave usmjeravanjem drugih ljudi;
- **III aspekt** se bavi menadžmentom kao naučnom disciplinom, odnosno teorijom i praksom.

Različiti autori su različito definisali menadžment. Evo neke od tih definicija:

W. J. Duncan – ”Menadžment je umjetnost koja se mora razvijati i usavršavati- on je fundamentalno važan za uspjeh svih vrsta organizacije i društva u cijelini”.

J. Stoner – ”Menadžment je proces planiranja, organizovanja, vođenja i kontrole rada članova organizacije i korišćenja svih raspoloživih resursa u postizanju ciljeva organizacije”.

P. Drucker – ”Menadžment je priča dvadesetog stoljeća. Menadžeri su sintisajzer koji povezuje resurse i imaju sposobnost da osjete šansu i vrijeme za njenu realizaciju”. On još kaže ”Mi danas znamo da menadžment predstavlja generičku funkciju svih organizacija bez obzira na to čime se konkretno bave. Menadžment je generički organ društva znanja”.¹³

Na osnovu navedenih definicija, mogu se izvući neke osnovne odrednice pojma menadžmenta¹⁴:

- Menadžment je usmjeren na postizanje željenih ciljeva,
- Ostvarivanje željenih ciljeva počiva na ljudskom resursu u organizaciji, tj.odnosi se na rad sa ljudima, s tim što su ljudi takođe nosioci procesa menadžmenta,
- Menadžment je proces,
- Menadžment prožima svaku poru u organizaciji,
- Menadžment je odgovoran za efikasnost i efektivnost organizacije,
- Prisutan je kako u profitnim, tako i u neprofitnim organizacijama,
- Radi se o svojevrsnoj tehnologiji raspolaganja ograničenim

2. POJAM MENADŽERA

Potreba za menadžmentom se javlja uvijek kada postoji određeni zadatak koji bi svojom kompleksnošću mogao da prevaziđe mogućnosti pojedinca. Nalazeći se u fizičkoj blizini drugih ljudi, čovjek djeluje sa njima u poznatom prirodnom jedinstvu. Pored toga, čovjek u procesu izvršavanja zadatka svjesno nastoji da se udruži sa drugim ljudima. Udružen sa drugim ljudima u organizaciji, on povećava svoje sposobnosti i lakše zadovoljava sopstvene potrebe.

Čovjek ima usađen smisao za organizovanu djelatnost. Ta organizovana djelatnost je utemeljena na mišljenju. Ono što postoji izvan ljudskog roda samo kao rezultat prirodnih dispozicija. Da bi sa najmanje utrošenog vremena i energije ostvario postavljeni cilj, čovjek razmišlja, kombinuje i kreira. Ipak, sve te aktivnosti ne može da obavi sam. Mora postojati organizacija. Ljudi ulaze u organizaciju zbog ostvarivanja sopstvenih ciljeva. Da bi u tome uspjeli, odnosno da bi se njihovo djelovanje uskladilo i organizacija imala neku svoju svrhu, potrebni su ljudi određenih specijalnosti i zanimanja. Ta grupa ljudi u organizaciji predstavlja menadžere. Sledeća slika prikazuje uslovljenost ljudi, organizacije i menadžmenta, koji funkcionisanje organizacije usmjeravaju u skladu sa potrebama njenih članova.

¹³ Lojpur A., Kuljak M, *Menadžment*, Ekonomski fakultet u Podgorici, Podgorica, 2003., str. 7.

¹⁴ Ibid., str.5

Menadžeri su jedan od osnovnih faktora u organizaciji. Saznanje da je profit važan, isto tako kao i čovjek, smijenilo je novije prilagođeno saznanje, koje proizilazi od toga da je čovjek važan isto kao i profit. U tom smislu, problem menadžmenta je trajno aktuelan, kako u nerazvijenim privredama, tako i u razvijenim.

Menadžeri su osobe koje su zadužene za efikasno i efektivno odvijanje biznisa. Oni svoj posao obavljaju tako što nadgledaju i koordiniraju rad drugih osoba u organizaciji. Menadžerska grupa u firmi se najčešće naziva menadžment. Menadžeri u svojoj organizaciji usmjeravaju svoje napore prema zajedničkim, poželjnim ciljevima, ali i preko aktivnosti drugih. Ponekad se vlasnici firme, posebno malih firmi, nalaze u ulozi menadžera. U velikim kompanijama menadžeri su plaćene osobe koje mogu da budu njeni akcionari. Menadžeri su odgovorni za racionalno raspolaganje resursima firme i resursima cijelog društva.

3. MATERIJALNE KOMPENZACIJE I STIMULACIJE

Cilj materijalnih kompenzacija i stimulacija je usmjeren ka osiguranju i unapređenju materijalnog položaja zaposlenog, ali to podrazumijeva i finansijske kompenzacije za rad. Prema jednoj klasifikaciji, one se mogu analizirati ili posmatrati kroz dvije dimenzije:

- Stepenn direktnosti materijalnih dobiti, odnosno relacije pojedinac – materijalna dobit
- Uloge individualnog rada i ponašanja u njihovom ostvarivanju , odnosno nivo i obuhvatnost organizovanja i distribucije.¹⁵

Direktni dobici koji su materijalne prirode, ili kako ih zovu – finansijski dobici, odnose se na dobitke *u novcu* putem plate, kao što je sistem plata i nekih drugih materijalnih podsticaja, tj. „bonusa vezanih s grupnim ili individualnim radom, koji se, i iz individualnog i iz organizacionog aspekta percipiraju kao direktne nagrade za rad.“¹⁶

Prema drugom aspektu posmatranja materijalnih kompenzacija jeste nivo i obuhvat organizacije i distribucije u preduzeću. Ovdje se razlikuju dvije vrste:

- Materijalne nagrade koje su posledica individualne radne uspješnosti
- Materijalne nagrade vezane za organizacioni nivo „koje se distribuiraju na osnovu organizacionih programa ili politika te uspješnosti u postizanju ciljeva.“¹⁷

Tabela br. 1: Klasifikacija materijalnih kompenzacija zaposlenih

¹⁵ Sikavice P., *Temelji menadžmenta*, Školska knjiga, Zagreb, 2007, str. 710.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Ibid., Cf. Bahtijarević Š.F., *Menadžment ljudskih resursa*, Golden marketing, Zagreb, 1999, str. 614.

		DIREKTNE MATERIJALNE KOMPENZACIJE	INDIREKTNE MATERIJALNE KOMPENZACIJE
NIVO	POJEDINAC	- Plata - Bonusi i podsticaji - Naknade za inovacije - Naknade za širenje znanja i fleksibilnost - Ostali podsticaji (bonusi)	- Stipendije i školarine - Studijska putovanja - Specijalizacije - Plaćena odsustva i slobodni dani - Automobil kompanije - Menadžerske beneficije
	PREDUZEĆE	- Bonusi vezani uz rezultate i dobitak organizacione jedinice ili preduzeća - Udio u profitu - Udio u vlasništvu (distribucija akcija)	- Penzijsko osiguranje - Zdravstvena zaštita - Životno i druga osiguranja - Naknade za nezaposlenost - Obrazovanje - Godišnji odmori - Briga o djeci i starima

Izvor: Bahtijarević Š.F., *Menadžment ljudskih resursa*, Golden marketing, Zagreb, 2007, str. 615.

3.1.INDIREKTNE MATERIJALNE KOMPENZACIJE

Beneficije predstavljaju različite oblike kompenzacija koji mogu na različite načine uticati na ekonomski standard tokom rada i po završetku radnog odnosa i vijeka. Za njih se mogu vezati dvije specifične odrednice:

- Pravo na njih je proisteklo iz činjenice da neko pripada određenoj organizaciji
- Po pravilu za njih nije karakteristično percipiranje finansijskim stimulacijama koje su vezane uz rad.¹⁸

Tabela br. 2: Vrste beneficija – indirektnih kompenzacija u organizacijama

¹⁸ Cf. ibid., str. 713.

VRSTE BENEFICIJA		
Beneficije sigurnosti i zdravlja	Beneficije slobodnog vremena	Usluge zaposlenima
- Penzijsko osiguranje - Zdravstveno osiguranje - Životno osiguranje - Osiguranje i naknade u slučaju profesionalnih oboljenja, nesreća i sl. - Bolovanja, - Socijalna sigurnost - Osiguranje i naknade u slučaju nezaposlenostiž - Otpremnine i dr.	- Odmori - Praznici - Opravdani izostanci - Plaćeni dopusti - Žalbeni postupci i pregovaranje - Plaćeno vrijeme tokom stručnog usavršavanja i obrazovanja i dr.	- Pomoć i stipendije za školovanje - Krediti zaposlenima - Usluge prehrane - Automobil kompanije - Profesionalna odjeća - Pravne usluge - Programi štednje - Prevoz i parkiranje - Različite nagrade za službu, staž i sl. - Programi rekreacije i zdravlja - Socijalne aktivnosti - Troškovi preseljenja i transfera - Diskontna kupovina proizvoda organizacije - Prodaja otpisane opreme - Bonusi i pokloni za praznike - Savjetovanje i različite stručne usluge - Neplaćena odsustvovanja zbog porodičnih razloga i dr.

Izvor: Sikavice P., et.ali, Temelji menadžmenta, Mate, Zagreb, 2007, str. 710.

3.2.STIMULATIVNI SISTEM NAGRAĐIVANJA

U okviru stimulativnog sistema nagrađivaja finansijska kompenzacija (gdje se misli na ukupna materijalna primanja) koje dobija pojedinac po pravilu bi trebala biti sastavljena iz četiri dijela:

1. *Prvi dio finansijske kompenzacije*

Ovaj dio je vezan za posao koji pojedinac obavlja. U smislu veličine je isti kao i za sve one koji su vezani za izvršavanje datog posla, a po pravilu, on je određen i kolektivnim ugovorom.

2. *Drugi dio finansijske kompenzacije*

Ovaj dio je promjenljiv i povezan sa individualnom ili grupnom uspješnošću.

3. *Treći dio finansijske kompenzacije*

Ovaj dio sačinjavaju posebne, dodatne individualne nagrade i bonusi.

4. *Četvrti dio finansijske kompenzacije*

Riječ je takođe o promjenljivom vidu kompenzacije, koji je povezan sa uspješnošću organizacione jedinice i organizacije, a dobijaju ga zaposleni i menadžeri prema unaprijed određenim kriterijumima.

Da bi materijalne nagrade bile u funkciji povećanja radnog učinka one bi morale biti povezane sa onim pokazateljima radne uspješnosti na koje bi menadžer mogao uticati svojim ponašanjem.

Potrebno je da postoji jasna veza između rezultata rada i nagrade. „Rad se mora percipirati kao instrument za povećanje plate i uopšte ostvarivanje individualnih ciljeva (razvoja, napredovanja, statusa i tako dalje.)“¹⁹

Sistem nagrađivanja bi trebao biti zasnovan više na pozitivnim konsekvencama, a ne na negativnim konsekvencama radnog ponašanja.

¹⁹ Ibid, str. 714.

3.2.1.UTVRĐIVANJE INDIVIDUALNIH PLATA

U cjelokupnom sistemu materijalnog nagrađivanja utvrđivaje osnovne plate svakog pojedinca predstavlja veoma važan korak i „ishodište cjelokupne nadgradnje podsticanja dobrog rada“.²⁰ Potrebno je kvalitetno odgovoriti na pitanje koliko posao koji pojedinac u organizaciji obavlja vrijedi za organizaciju i koliko donosi novca. Kao uobičajeni način pomoću koga se daje odgovor na ovo pitanje je procjena posla.

3.2.1.1.PROCJENA POSLA

Procjena posla predstavlja postupak kojim „se utvrđuje relativna vrijednost različiti poslova unutar neke organizaci ejako bi se utvrdila struktura plata i razlike u osnovnoj plati za poslove različitih zahtjeva i složenosti.“²¹

Procjena posla podrazumijeva sljedeće ciljeve:

- Utvrditi strukturu plata
- Osigurati svaku „horizontalnu ili vertikalnu unutrašnju nejednakost u plaćanju istih poslova.“²²
- Omogućiti upoređivanje visine plata za različite poslove, funkcije i jedinice unutar organizacije
- Identifikovati zadatke , vještine i odgovornosti povezane sa svakim poslom
- Osigurati metodu za uspostavljanje visine plate za nove poslove i vještine i redizajnirane poslove unutar organizacione strukture.

²⁰ Ibid, str. 716,

²¹ Bahtijarević Š.F., *Menadžment ljudskih resursa*, Golden marketing, Zagreb, 2007, str. 619.

²² Ibid., str. 619.

ZAKLJUČAK

Menadžment se može posmatrati sa 3 aspekta. Prema prvom aspektu riječ je o procesu usmjeravanja rada ljudi ka nekom cilju; prema drugom – menadžment je zanimanje, gdje se menadžeri bave usmjeravanjem drugih ljudi. Treći aspekt podrazumijeva proces menadžmenta shvaćen kao teorija i kao praksa. Potreba za menadžmentom se javlja uvijek kada postoji određeni zadatak koji bi svojom kompleksnošću mogao da prevaziđe mogućnosti pojedinca. Nalazeći se u fizičkoj blizini drugih ljudi, čovjek djeluje sa njima u poznatom prirodnom jedinstvu. Pored toga, čovjek u procesu izvršavanja zadatka svjesno nastoji da se udruži sa drugim ljudima. Udružen sa drugim ljudima u organizaciji, on povećava svoje sposobnosti i lakše zadovoljava sopstvene potrebe. Menadžeri su jedan od osnovnih faktora u organizaciji. Saznanje da je profit važan, isto tako kao i čovjek, smijenilo je novije prilagođeno saznanje, koje proizilazi od toga da je čovjek važan isto kao i profit.

Nagrađivanje menadžera, ali i zaposlenih uopšte je proces koji je direktno usmjeren na zadovoljenje potreba prvo svojih zaposlenih, kako bi se stekle pretpostavke za zadovoljenje potreba potrošača. Cilj materijalnih kompenzacija i stimulacija je usmjeren ka osiguranju i unapređenju materijalnog položaja zaposlenog, ali to podrazumijeva i finansijske kompenzacije za rad. Prema jednoj klasifikaciji, one se mogu analizirati ili posmatrati kroz dvije dimenzije i to kroz: stepen direktnosti materijalnih dobiti, odnosno relacije pojedinac – materijalna dobit i uloge individualnog rada i ponašanja u njihovom ostvarivanju, odnosno nivo i obuhvatnost organizovanja i distribucije.

Direktni dobici koji su materijalne prirode, ili kako ih zovu – finansijski dobici, odnose se na dobitke *u novcu* putem plate, kao što je sistem plata i nekih drugih materijalnih podsticaja, organizacije i distribucije u preduzeću. Ovdje se razlikuju dvije vrste: materijalne nagrade koje su posledica individualne radne uspješnosti i materijalne nagrade vezane za organizacioni nivo

koje mogu biti distribuirane na osnovu organizacionih programa i politika kao i uspješnosti u ostvarivanju ciljeva. Njima su svojstvene dvije odrednice a to je da je: pravo na njih je proisteklo iz činjenice da neko pripada određenoj organizaciji i, po pravilu, njima nije svojstveno percipiranje finansijskim stimulacijama koje su vezane uz rad.

Da bi materijalne nagrade bile u funkciji povećanja radnog učinka one bi morale biti povezane sa onim pokazateljima radne uspješnosti na koje bi menadžer mogao uticati svojim ponašanjem. Potrebno je da postoji jasna veza između rezultata rada i nagrade. Rad mora da ima ulogu instrumenta koji ima značaja za povećanje plate, ali i ostvarivanja ostalih ciljeva koji su usmjereni na napredovanje.

U cjelokupnom sistemu materijalnog nagrađivanja utvrđivaje osnovne plate svakog pojedinca predstavlja veoma važan korak i ishodište cjelokupne nadgradnje podsticanja dobrog rada. Potrebno je kvalitetno odgovoriti na pitanje

koliko posao koji pojedinac u organizaciji obavlja vrijedi za organizaciju i koliko donosi novca. Kao uobičajeni način pomoću koga se daje odgovor na ovo pitanje je procjena posla.

LITERATURA

1. Bahtijarević Šiber Fikreta, *Menadžment ljudskih resursa*, Golden marketing, Zagreb, 1999.
2. Sikavice Pere i drugi, *Temelji menadžmenta*, Školska knjiga, Zagreb, 2008.
3. Ristić Žarko, *Menadžment ljudskih resursa*, Ekonomski fakultet Univerziteta u Beogradu, Beograd, 1998.
4. Lojpur A., Kuljak M, *Menadžment*, Ekonomski fakultet u Podgorici, Podgorica, 2003.

KUD 338(496.51)

ORIENTIMET GLOBALE STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT EKONOMIK NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

*M.sc. Ariana Xhemajli
arianaxhemajli@gmail.com*

Abstrakt

Në bazë të praktikave të vendeve tjera të cilat kanë kaluar në periudhën e tranzicionit, problemi kyç i këtij procesi ishte dukuria e korrupsionit, varfërisë dhe efekteve negative të globalizimit. Në këtë punim synojmë që të analizojmë orientimin global strategjik në zhvillimin e ekonomisë së Kosovës në periudhën e tranzicionit, me qëllim të zvogëlimit të normës së papunësisë, varfërisë dhe anëtarësimin më të shpejtë të Kosovës në UE. Qëllimi i këtij punimi do të jetë një kontribut sa do i vogël që të plotësojë një mungesë të madhe të studimeve që trajtojnë aspektet ekonomike dhe sociale në Kosovë. Zhvillimi i ekonomisë së hapur të tregut e të strukturave demokratike të shoqërisë në Kosovë konsiderohet si domosdoshmëri për stimulimin e aktiviteteve ekonomike. Projekti synon të përmirësojë nivelin e informimit të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për aspektet ekonomike të problemit të Kosovës, të cilat janë shumë të rëndësishme, por nga ana tjetër, shpeshherë të marginalizuara.

Fjalët kyçe: globalizimi, zhvillimi ekonomik, privatizim

JEL klasifikimi: M3, M37

Hyrja

Kosova, si një vend i vogël dhe ballkanik, duhet të orientohej për ndërtimin e sistemit të ekonomisë sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe botëror, politikë të matur, rregullativ dhe liberalizim ekonomik. Ky sistem ekonomik është një sistem që krijon një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë së Kosovës në rajon e më gjerë, stimulimin e bashkëpunimit ekonomik dhe që nxitë investimet e përbashkëta me partnerët e jashtëm. Lidhur me këtë nevojitet strategjia e përkufizuar qartë e transformimit të pronës shtetërore (shoqërore) në pronë private dhe për zhvillimin e ndërmarrësisë si filozofi zhvillimore me tërë infrastrukturën e saj të nevojshme. Kjo mundëson krijimin e një ambienti të volitshëm për zhvillimin e konkurrencës dhe të autonomisë së ndërmarrjeve, duke përfshirë kategorinë e rrezikut. Kjo kërkon ndërtimin e tregut integral (tregu i mallrave dhe shërbimeve, tregu i punës dhe tregu financiar), me gjithë institucionet e tij.

=====

Roli i shtetit duhet të përqendrohet në rregullimin bashkëkohor makro-ekonomik që siguron stabilitet ekonomik dhe ndertim të politikës zhvillimore. Këtu përfshihet: rregullimi i marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, ndertim i politikës regionale, ndertim i politikës agrare, asaj ekologjike dhe financat publike. Shteti duhet t'i marrë mbi vete edhe funksionet e domosdoshme sociale, me qëllim që më lehtë të tejkalohen pasojat negative në këtë fazë të tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Sistemi ekonomik funksionimin e vetë duhet ta mbështesë në institucionet demokratike, demokracinë liberale e shoqërinë e hapur, si dhe në internacionalizimin e ekonomisë dhe të shoqërisë kosovare

Tranzicioni është proces transformues i përmasave të thella të një sistemi shoqëror, nëpërmjet të cilit ky sistem kalon në një strukturë të re, e cila siguron një efikasitet dhe efektivitet më të lartë. Për të arritur këto performansa, duhet ndërtuar ndryshime simultane në të gjitha nënsistemet e sistemit shoqëror, e para së gjithash në sistemin politik, në sistemin ekonomik dhe në sistemin arsimor.

Tranzicioni nuk mund të jetë proces që qeveriset nga rasti në rast, aq më pak në mënyrë stihike. Kjo do të thotë se nevojitet ndërtimi i strategjisë së tranzicionit, i cili në vete përmban qëllimet e shtrua qartë, pengesat në të cilat mund të ndeshë realizimi i këtyre qëllimeve dhe resurset e mekanizmat me të cilat duhet tejkaluar këto pengesa. Kjo do të thotë gjetja e optimumit, duke patur parasysh oportunitetin politik, oportunitetin ekonomik dhe oportunitetin social. Përvoja e zhvillimit të tranzicionit në vendet ish socialiste dëshmon se mungesa e kësaj strategjie dhe këtij optimumi e forcon rezistencën ndaj ndryshimeve dhe ushqen inercionin më të fuqishëm të elementeve të sistemit të vjetër.

Ekonomia e Kosovës

²³Përkufizimi konvencionale të globalizimit nënkupton procesin e krijimit dhe liberalizimit të tregjeve kombëtare financiare dhe shkrirjen e tyre në tregun e kapitalit global. Të gjitha shoqëritë e organizuara janë të preokupuara me startin e tyre në mileniumin e ri. Janë të shqetësuara me faktin se sa do të jenë në gjendje të inkuadrohen në ndryshimet dramatike që po i sjell shoqëria pasindustriale, përkatësisht ajo informatike.

Prandaj, përkundër situatës në tranzicion në të cilën ndodhet Kosova, nuk guxojmë të mos e shtrojmë pyetjen dhe të përpiqemi të kërkojmë përgjigje mbi atë se ku ndodhemi dhe çka na pret?

Ekonomia e Kosovës starton në etapën e re, pas një periudhe të gjatë rënije drastike të aktivitetit ekonomik, me ngecjen e madhe teknologjike të kapaciteteve industriale, si mungesë e investimeve për disa vite, me rënien e potencialeve prodhuese në sektorin shtetëror e publik. Nevoja e një programi rehabilitimi dhe ristrukturimi të ekonomisë është shumë e evidente. Tri punkte të

²³ J. Lončar: Globalizacija – pojam, nastanak i trendovi razvoja Geoadria, 10/1, 91-104, 2005.

rëndësishme të industrisë megjithatë do ta kenë perspektivën edhe në kushtet e reja: Elektroenergji, Trepça dhe Feronikeli, pas konsolidimit, të luajnë rolin e forcave të zhvillimit ekonomik. Degët e tjera kanë nevojë për një regjenerim kompleks teknologjik, i cili duhet të realizohet krahas privatizimit dhe nëpërmjet investimeve të përbashkëta. Burimet e mëdha të rritjes janë edhe në bujqësi dhe në sektorin e veprimtarive tregëtare dhe shërbyese.

Faktor i rëndësishëm ekonomik është edhe diaspora. Infrastruktura energjetike dhe ajo e trafikut përbëjnë vetëm bazën fillestare për të zënë hapin e zhvillimit, por ato duhet të zgjerohen e modernizohen krahas zhvillimit ekonomik. Infostruktura (infrastruktura informatike) duhet të krijohet me përparësi.

Resurset e disponueshme: pasuritë natyrore, humane, kapacitetet ekzistuese, janë rrethanë pozitive e zhvillimit.

- Disa kapacitete të industrisë bazike, energjetika, nikli, metalet e ngjyrosura, në kushtet e zhvillimit të pavarur, mund të tejkalojnë pozitën e deprimuar në politikën e çmimeve në tregun e brendshëm dhe pengesat për eksport, që ishin ndër pengesat më serioze në zhvillimin e tyre. Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre kapaciteteve duhet të bëhet në formë të investimeve të përbashkëta.
- Resurset natyrore duhet të orientohen veçmas në zhvillimin e agrobiznesit dhe turizmit;
- Fondi i resurseve humane – popullsia e re, mund të jetë faktor shumë pozitiv i zhvillimit nëse aftësohet për tëu inkuadruar në rrjedhat e revolucionit informatik.

Qëllimet strategjike

Globalizimi mund të argumentohet se një pasojë e zhvillimit të shkencës, teknologjisë moderne, ekonomisë së tregut e demokracisë. Globalizimi i ka mundësuar lëvizjen e lirë e kapitalit, mallrave, informacionit dhe të njerëzve nëpërmjet zgjerimit dhe heqjen e kufijve.²⁴

Duke u nisur nga rrethanat aktuale dhe ato të pritura, nga niveli i zhvillimit, problemet sociale-ekonomike dhe trendet e pritura të zhvillimit në Evropë dhe në botë, qëllime strategjike të zhvillimit të Kosovës në dekadën e ardhshme do të ishin:

- zhvillimi i pavarur ekonomik brenda integriteteve ekonomike rajonale, evropiane e më gjerë;
- aktivizimi maksimal ekonomik i popullsisë së aftë për punë nëpërmjet zhvillimit dinamik;
- mobilizimi i potencialeve zhvillimore natyrore, humane dhe financiare të popullsisë nëpërmjet sistemit të ekonomisë së hapur të tregut dhe ndërmarrësisë si filozofi bazike e zhvillimit;

²⁴ J. Lončar: Globalizacija – pojam, nastanak i trendovi razvoja Geoadria, 10/1, 91-104, 2005.

- inkuadrimi në rrjedhat e zhvillimeve teknologjike, informatike dhe telekomunikimit e globalizimit.

Pavarësia dhe integrimet rajonale

Pavarësia ekonomike e Kosovës është kusht për zhvillimin ekonomik të Kosovës. Ajo krijon kushte për integritime brendakombëtare, rajonale dhe më gjerë. Pavarësia dhe integrimet janë procese komplementare në frymën e proceseve aktuale që zhvillohen në botë. Pavarësia ekonomike e Kosovës mund të mbështetet në potencialet njerëzore, pasuritë natyrore, infrastrukturën dhe vlerat e krijuara më parë. Bilancet e bëra dhe projeksionet e zhvillimit të pritur dokumentojnë se, në kuadër të një ekonomie të hapur dhe një shoqërie civile e demokratike, Kosova mund ta buxhetojë pavarësinë e saj ekonomike.

Konkurrenca dhe të punësimi si një objektiv mund të realizohen nëpërmjet dhjetra fondeve për zhvillim rajonal, dhe përfshijnë: rritjen e konkurrencës dhe punësimin, duke rritur atraktivitetin rajonal, parashikimet ekonomike dhe ndryshim social në veçanti ato që lidhen me procesin e globalizimit dhe regjionalizimit, promovimin e burimeve njerëzore, mjedis, njohuri, infrastruktura dhe tregu fleksibil²⁵

Inkuadrimi në revolucionin informatik dhe globalizim

Kosova nuk mund të presë që të arrijë një stad të caktuar zhvillimi për t'u inkuadruar menjëherë në revolucionin informatik, i cili po shprehet me digjitalizmin e ekonomisë dhe aktivitete të tjera të njeriut, të bazuara në zhvillimin e fuqishëm të telekomunikimeve. Resurset humane, me të cilat Kosova ka përparësi zhvillimore, do të mund të jenë në funksion të zhvillimit bashkëkohor vetëm nëse arrijnë arsimimin informatik (alfabetizmi kompjuterik), aftësohen për ta përdorur teknologjinë informatike dhe për të marrë pjesë në zhvillimet e saj të ardhshme. Për këtë nevojiten transformime të thella në sistemin e edukimit dhe të arsimimit.

Faktorët që ndikojnë në rritjen ekonomike

Parakusht të realizimit të qëllimeve strategjike të zhvillimit të Kosovës janë:

- Sistemi i ekonomisë së hapur të tregut
- Zhvillimi i ndërmarrësisë dhe NVM
- Konsolidimi, ristrukturimi dhe vazhdimi i privatizimit i ekonomisë ekzistuese

Ndërtimi i sistemit të ekonomisë së hapur të tregut është parakusht për inkuadrim në rrjedhat e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në proceset e globalizimit. Ai është parakusht i domosdoshëm për zhvillimin e marrëdhënieve me integritet ekonomike, me vendet me ekonomi të zhvilluar, me institucionet financiare ndërkombëtare dhe parakusht për mobilizimin e resurseve financiare të popullsisë dhe diasporës. Kjo nënkupton sistemin efikas ekonomik, mbrojtjen

²⁵ Strategjia razvoja Tuzlanskog kantona 2008 – 2013 Sarajevo, decembar 2008

e pronës, respektimin e rregullave të tregut dhe barazinë e subjekteve ekonomike – veprimin efikas të shtetit ligjor. Bazat institucionale të këtij sistemi janë trajtuar në kapitullin e mëparshëm. Ndërtimi i sistemit të ekonomisë së hapur në Kosovë është domosdoshmëri, sepse çfarëdo autarkizmi do të ishte fatal për cilësinë e zhvillimit të Kosovës. Kosova si vend i vogël dhe ekonomikisht i pazhvilluar është e detyruar të orientohej në ekonominë e hapur.

Karakteristikat e ekonomisë së hapur janë:

- liberalizimi i çmimeve
- liberalizmi në tregtinë e jashtme (regjimet e këmbimit),
- liberalizmi i tregut financiar (kursi real dhe kamata reale, formimi i tyre në treg),
- liberalizimi i tregut të punës.

Thelbi i kësaj ekonomie qendron në stabilitetin ekonomik i cili në masë të madhe kushtëzohet nga bilanci i pagesave, që do të jetë problem i vështirë për Kosovën, andaj edhe do të shqyrtohet më detalisht në vijim.

Strategjia e zhvillimit të NVM duhet të krijojë një arsenal masash dhe instrumentesh për nxitjen e zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që kanë rritje të shpejtë dhe koncept ofensiv të zhvillimit. Gjithashtu, aktivitete dhe masa specifike mund të merren për sektore të caktuara: agrobiznesi, shërbimet informatike, programet prodhuese, biznesi i fermave, shërbimet e konsaltingut dhe edukimit për biznes.

Ekspertet nderkombetare dhe shqiptare në këto momente janë duke analizuar faktorët pengues të një rritjeje më të shpejtë të ekonomisë shqiptare dhe sidomos faktorët potenciale, të cilët janë në nivele të pazhvilluara dhe kanë në vetvete rezervë të mëdha për të rritur ritmet e rritjes së ekonomisë shqiptare.

Kjo analizë është shumë dimensionale. Ajo bazohet në rëndësinë që kanë faktorët ndryshëm, siç janë edukimi, energjia, telekomunikacioni, por sidomos mireqeverisja, ku pronesia, funksionimi i shtetit ligjor, lufta kundër korrupsionit dhe efica e enteve rregullatore e mbikqyrëse konsiderohen të rëndësishme për të ushqyer ritmet e larta të rritjes.

Mireqeverisja, reduktimi i barrierave të biznesit, profesionalizmi dhe modernizimi i administratës publike, rritja e tregtisë rajonale, eliminimi i barrierave jo vetëm doganore, krijimi i tregut unik rajonal dhe levizja e lire, konsiderohen të rëndësishme për të rritur thithjen e investimeve të huaja, për të rritur tregtinë rajonale e globale, të cilat sëbashku mbështesin me mirë rritjen ekonomike.

Rritja e performancës eksportuese të ekonomisë sone, apo një ekonomi e orientuar nga eksporti, konsiderohen të detyrueshme në sfidat për qendrueshmërinë e rritjes të lartë ekonomike. Ka një korelacion të fortë pozitiv midis thithjes së investimeve të huaja dhe rritjes së aftësisë eksportuese të ekonomive tona.²⁶

²⁶ Arben MALAJ, Midis rritjes reale dhe nominale të ekonomisë, “Gazeta Start”

=====

Zbatimi i programit të rikonstruktimit dhe regjenerimeve teknologjike e organizative në sektorët e përmendur, brenda një periudhe 2-3 vjeçare (pas normalizimit të gjendjes), mund të ndikojë në konsolidimin e përgjithshëm ekonomik. Kjo gjithashtu mund të konsolidojë edhe rrjedhat e eksportit. Konsolidimi i infrastrukturës ekonomike ka të bëjë me nevojën e rehabilitimit të rrjetit të rrugëve, rivitalizimit të disa drejtimeve më të rëndësishme. Elektrifikimi i hekurudhës gjithashtu shtrohet si nevojë e rëndësishme. Konsolidimi i dy hidrosistemeve (Ibër-Lepenc dhe Radoniq) duhet të zbusë problemin e ujit dhe të mundësojë rritjen e rendimenteve të prodhimit dhe të agrobiznesit.

Përfundimi

Nuk duhet të harrojmë të gjithë ne ekspertët e ekonomisë se rezultatet e para makroekonomike pas përfundimit të privatizimit mund të priten vetëm pas një periudhe 5-10 vjeçare. Deri atëherë, institucionet qeveritare dhe joqeveritare duke përfshirë të gjithë aktorët kontribuues në zhvillimin ekonomik, duhet të përpilojnë plane dhe hartojnë projekte në funksion të stimulimit dhe përkrahjes së iniciativës private që është në lindje e sipër. Vështruar nga prizmi i ekonomisë së tregut, me rëndësi kapitale është transformimi sa më i shpejtë i pronës shoqërore në atë private. Iniciativa private mbetet i vetmi gjenerator i pakontestueshëm i zhvillimit ekonomik në botën moderne të biznesit.

Do të ishte iluzion nëse themi se gjithçka vajti në rregull dhe se nuk kishte gabime. Me siguri se në procese të tilla komplekse gabime ka dhe se ato zbulohen vetëm me kalimin e kohës përmes kryerjes së punëve dhe detyrave. Tek e fundit, mësimi zë vend atëherë kur detektohen gabimet e së kaluarës dhe më pastaj ndërmerren masa për të përmirësuar sjelljet apo mënyrat e kryerjes së punëve.

Literatura

1. Francis F., "Pas fundit të historisë", 2006.
2. Hana L. & Telo I., Tranzicioni në Shqipëri – arritjet dhe sfidat, Tiranë 2005
3. Ilić G., Reforme Evropshke Unije – Institucionalni aspekti., Beograd 2004
4. Jovanović M., Evropshka Ekonomshka integracija, Beograd 2004
5. Limani M., Integritet ekonomike evropshane, Prishtinë 2004
6. Sadiku M., Tranzicioni dhe Reformat Institucionalne në Kosovë, Riinvest, Prishtinë 2007
7. Selmanaj S. Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat, Riinvest Prishtinë 2006
8. Selmanaj S. Sistemet ekonomike bashkëkohore, Prishtinë 2006
9. Selmanaj B., Globalizimi, Lubljanë 2006
10. Uvalic Milica, "Privatisation and Corporate Governance in Serbia (FRY)", dhjetor 2001;

11. World Bank, "World Development Report 2000/01: Attacking poverty", NY, 2001;
12. World Bank report, "Supporting the Economic Growth and Sustainable Development", in cooperation with Ministry of Agriculture and Food, Albania, November, 2002;

KUD 658

KONTRATA E FRANSORIZINGUT MUNDËSI ALTERNATIVE PËR RRITJE TË INVESTIMEVE

*Dr.sc. Armand Krasniqi, prof as.²⁷
mandikrasniqi@gmail.com*

Abstrakt

Punim trajton një rënë nga mundësitë e funksionimit të tregu ndërkombëtar dhe vendor në bazë të një sistemi kompleks rregullash juridike – kontraktuale specifike. Institucionet respektivisht mekanizmat ekonomikë dhe ligjorë që e rregullojnë këtë segment janë të ndërlidhura e ndërthurura ndërmjet vete sa që marrëdhëniet tregtare dhe biznesore sot karakterizohen për një shkallë të lartë aq sa nuk ka ekzistuar asnjëherë më parë. Dekadat e fundit kanë lindur dhe formësuar një seri kontratash të cilat, përveç që kryejnë funksionin instrumenteve juridike – ekonomike të komunikimit dhe zhvillimit të biznesit në mes të palëve, investimeve u kanë dhënë një dinamizëm dhe masivitet në të gjitha nivelet. Për shkak të rëndësisë që kanë këto kontrata, zbatimit të tyre dhe mundësive që ofrojnë ato në jetën e përditshme, qesin në pah nevojën e domosdoshme të njohjes të përmbajtjes dhe formës së tyre. Termi Franchizing (Franchising) ka shumë përkufizime dhe vlerësojmë se pothuajse çdo vend në botë për shkak të specifikave dhe zhvillimit ekonomik ka perceptimin e vet lidhur me përmbajtjen e asaj çfarë konsiderohet është franchizing. Ky punim pretendon që thjeshtë dhe saktë të ofrojë një tablo të plotë për franchizingun si njëra nga format e mundshme për depërtim në treg e cila gjithsesi duhet vlerësuar dhe mundësisht zbatuar për të qenë pjesë e mjedisit biznesor ndërkombëtar.

Fjalët kyçe: E drejtë kontraktore, investime alternative, Franchizing, privilegje, know – how,.

Hyrja

Zhvillimi i intensiv i teknikës, teknologjisë dhe i ekonomisë në mënyrë të detyrueshme është përcjell dhe determinuar edhe nga zhvillimi i instrumenteve e teknikave juridike roli i të cilave është që të mundësojë realizimin e papengueshëm dhe të sigurt të aktiviteteve biznesore. Pikërisht për shkak të këtij zhvillimi aktual i instituteve të së drejtës klasike nuk iu përgjigjen efektivisht këtyre nevojave. Praktika biznesore, në suaza të rendit ekzistues

²⁷ Autori është mësimpldhënës i lëndëve të te drejtës në biznesore dhe të drejtës biznesore ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë

juridik, tani më ka krijuar instrumente të reja juridike të cilat i përgjigjën situatës së sapokrijuar në qarkullimin e vlerave. Së këndejmi ka ardhur deri të krijimi i një serie kontratash të reja. Kjo duke u bazuar nga disa parime të përgjithshme dhe premisave të së drejtës detyrimore që janë valide për rregullimin e situatave deri tash jo ekzistuese të krijuar faktikisht në jetën praktike. Mbi këto koncepte dhe nevoja në mas të madhe fillojnë marrëdhëniet e reja kontraktore që në thelb dallohen nga të ashtuquajturat kontratat klasike të së drejtës civile. Këto kontrata ne përmbajtjen dhe qëllimin e tyre aq shumë diferencohen nga ato klasike sa tani më nuk mund të flitet për përkatësinë e tyre në kudër të njërit nga grupet ekzistuese të kontratave por kontrata të llojit të ri, të pavarur, *sui – generis*. Lëmenjtë e jetës ekonomike në kuadër të te cilave ka ardhur deri të krijimi i llojit të ri të kontratave, madje edhe instituteve dhe degëve të reja juridike, para së gjithash janë: ndërtimtaria investive, financimet, kreditimet, operimet, investimet e përbashkëta (në vend dhe jashtë) transporti, sigurimet, turizmi, hulumtimet, etj,. Në këtë mënyrë janë krijuar dhe aplikohen kontratat mbi inxhinieringun, faktoringun, franshizingun, lizingun, etj,. Këto kontrata janë kreacione moderne juridike të praktikës biznesore e cila ka dalë nga nevoja që zhvillimi ekonomik të formësohet – përformohet juridikisht. Elementet “ekonomike” dhe “juridike” këtu ndërthuren thellësisht duke e përcaktuar esencën e secilës punë kontraktore. Pasi që në praktikë ekziston një numër i madh i punëve kontraktuale, analogjikisht ekziston mundësia që nëpërmjet tyre të krijohen strategji alternative të sigurimit të investimeve të huaja në të gjitha lëmenjtë e jetë shoqërore – ekonomike.

Funksionimi i të drejtës kontraktore - kusht për zhvillimin e strategjive alternative të investimeve dhe të rritjeve ekonomike

Marrëdhëniet shoqërore – ekonomike specifike të cilat kanë ndikuar në krijimin dhe kodifikimin e së drejtës biznesore ndërkombëtare kanë kaluar nëpër një rrugë të gjatë. Në këtë pikëpamje procedurat konkrete për zyrtarizimin e kodifikimit dhe unifikimit kanë qenë mjaft të koklavitura e të ngadalshme sa që proceset ekonomike nuk kanë mundur të presin. Spontanisht, nëpërmjet të praktikës në sferën e biznesit ndërkombëtare, dokeve, rregullave të përgjithshme të afarizmit, kontratave tip dhe formular, gradualisht është krijuar një e drejtë profesionale të cilën nuk e ka krijuar shteti por organizatat e ndryshme biznesore. Nga praktikat biznesore ndërkombëtare në teorinë e të drejtës është emërtuar si e drejtë biznesore autonome ndërkombëtare. Unifikimi përmes kontratave ndërkombëtare, në mënyrë kronologjike ka ndikuar në procesin e unifikimit spontan. Mund të konstatohet se kodifikimi i të drejtës dhe rregullave materiale në lëmin e të drejtës kontraktore ndërkombëtare përveç qëllimeve kryesore të rregullimit raporteve specifike në këtë lëmi kanë krijuar edhe

mundësinë që vendete tranzicionit të shfrytëzojnë kontratat për të përmirësuar zhvillimin e vet ekonomik pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të shtetit.²⁸ Rasti me i besueshëm për rritje e operacioneve në kuadër të biznesit vendas dhe ndërkombëtar është edhe kontrata e franshizingut e cila u mundëson bizneseve vendase që të krijojnë lidhje partneriteti me ndërmarrje të njohura dhe sigurim të një pozite të volitshme në hapësira të caktuara.

Çka është franshizingu

Franshizingu është një sistemi veçantë dhe delikat i operimit biznesor në kuadër të tregut modern me mallra, shërbime ose teknologji bazuar në një bashkëpunim specifik, të ngushtë e të vazhdueshëm në mes të një pronari financiarisht të pavarur që ka ekskluzivitetet – franshizat e ndërmarrjes të cilat në formë të kontratës u garanton palëve – klientëve të tije së bashku me mundësinë, formën, bashkëpunimin dhe përdorimin e të drejtave të marra në pajtim me konceptin e franshizingut. E drejta kontraktuale bazuar në parimin e autonomisë së vullnetit të palëve i lejon përdoruesit kryerjen e aktiviteteve dhe veprimtarive ekskluzive individuale të marra respektivisht të kontraktuara nga dhënësi i franshizingut në këmbim të një kompensimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë financiare. Brenda këtyre marrëdhënieve specifike përcaktohen ekskluzivitet e përdorimit, mbajtjes dhe mbrojtjes të emrit të franshizing – dhënësit për produktin apo shërbimin, know – how – in, mënyrën e të bërit biznesit, teknikat dhe metodat të cilat përbërjen e procedura standarde e të drejtat tjera që kanë bëjnë me prodhimin ose pronën intelektuale. Kjo nënkupton vazhdimisht dhënien e ndihmës ekonomike dhe teknologjike brenda kohës së përcaktuar në marrëveshje të ekskluzivitet me shkrim që është lidhur me palëve për këtë qëllim.

Franshizingu gjithashtu mund të trajtohet edhe si një mënyrë e bashkimit të burimeve e të aftësive të cilat palët e interesuara i kanë në dispozicion. Franshizing – dhënësi me kapitalin fillestar, njohuritë dhe përvojat mund të ndikojë që franshizing – marrësi të kontribuojnë nëpërmjet investimit me kapitali shtesë, motivimit dhe përvojave të biznesit në tregjet shumë dhe të ndryshme të depërtojnë dhe të arrijnë suksese në treg. Nga kjo konfirmohet dhe shihet se franshizingu është një marrëdhënie kompleks e biznesit dhe jo vetëm një marrëdhënie e thjeshtë blerës – shitës.

Franshizingu është posaçërisht i veçantë për faktin se në mes të dhënësit dhe marrësit të një privilegji krijohet një nivel të lartë të ndërvarësisë. Ekskluziviteti është formë e caktuar edhe në drejtimin e biznesit dhe në identitetin e përbashkët komerciale. Franshizingu respektivisht marrëdhëniet që krijohen në këtë instrument juridik me vlera ekonomike përbëhen nga një pako biznesi që ne

²⁸ V. Šmid: Putnička agencija i njeni ugovori s putnicima i davaocima Usluga., Monografi, Savremena Administracija Beograd 1977, fq 48

vete mund te përfshijë; markë ose markat, përbërjen, know – how /in , eksperiencë e biznesit, mbështetje të vazhdueshme teknike dhe të marketingut, trajnime, doracakë, mallra ose shërbime, etj.. Të hysh në një ndërmarrje dhe të blesh një ekskluzivitet është një nga mënyrat e sigurta për të filluar dhe rritur operacionet tregtare sepse kjo metodë konsiderohet interes i të dyja palëve respektivisht të dhënësit dhe marrësit të një privilegj. Me blerjen e një privilegji dhe angazhimit operativ arrihet që shitjes së mallrave dhe shërbimeve që vetëm janë të njohura të depërtojnë menjëherë në treg. Është e rëndësishme që kur blihet një privilegj të marrën trajnimet dhe mbështetjet që do të kontribuojnë për suksesin.²⁹

Marrëveshjet për ekskluzivitet deri me tani nuk janë rregulluar ngushtë ne sistemin juridik te vendit si një kontrate të veçantë e emërtuar. Megjithatë, bazuar në parimet e Ligjit mbi të drejtat e detyrimeve, ligjeve që garantojnë dhe rregullojnë marrëdhëniet autonome tregtare mbi të gjitha, kushtet e përgjithshme të kompanive ekskluziviteve, kontratave formulare, normave dispositive të ligjit civil dhe komercial, normave të përgjithshme doganore të tregtisë dhe e praktikës gjyqësore dhe arbitrazhit ky instrument i komunikimit juridik – ekonomik ne mes të palëve ka mundësi që të zbatohet lehtë në jetën praktike.

Po ashtu edhe në shumicën e vendeve marrëveshjet mbi ekskluzivitetet nuk janë të rregulluara me ligje të veçanta kombëtare. Nëse ka kërkesa ligjore të lidhura me ekskluzivitetet , atëherë ato janë të lidhura kryesisht me marrëdhëniet kontraktuale midis përfituesve dhe donatorët. Prandaj, rregullat dispozitive të themeluara nuk janë domosdoshmërisht të rëndësishme për importimin dhe shpërndarjen e ndërkombëtare të produkteve apo shërbimeve. Një rregullore e tillë mund të jetë ligji për para-kontratë e cila i detyron ofruesit të paraqesin të dhënat e konceptit të ekskluziviteve para nënshkrimit të kontratës.

Për të rregulluar fushën franchising ekspertët e UNDROIT³⁰ kanë zhvilluar dy aktet të rëndësishme sic është ai i Ligjit të ri të tregtisë autonome dhe Udhëzuesin ndërkombëtare franchising për master marrëveshjen.³¹ Përveç kësaj, për të ndihmuar pjesëmarrësit në marrëdhëniet e biznesit ndërkombëtar Dhoma e Tregtisë në Paris (ICC) ne vitin 2000 ka të miratuar standardet ndërkombëtar lidhur me marrëveshjet e ekskluzivitetit të cilat konsideroheshin si një grup i rregullave uniforme të cilat duhet të kompensohen në mungesën të normave kombëtare që rregullojnë detyrimet ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve për ekskluzivitet.³²

²⁹ Vasili Jani, Kontratat jotipike, Botimet ADA Tiranë 2009 fq. 30

³⁰ <http://www.unfranchise.com/index.cfm?action=services.ubBusinessOverview>

³¹ Udhëzues për Marrëveshjet Ndërkombëtare Master ekskluzivitet nga vol. 1998. rishikimit në vol. 2007. dhe Ligjit Model për detyrimin për të informuar në lidhje me para kontratat franchising (Model ekskluzivitet Zbulimi Ligji) në vitin 2002. vol.

³² <http://www.observatoiredefranchise.fr/questions-reponses/comment-integrer-un-droit-d-entree-en-comptabilite-581.htm>

Llojet e marrëdhënieve - ekskluziviteve

Për produktet që janë subjekt i shpërndarjes së ekskluziviteve zakonisht dhënësi është një prodhues që shet produkte të caktuara gjysmë – të gatshme ose të përfunduar ndërkaq marrësi i produktit – ekskluzivitit është tregtari. Shitësit janë të gatshëm të ofrojnë shërbime të plota klientëve të tyre si para dhe pas shitjes duke ndikuar në këta të fundit jo vetëm për të shitur prodhimet e kontraktuara por dhe për të përmbajtur – ndaluar shitësin nga shitja e produkteve tjera konkurruese. Midis franchizing – dhënësit si shitës i tyre dhe franchizing – marrësit si blerësi krijohet një shkallë mjaft të lartë të ndërvaresisë.

Franchizingu i formatizuar nënkuptohet ajo marrëdhënia në të cilën franchizing / dhënësi i jep franchizing / marrësit një format të biznesit, të sistemit operativ dhe ekskluzivitit të markës të cilën pranuesi nuk mund të shes apo të prek sepse nuk futet në sferën e produkteve materiale por bëhet fjalë për privilegjet e shërbimeve.³³ Shembuj të këtij lloji të biznesit - ekskluzivitit mund të gjenden në hotelieri, mikpritje, shërbime, mirëmbajtja të automjeteve dhe fluturakeve, riparim veshjeje apo zëvendësimi i naftës, mirëmbajtje të motorëve, supermarkete, agjenci të qiradhënies së makinave dhe kamionëve, të shërbimeve të biznesit (të kontabilitetit, etj) dhe shërbimet e konsumit (pastrimi, mirëmbajtje dhe riparimi i shtëpive, kujdesi dhe shërbimet arsimore për fëmijët, duke u përgatitur për një zbritje të tatimeve dhe pronave të patundshme).³⁴

Franchizingu përfshin edhe format e biznesit në të cilin shitësit heqin dorë tërësisht nga aktivitetet e ekskluziviteve ose aktiviteve që lidhen me tej me modelin e franchising. Kjo realizohet kur kompania aktuale heq dorë vullnetarisht nga ekskluzivite e pavarura të tyre duke pranuar pagesën e ekskluzivitit në mënyrë që të arrihet një identitet të fortë i marketingut rajonale dhe kombëtare dhe përparësitë ekonomike e kombinuar blerjen e mallrave dhe shërbimeve. Shembulli më i mirë i këtij lloji janë një rrjet të broker pasurive të patundshme.

Elementet e një rrjeti të ekskluziviteve

Në kuadër të biznesit që realizohet nga marrëdhënia kontraktuale e franchizës kanë rrjedhimisht lindin rrjete franchize. Këto rrjete përbëhen nga një ose më shumë dhënës dhe marrës të një ose shumë më lloje të franchizës. Lloji më i zakonshëm i marrësit të ekskluzivitit zakonisht quhet një "njësi marrës" i cili zotëron dhe menaxhon ekskluzivitet e biznesit. Një aspekt tjetër krijimi të rrjeteve Franchising është i ashtuquajtur "franchizer rajonal". Ka dy lloje të përgjithshme drejtash ekskluzive: *zhvillim ekskluziv* dhe *master ekskluzivitit*.

³³ Krasniqi A., E drejta në turizëm dhe hotelieri, Universiteti i Prishtinës – Fakulteti i Biznesit Pejë fq., 159

³⁴ Po aty

- *Zhvillimi ekskluzivitet* nënkupton të drejtën e marrësit që të përpilojë dhe mbajë një numri të caktuar operacionesh ekskluzive (ose mund të jenë të pakufizuara) të vendosur në një territor të veçantë. Sipas kësaj metode donatorët obligohen që zakonisht të zhvillojnë një numër minimal të njësive në secilën periudhë të zhvillimit (zakonisht një vit), ose ndryshe të ashtuquajturave kuotave të zhvillimit. Fituesja nënshkruan marrëveshje për zhvillimin e privilegjit për çdo njësi individuale.
- *Ekskluzivitet e njohura si master (mjeshtri)* janë të ndryshme nga të drejtat e mëparshme të caktuar në përgjithësi nga franshizing / dhënësi. Kjo nënkupton që përfituesi i të drejtave ekskluzivitet (master / mjeshtëri) mund t'i akordojë palës së tretë nënfranshizing / marrësit të drejtën për të zhvilluar dhe të udhëhequr aktivitetet e caktuara si privilegje ekskluzive në territorin ku vepron. Megjithatë, në rrjete më të madhe kontratë e nën franshizingut e lidhur mes mbajtësit master ekskluzivitet , nënfranshizing mbajtës dhe franshizing / dhënësit nuk krijojnë asnjë lidhje të drejtpërdrejtë kontraktuale me nënfranshizing / mbajtësin dhe franshizing / dhënësit por ka vetëm ato të drejta që janë në lidhje master franshizing marrësin.

Zotëruesi i nënfranshizingut për master ekskluzivitet i ka të përcaktuara dhe të faturuara e tarifave për shpenzimet dhe shumës së paguar nga dhënësit e ekskluzivitet. Edhe pse ky lloj i Franchising përdorur me sukses në zhvillimin e rrjeteve të ndryshme në Shtetet e Bashkuara, marrëdhëniet në mes të Franchising mjeshtër është shumë më e zakonshme ndërkombëtarisht.

Disa dhënës të ekskluziviteve kanë zhvilluar një kategori specifike të franshizing marrëdhënieve. Nganjëherë ato ju referohen apo akordohen Drejtorive rajonale, sipas të cilave individit i epet e drejta për të mbuluar një territor të caktuar me qëllim të shitjes të të drejtave ekskluzive në emër të franshizing – dhënësit dhe vendin. Drejtoria rajonale mund të jetë i obliguar të organizojnë kurse trajnimi, duke dhënë ndihmë të vazhdueshme për të dhe monitorimin e cilësisë së mbajtësit ekskluzivitet në rajon të cilit i janë i ngarkuar ekskluzivitetet. Drejtori Rajonal ka një marrëdhënie kontraktuale me franshizing – dhënësin por nuk është përfituesi i një privilegji. Drejtoria rajonale merr një pjesë në pagesën e kompensimi (zakonisht 1/3 te 1/2) për ekskluzivitet e dhëna nga marrësit e ekskluziviteve dhe shumat të ngjashme të paguar nga marrësit e ekskluzivitet. Ky model është përdorur me sukses nga një kompani ekskluzivitet për zgjerimin e shpejtë.³⁵

Kush konsiderohet dhënës i ekskluzivitetev?

³⁵ Vasili Jani, Kontratat jotipike, Botimet ADA Tiranë 2009 fq. 30

- *Franshizing – dhënësi* është një sipërmarrës i cili është: zotëruesi i një markë dhe një identitet vizual i cili njihet në treg; Ofron një gamë e produkteve / shërbimeve / kanale teknologji tradicionale të shpërndarjes; ka të zhvilluar një metodë të shitjes që është testuar dhe përditësuar në disa fusha; është në gjendje për t'i përcjellë të tjerëve metodat e veta, përvojat dhe njohuritë nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme dhe këshillim; e ka zhvilluar kompania e tij, kështu që është në gjendje të zhvillojnë më tej metodat e tyre dhe menaxhojë rrjetin e ekskluziviteve.
- *Franshizing – marrësi* është një kontraktues i pavarur përgjegjës dhe të zgjedhur nga dhënësi i franshizese karakteristika si me mëposhtme: maksimalisht i afirmuar; posedimin e fondeve të mjaftueshme; gatishmërinë që të punojë ngushtë me të tjerët; gatishmërinë që të punojë brenda sistemit dhe duke pasur parasysh rregullat; pajtimin paraprak që të jetë një anëtar i rrjetit dhe që e ka të zhvilluar një frymë ekipore; duke u bashkuar në rrjet ka të drejtë për të përdorur të gjithë elementet që janë subjekt i ofertave.³⁶

Sipërmarrësit janë përfituesit potencial të ekskluziviteve. Veçanërisht ata të cilët në fazën e rritjes dëshirojnë që të pushtojnë tregje të reja për prodhimin e tij dalluese ose për përmirësimin e markë e njohur. Po ashtu për sipërmarrësit të fillojë ose që duan të zgjerojnë markë e tyre apo markat tjera. Zhvillimin e aktiviteteve të reja për të papunët që dëshirojnë të hyrë të një punë të re ose një kategorie tjetër të dëshirojnë të ndryshojnë punë. Mundësi e madhe mund të jetë edhe për punonjësit që marrin pagat dhe duan për të filluar një karrierë të re në biznesin e vet.

Është e rëndësishme të potencohet se i gjithë procesi i hyrjes së sipërmarrësit në një franshizing biznes do të varet dhe do të konsiderohet nga aspekti i vlerave për ndershmëri e cila vlerësohet në mënyrë rigoroze dhe objektive në mënyrë që të përcaktohet fuqia dhe virtytet e njohurive të tyre. Disa nga këto pyetje që janë të domosdoshme për të vlerësuar potencialin për dhënie të ekskluziviteteve varen nëse kjo është një punë i përshtatet karakteristikave të franshizing – marrësit; vetëdijësimin për bashkim me një sistem ekskluzivitetesh; gatishmërinë për të punuar ngushtë me njerëz; mundësinë e sigurimit të burimeve të nevojshme financiare për të vënë këmbën e punës; gatishmërinë për të punuar brenda një sistem dhe në përputhje me rregullat e tij strikte; gatishmërinë për të humbur një pjesë të lirisë së tyre për të punuar brenda një sistem; gatishmërisë që të pranojnë kontrolli periodik i Franchiso; posedimit të shpirt ekipor; gatishmërinë për punë shumë dhe të gjatë; posedim të një fjalori të ekskluziviteteve opracionale.³⁷

³⁶ Metoda, sistemi, apo know-how, produkte, markë dhe imazhin, ndihmë para, gjatë dhe pas hapjes, dhe të tjerët.

³⁷ Po aty

Funksionimi marrëdhënies kontraktore mbi rregullat e fransizingut dhe praktikave biznesore ndërkombëtare

Parimi i autonomisë së shprehjes së vullnetit të palëve është afirmuar në të gjitha sistemet juridike në lëmin e marrëdhënieve deterymore. Pra, të gjithë ligjdhënësit nisen nga supozimi se vet palët në mënyrën më të mirë dhe të përshtatshme do të i rregullojnë marrëdhëniet e tyre, të bazuar në interesin e përbashkët dhe rrethanat konkrete për secilën punë juridike. Parimi i vullnetit të palëve ka luajtur rolin kryesor në formimin e rregullave uniforme juridike të biznesit ndërkombëtar. Duke i shfrytëzuar këto mundësi, afaristet ndërkombëtar kanë thelluar pozitivisht marrëdhëniet e tyre pothuajse deri në fund dhe plotësisht duke i rregulluar ato me kontratë. Këto marrëdhënie janë sforcuar më tutje duke i paraparë dhe inkuadruar të gjitha elementet, në mënyrë detale, në kontratë me të cilën i rregullojnë çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë edhe me kontestet eventuale, ligjin e aplikueshme nacional etj. Përsëritja e vazhdueshme e klauzolave më përmbajtje të njëjtë në këto kontrata arrin që të shndërrohen në rregulla doksore të biznesit ndërkombëtare, të cilat në praktikë e derogojnë sistemin e vjetruar juridik nacional dhe relativizmin e ndikimit të shtetit në marrëdhëniet ekonomike. Në procesin e unifikimit të të drejtës ndërkombëtare tregtare përmes praktikës që sot krijon mundësi të mëdha zhvillimi dhe investimi rol të rëndësishëm kanë luajtur organizatat e mëdha dhe të fuqishme profesionale dhe shoqata të cilat kanë qenë në pozitë të influencojnë tipizimin e rregullave në një lëmi të caktuar të të drejtës ndërkombëtare biznesore. Me kontratat e tyre tip dhe formular paraprakisht kanë qenë të rregulluara edhe elementet më të imta, konfrom klauzoles për “kryerjen e veprimtarive më lehtësi dhe më siguri”. Palët të cilat dëshirojnë që të lidhin kontratë me pjesëtarët e këtyre organizatave nuk kanë mundësi të tjera vetëm që t’i pranojnë në tërësi ose të refuzojnë në tërësi kushtet e kontratës, dhe se pikërisht nga kjo emërtohen kontrata sipas aderimit (pranimi) apo kontratë athezione. Si formë e unifikuar e tipizimit të kontratave janë edhe kushtet e përgjithshme ose kushtet e biznesit të cilat i sjellin organizatat profesionale të sipërpërmendura në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve kontraktore në një lëmi shkencore të caktuar.

Me kushtet e përgjithshme dhe kontratat formulare janë krijuar parimet ndërkombëtare biznesore të cilat përjashtojnë zbatimin e të drejtave nacionale dhe sjellin në praktikë teknika të reja për lidhjen e kontratave. Në këtë funksion procesi dhe procedurat e strategjive alternative të investimeve bëhen të lehta dhe me kosto jashtëzakonisht të ulët. Ato themelohen në atë mënyrë që palët pa shumë mund dhe me pak kohë të shpenzuar të lidhin kontrata me të cilat i rregullojnë në detale marrëdhëniet e tyre. E drejta e cila është krijuar si produkt i këtyre marrëdhënieve, në teorinë juridike, quhet e *drejta formulare*.³⁸ Duke ju falënderuar këtyre kontratave, në lëmi të ndryshme shkencore të biznesit ndërkombëtare është krijuar një rregullim i ri juridik i cili përjashton përdorimin

³⁸ Krasniqi A: E drejta në Turizëm dhe Hotelieri, Shkolla e Biznesit Peje, Pejë 2004 fq.32

=====

e sistemit juridik nacional. Në këtë mënyrë arrihet që plotësisht të përjashtohet mundësia e intervenimit të gjykatave në raste të caktuara kontestuese. Subjektet biznesore ndërkombëtare paraprakisht i parashohin kompetencën e mekanizmave të veçantë respektivisht arbitrazhave ose gjykatave të zgjedhura gjë që rrjedhimisht e rrisin në mas të madhe sigurinë e investimeve. Shikuar në aspektin e përgjithshëm, subjektet biznesore ndërkombëtar në kontratat e tyre me lehtësi arrin që t'u mënjanojnë aplikimit të te drejtës nacionale dhe gjykatave duke arritur kështu që të krijojnë një sistem të veçantë të sanksioneve që do të shqiptoheshin kundër atyre palëve të cilat refuzojnë që të zbatojnë vendimet e arbitrazhit. Pavarësisht nga elementet pozitive dhe negative që ka e drejta formular në praktikë ajo është duke u zhvilluar, edhe pse ndoshta në mënyrë anarkike, duke i rregulluar në detale çështjet, në bazë të klauzolave dhe autonomisë së vullnetit të palëve të cilat lidhin kontrata dhe njëkohësisht është një formë – alternativë e tërheqjes së investimeve të huaja për vendin.

Përfundimi

Procesi i tranzicionit për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore është përcjell me zhvillime interesante dhe rolin dominant të shtetit për mëkëmbje dhe transformim ekonomik nëpërmjet krijimit të kushteve për investime të huaja direkt dhe portofol. Meqë koha, fazat dhe tërësia e procesit të transformimit në këto vende nuk ka qenë e njëjtë, për shkak të ndikimit të efekteve të caktuar politike, funksionit të shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit, suksesi i tyre natyrisht që nuk ka qenë i ngjashëm. Vendet e Ballkanit për shkak të mbizotërimit të situatave të komplikuara politike me vështirësi po arrin të transformojnë sistemin ekonomik dhe të rrisin aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve nacionale. Në kuadër të rikofigurimit të tregut në këto hapësira kanë përfituar vendet me ekonomi të qëndrueshme duke diktuar kushtet në bazë të parimit të ekonomisë së shkallës. Andaj këto komponente garantojnë përparime ekonomike vetëm nëpërmjet të bashkëpunimit në pikëpamje regjionale dhe globale. Ekonomia dhe veprimtaritë e saja rregullohen më norma juridike nacionale të cilat jo rrallë behën pengesë e këtij zhvillimin. Duke u nisur nga kjo situatë, organizata e ndryshme ekonomike, kompanitë, operatorët ekonomikë etj, zhvillimin ekonomik, në pikëpamje juridike, e kanë mbështetur në shfrytëzimin e parimeve dhe zakoneve biznesore duke i fisnikëruar këto marrëdhënie edhe me parimet dhe kushtet e të drejtës kontraktore. Sifidimi i legjislacionit nacional dhe zvogëlimi i ndikimit të shtetit në rregullimi e ekonomisë, në masë të madhe i ka kontribuar zhvillimi i përgjithshëm i marrëdhënieve kontraktore ndërkombëtare sipas parimeve të së cilës ofrohen metoda për tejkalimin e vështirësive që shfaqen në mes të sistemeve juridike nacionale duke dhënë edhe rekomandime që këto raporte të rregullohen sipas parimeve të te drejtës biznesore. Rol dominant për rregullimin e këtyre

marrëdhënieve po e luan parimi i “autonomis së vullneit” në marrëdhënie kontraktore. Në përgjithësi, konform proceseve ndërkombëtare për globalizimin dhe integrimin e vendeve në bazë të unifikimit të sistemit juridik, e drejta biznese dhe e drejta biznese ndërkombëtar seriozisht kanë ndikuar që nëpërmjet të instrumenteve juridik të unifikojnë bazën legale dhe atë nëpërmjet forumeve ndërkombëtare, normalizimit të praktikës biznese ekzistuese dhe unifikimit nëpërmjet konventave ndërkombëtare. E gjithë kjo veprimtari do të jetë garanci e zhvillimit të mëtejshëm ekonomik dhe të rregullimit të juridik cilësor në pikëpamje ndërkombëtare. Mbi të gjitha, avancimi i këtyre marrëdhënieve ndërkombëtare ka ndikuar në lindjen një seri kontratave të reja të cilat jo vetëm që palëve kontraktuese u garantojnë siguri të lartë juridike por njëkohësisht u mundësojnë edhe shteteve që rishikojnë mundësitë për hartimin dhe zbatimin e strategjive alternative për tërheqjen e investimeve të huaja në vend. Këto kontrata tani më kanë faktuar se e drejta kontraktore autonome e palëve arrin që të kufizojë rolin e shtetit, të rrisë sigurinë juridike biznese, tërheqjen e investime të huaja me një kosto të ulët ekonomike, sigurim të profit dhe nëpërmjet të bashkëpunimit biznesor të avancojë imazhin dhe forcën konkurruese të ndërmarrjeve vendore në tregun ndërkombëtar.

Çdo biznes i suksesshëm që ka për qëllim rritjen dhe zgjerimin duhet të marrë parasysh se ky synim është i mundur që të realizohet nëpërmjet marrëdhënieve franshizing – ekskluzivit. Avantazhet të cilat i ofron ky sistem pa dyshim janë të shumta. Një nga me të rëndësishmet llogaritet të jetë mundësia e përdorimit të burimeve të te tjerëve për të hapur zyrat e reja, që do të thotë se biznesi shpejt mund të përhapet tek njerëzit shumë të motivuar (investitorët, përfituesit e ardhshëm të ekskluziviteve) që do të drejtojnë degën. Në të njëjtën kohë shpenzimet e personelit udhëheqës në drejtimin e këtyre proceseve në këtë fushë janë të vogla posaçërisht në krahasim me shpenzimet e menaxhimit të rrjeteve të tyre. Natyrisht, këto janë avantazhet anën e saj të tjerë, dhe ky është fakti se biznesi ekskluzivitet që gjithmonë të ketë një fitim të vogël se në qoftë se ajo kishte në pronësi, dhe investimet e larta fillestare për hartimin dhe zhvillimin e rrjeteve ekskluzivitet. Përveç kësaj, pasi franchisor do të duhet të përballen me problemet e pashmangshme e komunikimit dhe duke punuar me përfituesit ekskluzivitet. Për shkak të gjithë procesin e hartimit dhe të rrjetit ekskluzivitet duhet të lihet të ekspertëve, si duhet të jenë të vetëdijshëm se ai krijon një formulë që do të shërbejë për vite me radhë, me ndryshime të vogla.

Prandaj, investimi fillestar mund të duket të shtrenjta por zgjedhin problemin e zgjerimit të biznesit afatgjatë dhe plotësojnë mungesën e tre faktorëve kryesorë për biznesin: kohën, të hollat dhe të strukturës së stafit të motivuar. Duke u bashkuar me ekskluzivitet, të tre faktorët ofrohen nëpërmjet ekskluziviteve – franshizez. Nëse doni të projektini në masë të madhe të zgjeruar biznesin tuaj dhe nëse doni të punoni për të rritur madhësinë optimale dhe maksimale profitabilitetit këtë mundëni që lehtë ta realizoni nëpërmjet krijimit të franshizing marrëdhëniesh.

=====

Format e bashkëpunimit bashkëkohor për teknika të reja të tregtisë ndërkombëtare, zhvillimit ekonomik të vendeve i kanë dhënë impulse pozitive. Jo të gjitha vendet (ne veçanti në zhvillim dhe ato të varfra) kanë treguar sukses në procesin e tranzicionit për shkak të dominimit të efekteve të ekonomisë së shkallës. Procesi i tej zgjatur transitiv këto vende i ka qitur para problemeve të shumta shoqërore. Andaj analizimi mundësive të investimeve eventuale alternative nëpërmjet të së drejtës kontraktore në jetën praktike jep rezultate efektive, me kosto ekonomike të ulët për vendin dhe ndërmarrjet e saja. Për të shfrytëzuar këto mundësi është e domosdoshme kompletimi i legjislacionit në frymën bashkëkohore që do të jetë kompatibil me konventat respektive ndërkombëtare dhe me standardet e larta të Bashkimit Evropian. Identifikimi i partnerëve serioz, krijimi i bashkëpunimit nëpërmjet të kontratave siç janë ato të franshizingut, Know – How – it, licencës, forfetingut, etj, besohet të jenë mundësi për një sukses zhvillimor ekonomik në vend.

Zhvillimi ekonomik në kushte e globalizimit, shoqërisë moderne dhe post moderne është shndërruar në motor të zhvillimit shoqëror. Në këtë kontekst procesi i zhvillimit, reformimit dhe transforimit të ekonomive të vendeve, për secilin veç e veç, ka specifikat e përbashkëta dhe ato që i dallojë nga njëra tjetra. Shumica orvaten që të shënojnë rritje ekonomike nëpërmjet të rritjes së tregtisë me jashtë dhe investimeve të huaja.

Literatura e konsultuar dhe e shfrytëzuar

1. Aleksander, Gordon J., & William F.Sh., Fundamentals of investments, 1989
2. Andersen, A., Regionalism and the World Trading System, WTO, 1995
3. Brumbulli S., Investimet, Tiranë 1998
4. Hetemi M., E drejta me njohuritë themelore të së drejtës afariste, Prishtinë 1996
5. Kristo I., Biznesi Ndërkombetar, Tiranë 2004
6. Krasniqi A., E drejta në turizëm dhe hotelieri, Pejë 2005
7. Gorenac V & Šmid V., Poslovno Pravo u Turizmu i Ugostiteljstvu, Zagreb 1999
8. Godštajn A: Privredno ugovorno pravo., Informator br.1, Zagreb 1980
9. Kuhn, G. Michale, Horvath Balaza and J. Christopher., Officaly Supported Export Credits, International Monetary Found, Washington D.C., 1990, Internation Trade Center UNCTAD/WTO, The Financing of Exports, Geneva, 1997
10. Vasili J., Kontratat jotipike, Botimet ADA, Tiranë 2009
11. <http://www.franchise.org/convention.aspx>
12. <http://www.ifeinfo.com/>

KUD 327 : 338

**KRIZA FINANCIARE GLOBALE
POLITIKAT FINANCIARE, GABIMET DHE REFLEKSIONET**

*Dr. Sc. Artan Nimani³⁹
artannimani@gmail.com*

Abstrakt

Kriza e globale ekonomike e kohëve të fundit po shërben si justifikim për të lëshuar një fushatë anembanë botës kundër ekonomisë të tregut dhe sipërmarrjes së lirë si dhe si një motiv për të justifikuar një ndërhyrje më të madhe të shtetit në ekonomi. Kriza e tanishme, si dhe ajo e vitit 1929, filloi në fushën financiare (në Wall Street) dhe në shtetin më të fuqishëm të botës. Tregu i lirë po konsiderohet si përgjegjësi kryesor i kësaj krize ndërkohë që shkaktari kryesor ka qenë në fakt ndërhyrja e qeverisë në ekonomi. Kuptohet që babëzia ka luajtur rolin e vetë në këtë situatë dhe shumë bankierë e kanë mbështetur shtetin si dritë të gjelbër për të abuzuar akoma më tepër duke dhënë kredi bujare për shtëpi për individë që nuk kishin kolateral apo të ardhura të mjaftueshme. Po kështu ka pasur shumë individë të papërgjegjshëm që kanë kërkuar e marrë kredi për shtëpi njëmilionëshe më të ardhura minimale duke shpresuar që rritja e çmimeve do vijonte. Me pak fjalë analiza e krizës që po mbizotëron në mediat ndërkombëtare është e gabuar dhe për këtë arsye edhe zgjidhja e propozuar është e gabuar dhe e dëmshme. Shkaktari i kësaj krize ka qenë ndërhyrja e qeverisë në ekonomi me taktikat e promovuara nga promovuesit e rrugës së tretë dhe jo sistemi i tregut të lirë. Kostoja totale globale e kësaj krize do të arrijë deri në 4.1 trilionë Dollarë

Fjalet kyçe: Kriza, Globalizmi, Tregjet financiare , FMN, Fitimi, Humbja, Qeveritë, Bankat

Hyrje

Kriza aktuale ka përfshirë botën e me theks të veçantë, vendet më të zhvilluara, të atyre shteteve që kanë shumicën e brutoproduktit botëror dhe që kanë nivelin e lartë të jetesës.

Edhe ata që nuk janë ekspertë mund t'i përshkruajnë pasojat e krizës duke e parë realitetin që po shihet, por për atë se deri ku do të shkojë kjo krizë

³⁹ Autori është ligjerues i lëndëve: Mikorekonomi dhe Financa në FSHAB në Universitetin e Prishtinës si dhe lëndëve: Menaxhment dhe Financa e drejta Financiare në Kolegjin Universitar Biznesi, Prishtinë.

është e pamundur që të parashikosh. Edhe ekspertët më të mëdhenjë kanë hamendje dhe divergjenca të mëdha, por pajtohen me një gjë :

- efektet shkatërruese të kësaj krize do të jenë më të rënda se asnjë herë më parë dhe nuk mund të parashikohen.

Kohë të gjatë, në teorinë ekonomike botërore pati sunduar teoria e ligjeve të tregut të lirë. Me bindjen se tregu është rregullatori i të gjitha problemeve ekonomike. Tregu, si uji i lumit do e gjejë rrjedhën me të mirë dhe do të gjejë zgjidhjen e nevojshme më të mirën. Prandaj sa më pak barriera shtetërore tregut, sa më pak intervenime shtetërore dhe vetë tregu është një autorregullatore ekonomik. Ekonomia e tregut të lirë u bë model i zhvillimit dhe progresit ekonomik botëror, ajo kaloi barrierat kombëtare dhe u bë ligji i zhvillimit të mbarë ekonomisë botërore. Globalizmi dhe tregu i liri botëror u bënë parimet e zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Të gjithë organizmat ndërkombëtar, si Banka Botërore, shtetet e fuqishme ekonomike, parime të zhvillimit dhe bashkëpunimit vunë ekonominë e tregut të lirë dhe eliminimin e intervenimeve shtetërore. Sa më pak intervenim të shtetit sa më tepër liri veprimit të tregut- ky ishte parimi kryesor ndërkombëtar. Po jetojmë në një epokë financiare tragjike. Tregjet financiare dhe ekonomit bankare ne veqanti janë në një gjendje jo të mirë, tregjet amerikane të aksioneve ranë rreth 40%, me fjalë të tjera kjo kohë, ishte një ndër 5 momentet më të errëta që nga viti 1920. Para saj mund të renditen vetëm "shembja" e bursës së Wall Street në vitin 1929, kolapsi teknologjik i vitit 2000, kriza e vitit 1973 pas luftës së Yom Kippurit, ndërsa çmimi i naftës u katërfishua dhe kolapsi i famshëm i viteve 1937/'38, kur në Evropë po niste Lufta II Botërore

Në vitin 2000, edhe pse duket sikur fundi i botës ishte pas kthesës, ekonomia botërore shpëtoi thujtë e pacenuar. Sigurisht që u regjistruan recesione të vogla në Shtetet e Bashkuara, Evropë, apo Japoni.

Shumë më e vështirë ka qenë situata në krizat e viteve '30, apo '70, megjithatë bota ia doli mbanë. Për sa i përket krizës së fundit financiare, ajo i ka të gjitha shenjat të jetë shumë më e mprehtë dhe me më shumë pasoja. Rënia e çmimeve të aksioneve është më shumë një efekt anësor i asaj çka po ndodh në të vërtetë. Tregjet financiare e nisën vallen e vdekjes me krizën e kredive, e cila erdhi si pasojë e rritjes së madhe të çmimeve të pasurive të patundshme dhe e borxhit të ekonomive familjare. Pikërisht këto dy dukuri të fundit mund të krahasohen fare mirë me fitimet e mëdha të viteve '20, periudhë gjatë së cilës njerëzit shpenzonin me grushte sikur e nesërmja të mos ekzistonte.

Të gjithë nuk po e heqim nga goja fjalën recesion, që nuk përbën më një fakt të papritur dhe të befte. Por sa më shumë që shkrihet tregu financiar, aq më i madh është rreziku i një ekonomie problematike për vitet që do të vijnë. Kështu, për shembull, kriza bankare në Japoni doli të ishte shumë më e rëndë nga sa u parashikua fillimisht, pjesërisht për shkak të aseteve në të cilat ishin bazuar shumë banka kur dhanë kreditë, veçanërisht toka që humbën shumë në çmim. Çmimi i tokave në Japoni ka rreth 15 vjet që vazhdon të bjerë. (Adri Nurellari-Botuar tek gazeta "shqip"). Në këtë moment, është ende e vështirë që të çmosh

=====

se deri në çfarë mase kriza ka ndikuar në ekonominë dhe cilat do të jenë pasojat e krizës. Ajo çka dimë është se shumë banka do të duhet për shumë kohë ta reduktojnë dhënien e kredive, por për bankat që këtë funksion e kanë pasur primar, kjo do të thotë humbje e madhe

Kriza dhe refleksionet

Kriza e gloale ekonomike e kohëve të fundit po shërben si justifikim për të lëshuar një fushatë anembanë botës kundër ekonomisë të tregut dhe sipërmarrjes së lirë si dhe si një motiv për të justifikuar një ndërhyrje më të madhe të shtetit në ekonomi. Tregu i lirë po konsiderohet si përgjegjësi kryesor i kësaj krize ndërkohë që shkaktari kryesor ka qenë në fakt ndërhyrja e qeverisë në ekonomi. Kuptohet që babëzia ka luajtur rolin e vetë në këtë situatë dhe shumë bankierë e panë mbështetjen e shtetit si dritë të gjelbër për të abuzuar akoma më tepër duke dhënë kredi bujare për shtëpi për individë që nuk kishin kolateral apo të ardhura të mjaftueshme. Kriza e tanishme, si dhe ajo e vitit 1929, filloi në fushën financiare (në Wall Street) dhe në shtetin më të fuqishëm të botës. (Sipas vlerësimeve të FMN, ShBA ze vendin e parë me 23.6% të GDP botërore për 2008, pasuar nga Japonia me 8.0%, Kina 7.1 %, Gjermania 6 % etj).

Kjo krizë u përhap në të gjitha vendet, sidomos në ato të zhvilluara, dhe u shndrrua shpejt në një krizë ekonomike me pasoja të rënda sociale. Analistët venë dukje se, një vit pas fillimit, bota vlerësohet të ketë humbur një pasuri prej 15 trilion \$ (10.3 trilion euro) .

Madje, shtete si Islanda por dhe Hungaria e Letonia, shkuan në buzë të greminës. (SPIEGEL, 7.9.2009). Sipas parashikimeve më të fundit të FMN, (tetor 2009), GDP botërore pritet të bjerë 1.1 për qind këtë vit.

- Më e thellë rënia do të jetë në vendet më të zhvilluara : 3.4 %;
- në Japoni 5.4 %,
- në Gjermani 5,3 %,
- në Itali 5.1 %,
- në Britani 4.4 %,
- në Spanjë 3.8 %,
- në ShBA 2.7 %,
- në Francë, 2.4 %

Rënia ekonomike po shoqërohet me rritjen e shkallës të papunësisë:

- në ShBA 9.3 % më 2009 dhe 10.1 % më 2010 kurse
- në vendet e eurozonës përkatësisht 9.9 % dhe 11.7 %.

Miliona amerikanë humbën shtëpitë e tyre nga piramidat e hipotekave dhe miliona të tjerëve i'u ra vlera e tyre. Gjatë kësaj krize dolën në pah skemat financiare mashtruese të tipit "Ponzi" (1920). Bernard Madoff, ish kryetar i bordit të Bursës NASDAQ të Nju Jorkut për dekada kishte ngritur një piramidë gjigande ku 15 400 investues humbën 65 miliard usd!

Krahasuar me Depresionin e Madh kjo krizë ka si veçori kryesore se bota ndodhet tani në fazën e globalizmit, ndërvarësisë ekonomike, zhvillimit të

teknologjisë dhe internetit, për rjedhojë dhe masat për kapërximin e saj parashikohet të jenë më efektive.

Po cilat janë shkaqet apo rrënjët e krizës? Sigurisht ato janë të shumta dhe të ndryshme. Në këtë shkrim po sjellim në vëmendje kryesisht opinionet e disa fituesve të Çmimit Nobel në Ekonomi, si Paul Krugman (2008), Jozef E. Stiglitz (2001, Amartia Sen (1998), si dhe të ndonjë personaliteti të rëndësishëm botëror

Politikat financiare, gabime dhe pasojat

Në mjaft shkrime të kohëve të fundit nobelistët e cituar konvergojnë në mendimin se rrënjët dhe shkaqet e krizës së tanishme lidhen me politikat e gabuara të ndjekura në ShBA dhe në vende të tjera të zhvilluara në drejtimin e ekonomisë.

Një ndikim të ndjeshëm kanë dhënë sidomos teoritë dhe politikat liberale dhe monetariste të tipit laissez-faire, që i japin përparësi funksionimit automatik të tregjeve tregut, si vetë-korrigjues dhe vetë-rregullues dhe që nënvleftësojnë rregullimet qeveritare. Ato u përpunuan nga M. Fridman, lider i Shkollës Ekonomike të Çikagos në vitet '70, dhe u jetësuan në qeverisjen e R. Reganit, M. Theçerit etj. në vitet '80, e më vonë.



Këto teori sfiduan ato të J.M.Keynes (1883-1946), (ekonomist i britanik, i njohur dhe si themelues i makroekonomisë moderne), i cili përpunoi politikat qeveritare të zbutjes të efekteve të cikleve të biznesit, reçesioneve dhe depresioneve përmes masave fiskale dhe monetare. Lindja e ekonomisë si shkencë- shkruan Krugman-daton me veprën klasike të

Adam Smithit “Pasuria e Kombeve” më 1776. Për mëse 160 vjet u zhvillua një teori ekonomike, mesazhi kryesor i së cilës ishte: Beso tregun! Ekonomistët e pranuan tregun bashkë me rastet e dështimit, ku më i rëndësishmi është ai i “përrjashtimeve”...Thelbi i ekonomisë “neoklasike” ishte gjithashtu besimi në një sistem tregu

Por Depresioni i Madh i 1929 e zbehu këtë besim. Pas kësaj, shumica e ekonomistëve u përqëndruan në analizat e Kejnsit për atë çfarë kishte ndodhur dhe në rrugë-zgjidhjet për depresionet e ardhëshme, të cilat ai i kishte përmbledhur në vitin 1936 në veprën e tij, “Teoria e Përgjithëshme e Punësimit, Interesave dhe Parasë”. Kejnsi kundërshtoi mendimin se ekonomitë e tregut të lirë mund të vetëfunksionojnë, duke shprehur mosbesim në mënyrë të veçantë

=====

për tregjet financiare. Ai bëri thirrje për ndërhyrje aktive qeveritare –për të nxjerrë më shumë para gjatë krizave dhe, nëse është e nevojshme, për të luftuar papunësinë - duke shpenzuar më shumë në punët publike. Kejnisi argumentoi se jo vetëm që tregjet nuk janë vetë-korrigjues, por që në një krizë ekonomike, politika monetare mund të mos jetë efektive. (Krugman, 2 shtator 2009.)

Në këtë linjë është edhe A.Sen kur analizon se “kriza e tanishme ekonomike, pjesërisht është shkaktuar nga një mbivlerësim i madh i veprimit të proceseve të tregut dhe është acaruar nga ankthi dhe mungesa e besimit në tregun financiar dhe në bizneset në përgjithësi. Roli mbikqyrës i qeverisë në ShBA ka qënë reduktuar ndjeshëm, i ushqyer nga një besim në rritje për natyrën vetërregulluese të ekonomisë së tregut (Sen, 26 mars 2009).

Duke analizuar shkaqet e kësaj krize në një rrafsh më konkret por që nxiten nga teori liberale, Presidenti B.Obama në fjalën e tij më 14 prill 2009 në Universitetin Georgetown Washington, thekson se ky recesion, ndryshe nga të mëparshmit “ nuk erdhi si rjedhojë e një rënie normale të ciklit të biznesit. Ai u shkaktua nga një furtunë e vërtetë e papërgjegjshmërisë vendimarrëse që shtrihet nga Wall Street, në Washington në Main Street.”

Teoria e Kejnisi –Rikthehet

Nga Depresioni i Madh kemi mësuar se tregjet nuk janë vetë-rregulluese thekson Siglitz. Por këto mësimë sikur filluan të harrohen këto tre dekadat e fundit. Sistemi financiar amerikan ka ndryshuar thellë që nga vitet 1930. Shumë nga bankat e mëdha lëvizën nga “huadhënia” për bizneset në “lëvizjen e bizneseve .” Ato u fokusuan në blerjen e aseteve, rietiketimin dhe shitjen e tyre, duke treguar paaftësi në vlerësimin e riskut dhe analizën e vlefshmërisë të kredisë.

Ai shton se bota në këto dekadat e fundit është joshur pas idesë të bazuar në nocionin fundamentalist se tregjet janë vetë-korrigjues, i shpërndajnë burimet në mënyrë eficiente, dhe u shërbejnë mirë interesave publike. “Ka qënë ky fundamentalizmi i tregut që shtroi Theçerizmi, Reganomia, dhe i ashtuquajtur i “Konsensusi i Uashingtonit”, (me këtë ai ka parasysh politikën ekonomike që kanë ndjekur institucionet financiare ndërkombëtare), në favor të privatizimit, liberalizimit dhe pavarësisë të bankave qendrore duke u fokusuar posaçërisht mbi inflacionin. Mbrojtësit e fundamentalizmit të tregut -shton ai- duan ta çvendosin përgjegjësinë nga dështimi i tregut në dështimin e qeverisë. Por kjo nuk i ndryshon faktet: bankat e ShBA keqmenaxhuan riskun, ndërsa qeveria u jep atyre miliarda usd si kompensim. (Stiglitz, korrik 2008) .

Mirëpo tani, jemi kthyer të gjithë kejnsonianistë -shprehet jo pa nënkuptim- Stiglitz. Madje edhe të djathtët në Shtetet e Bashkuara i janë bashkuar kampit kejnsonianist me entuziazëm të shfrenuar. Për këdo nga ne që pretendon për disa lidhje me traditat kejsianiste, ky është një moment kthese, pasi ka qënë shmangur, për më shumë se tri dekada. Ajo që po ndodh tani përbën një triumf të arsyes përmbi ideologjitë dhe interesat. (Stiglitz, dhjetor 2008).

Pas fillimit të krizës dhe në fund të mandatit, Presidenti G W Bush duket më realist për rolin e tregut. Në Samitin për Bashkëpunimin Ekonomik Azi-Paqësor në Lima më 22 nëntor 2008 z. Bush pranoi se sistemi i tregut të lirë nuk është perfekt dhe se ai “mund të jetë subjekt i teprimeve dhe abuzimeve. Siç kemi parë këto muajtë e fundit, ka periudha kur ndërhyrja qeveritare është thelbësore për të rivënë në punë tregjet dhe për të mbrojtur shëndetin e përgjithshëm ekonomik.”

A.Greenspan, (kryetar i Rezervës Federale në vitet 1987-2006, i caktuar fillimisht nga Regani por që vazhdoi edhe ne administratat e tre presidentëve të tjerë), u shpreh para një komisioni të Kongresit më 23 tetor 2008 se kishte pasur shumë besim në fuqitë vetë-korrigjuese të tregut të lirë dhe se kishte dështuar të parashikonte fuqitë vet-shkatërruese të huave të ekzagjeruara të hipotekave (nytimes.com.24.10.2008).

Kapitalizëm me rregulla dhe moral

Çështja që shtrohet me shumë forcë tani lidhet me natyrën e kapitalizmit dhe me nevojën ose jo të ndryshimit të saj-shkruan A.Sen. Disa mbrojtës të kapitalizmit të shpenguar, që kundërshtojnë ndryshimin, shprehen se kapitalizmi po fajësohet shumë për problemet ekonomike afatshkurtëra- probleme që ata i a hedhin qeverisjes së keqe (për shembull administratës të Bushit) dhe sjelljes së keqe të disa individëve (ose si John McCain e përshkroi gjatë fushatës presidenciale- "babëzi e Wall Street"). Por të tjerë, shohin difekte vërtet serioze në rregullat ekzistuese ekonomike dhe duan t'i ndreqin ato, duke kërkuar një qasje alternative që ka filluar të quhet -" kapitalizëm i ri."

Mendimi për një “kapitalizëm të ri” u hodh në Simpoziumin e mbajtur në Paris më 8 janar 2009. Në fjalën e tij, presidenti francez N.Sarkozy e cilësoi kapitalizmin financiar bazuar në spekulimin "një sistem imoral " që ka “prishur logjikën e kapitalizmit”, kancelarja gjermane A.Merkel ngriti shqetësimin se sistemi "nuk mund të vazhdojë kështu siç është" dhe propozoi “për tregje më të rregulluara” kurse ish kryeministrit britanik T.Blair u shpreh për një rend të ri financiar bazuar në "vlerat ndryshe nga një fitim maksimal afat-shkurtër."

Ekonomisti M. Yunus që drejton një bankë të madhe mikrokrediti në Bangladesh, (fitues i Çmimit Nobel për Paqe për vitin 2006) shprehet se ‘dora e padukëshme’ e Adam Smithit, e cila mendohej se i zgjidh të gjitha problemet e tregut nuk ekziston. Ajo ç’ka po përjetojmë është një dështim dramatik i tregjeve. Duket qartë se tregu nuk është në gjëndje të zgjidhë të gjitha problemet vetë prandaj njerëzit tani vrapojnë tek qeveritë për të kërkuar ndihmë emergjente. Kapitalizmi, me të gjitha mekanizmat e tregut, do të mbijetojë- nuk është kjo çështja. Por nuk duhet të ketë vetëm një motiv për të bërë biznes siç është maksimizimi i fitimit; e nevojshme është të përfshihen edhe nxitësa sociale.”(SPIEGEL ONLINE International. 10.10.2008.)

Duke lënë mënjanë teoritë e “mosndërhyrjes qeveritare”, duke mos i besuar rolit vetë-rregullues të tregut, qeveritë kanë marrë masa të

=====
 jashtëzakonshme duke injektuar qindra miliard usd në banka dhe institucione të tjera për t'i shpëtuar nga falimentimi dhe për të frenuar krizën ekonomike. Madje nuk kanë ngurruar të ndërhyjnë edhe drejtpërdrejt për të mbrojtur industrinë kombëtare si psh ato të makinave në ShBA, Gjermani etj.

Të ndërgjegjshëm se masat rregulluese në nivel shtetëror nuk mjaftojnë, janë hedhur në lëvizje dhe aktivitet të plotë edhe organizmat dhe institucionet ndërkombëtare si G8, G20, FMN, BB etj). Mjaft frytdhënës dhe tej parashikimeve rezultoi sidomos takimi i G20 i zhvilluar në Londër më 3 prill 2009, ku liderët ranë dakord t'i akordojnë FMN 1.1 trilion usd për të mbështetur një program për kreditimin, rritjen dhe punësimin në ekonominë botërore.

Duke konfirmuar efektivitetin e këtyre masave, shtatë muaj më vonë, në Samitin e G20 në Pittsburgh (ShBA) më 24-25 shtator 2009 kreu i FMN, Strauss-Kahn u shpreh se bashkëpunimi i liderve duhet të vazhdojë për të mbështetur ringritjen ekonomike globale, pasi kjo është ende e pasigurtë. Prandaj-shtoi ai- është e parakohëshme të heqim dorë nga politikat monetare dhe fiskale rregulluese.

Përfundimi

Me qellimte perballimi të kësaj gjendjeje jo të mirë globale financiare, qeverit duhet të jenë të kujdesshme dhe të marrin masa urgjente. Qeveria duhet të lejojë tregun të bënte punën e vetë duke rihvendosur burimet nga sektorë jo-produktiv ose jo-efikas sikurse ishte ajo pjesë e sektorit bankar që u morr me kreditë për shtëpitë, drejt sektorëve të tjerë më produktiv. Pra duhet që ti jepej mundësi tregut që të normalizonte marrëdhënien midis kursimeve, huadhënies dhe produktivitetit. Mirëpo qeveritë në vend që të lejonin krasitjen e shëndetshme që do t'i bënte vetë tregu degëve të kalbura të ekonomisë, është duke e zgjatur (por jo duke eliminuar) kalbësinë. Sikurse thotë Daniel Mitchel i Cato Institute, tregu pa falimentim është si feja pa ferr. Tregu pa falimentimin është i gjymtuar dhe i çaktivizuar dhe nuk mund të bëjë funksiononin e vetë. Duke shtuar likuiditetin në treg shteti amerikan ka ndërmarrë një masë afatshkurtër që thjesht ka për të ndihmuar ato banka që kanë pasur dobësi në menaxhim si dhe ka për të nxitur inflacionin. Po të ndodhte krasitja aktivitetet dështake do të mbylleshin ato aktivitete që nuk rrinë dot në këmbë dhe që konsumatorët nuk i duan dhe fondet, burimet apo energjitë do të kalonin në aktivitete fitimprurëse. Mirëpo në vend që të lihen të falimentojnë institucionet financiare kanë abuzuar me situatën apo që kanë bërë zgjedhje gabuara në treg për të cilat duhet të mbajnë përgjegjësi, qeveria amerikane e më pas qeveritë e tjera u futën në lojë për të mbajtur në këmbë këta dështakë. Në vënd që qeveria të merrte përgjegjësitë që i takonin për krizën dhe të tërhiqej nga tregu qeveria bëri të kundërtën i futi akoma më keq duartë në ekonominë e tregut duke gjendur qindra miliarada të taksapaguesve. Mirëpo paraja në vetëvete nuk gjeneron pasuri po të kishte qenë e mundur do e kishim zhdukur varfërinë qëmoti.

Edhe pse Bankat ndërprejnë huadhënien ndaj njëra-tjetrës, duke pasur frikë se bilancet e tyre të mbushura me borxhe e "mbetje toksike" do të shpërthenin nga momenti në moment. Në këtë situatë ngurtësimi të likuiditetit, bankat qendrore nisën të pomponin para në të gjithë sistemin bankar dhe në shuma shumë të mëdha, e megjithatë zhblllokimi i situatës nuk ndodhi. E që do të thotë se Kriza është me serioze se sa parashikohej deri me tani.

Në perfundim du atë paraqes edhe disa aksione konkrete të qeverive dhe BQ në tejkalimin e kësaj gjendje të emruar si Plane shpëtimi, Planet e shpëtimit të sektorit bankar të rrezikuar fillimisht u plasuan në SHBA dhe Evropë dhe në të shpeshtën e rasteve ka dy aktorë të mëdhenj: - Qeveritë dhe Bankat qendrore.

Bankat qendrore po reagojnë në zbritjen e përqinjes së interesit të tyre si dhe në marrjen si garant të aktiveve të infektuara të bankave në vështirësi. Psh. Në tetor 2008, Fed dyfishoj nivelin e likuiditetit të vënë në dispozicion të bankave duke arritur shumën në 9000 miliard dollarë.

- Qeveria Amerikane plasoj Planin Paulson i cili plan parashikon blerjen e aktiveve të infektuara nga bankat e ndryshme në shumën prej 700 miliard dollarë.
- France : Shteti garanton të gjitha operacionet bankare në vlerë prej 320 miliard dollarë dhe ndihmon në kapitalizimin e bankave në vlerë prej 40 miliard dollarë.
- Gjermani : Shteti garanton operacionet bankare në vlerë prej 400 miliard dollarë dhe ndihmon në kapitalizimin e bankave prej 80 miliard dollarë.
- Britania e Madhe : Shteti garanton operacionet bankare në vlerën prej 320 miliard dollarë dhe ndihmon në kapitalizimin e bankave në vlerë prej 64 miliard dollarë.
- Zvicër : ndihmohtet në kapitalizimin e bankës prej 6 miliard frz. dhe blihen aktivet e infektuara prej 60 miliard frz.
- Indi: ndihmohet sektori bankar me 9 miliard dollarë
- Kinë: Ulet pëqindja e interesit.

Ateher parashtohet pyetja ligjike se kush fitoj dhe kushe humbi nga gjith kjo vorbull financiare. Në rend të parë fituan ata që edhe janë përgjegjës të kryesor të kësaj krize. E ata janë menagjerët e shumtë, bankjerët, ndermjetësuesit bankarë e financiare të cilët kjiuan produkte të lloj-llojshme të plasuar në bursat e njohuar me premtimin e fitimit joreal për financuesit duke siguruar për vetën e tyre fitimin e menjëhershëm mbi kapitalin e investuar nga të tjerët. Financuesit e mëdhenj, spekulatorët e shumtë të tregut bursier duke vjelur fitimet e tyre të garantuara dhe duke lënë si pasojë rrëmujën e mëvonshme financiare. Vetëm rrogat dhe bonuset e menagjerëve të shumë të bankave silleshin në 500'000 deri në 50 milion dollarë vjetor, ndërsa rrogat e punëtorëve as për të siguruar jetesën normale të familjeve të tyre. Sipas revistës „Le Times“, vetëm 15000 familje amerikane fitojnë 5% të të ardhurave totale kombëtare

=====

amerikane - që është e barabartë me të ardhura prej 9.5 miliard dollarë për familje në vit. Në të njëjtën kohë aktualisht sot në botë 1.2 miliard njerëz jetojnë me më pak se 1 dollarë në ditë. Fituan bankat e mëdha të cilat me vite përvetësuan fitimin mbi investimet e realizuara për të vete dhe për të tjerët, ndërsa në rastin e tanishëm, investimet e tyre të pavlerë i bartën me mjeshtri në barrë të bugjetit shtetëror, gjegjësisht në barrën e qytetarëve të thjeshtë që nuk ka asnjë përgjegjësi në arrogancën bankare.

Po kush humbën,- kjo është ana tjetër e medaljese që kushtoj jo pak në gjithë botën. Ketu Humbën kryesisht bankat dhe financuast e ndryshëm që plasuan kursimet e tyre financiare në kërkim të një fitimi më të madh, një fitimi që u bë modë „e shkathtësisë dhe vigjilencës financiare Humbën fondacionet e ndryshme të fondeve pensionale, të cilat investuan në këto produkte financiare me shpresën e kapitalizimit më të madhe, për tu gjendur sot të rrudhura për humbjet e pasuara. Fat të njëjtë pësoj edhe Fondi Pensional i Kosovës për të cilin më në fund po flitet se vetëm gjatë vitit 2008 humbi rreth 100 milion euro nga tërësia e tij. Po nuk di pse nuk thuhet asgjë për parat e grumbulluara nga agjencia e Privatizimit të pasurisë së Kosovës, për të cilat thuhet se janë depozituara në një vend të sigurt, po nuk dihet se ku dhe sa është vlera reale e sotme e tyre. Humbi qytetari, humbën miliona familje të cilat tash dhe në të ardhmen do të bartin humbjet e mëdha financiare me kurrizin e tyre përmes zvoglimit të fuqisë blerëse dhe rritjes së tatimit që shteti do e bartë tek ta për të mbuluar rrezikun që shteti sot ka marrë mbi bankat për të ashtuquajtrua „produkte të infektuara financiare“. Bankierët dhe financierët kanë përvetësuar fitimet e tyre kolosale ndërsa Humbën mijëra të punësuar në ekonominë, pasojat e kësaj krize veç kanë filluar të ndihen, e sektori i dytë pas atij financiar është ai automobilistikë, ku shumica e prodhuesve automobilistik po kërkojnë ndihmën e shtetit dhe kanë ndërprerë përkohësisht prodhimin. Në vazhdim kriza do vazhdojë mbi sektorin e ndërtimtarisë, industrisë, hotelierisë dhe mbi gjithë ekonominë. Recesioni ka përfshirë në gjysmën e dytë të viti 2008 SHBA-në, Japoninë, Francën e edhe Gjermaninë, ndërsa parashikimi i depresionit të Bruto Produktit për vitin 2009-2010 do sillet në rreth -3 e -10%. Me këtë parashikim është evidente humbja e qindra mijëra vendeve të punës.

Si perfundim mbeshetur në të dhenat e FMN-së, humbja apo kostoja totale që do i kushtojë globit kjo krize do të arrijë deri në 4.1 trilionë Dollarë

Literatura dhe referenca

1. Civici, A “Kriza financiare ...apo globale?”, Tiranë, 2010
2. Paul Krugman Fitues i Çmimit NOBEL në Ekonomi (2008),
3. Jozef E. Stiglitz, Fitues i Çmimit NOBEL në Ekonomi (2001)
4. Amartia Sen Fitues i Çmimit NOBEL në Ekonomi (1998)
5. Beqa B, **KRIZA FINANCIARE GLOBALE : EFEKTET SHKATËRRUESE TË SAJ DHE E MAJTA**

6. Govori F.- Financë, - Prishtine2010
7. Nimani A.,- Politikat Financiare- Prishtinë 2010
8. SPIEGEL ONLINE International. 10.10.2008 dhe SPIEGEL, 17.9.2009
9. Nytimes.com.24.10.2008
10. A.Greenspan-kryetar i Rezervës Federale në vitet 1987-2006
11. Sen, 26 mars 2009.
12. M. Yunus fitues i Çmimit Nobel për Paqe për vitin 2006
Daniel Mitchel i Cato Institute, shkurt 2010
13. (Stiglitz, korrik 2008 dhe Stiglitz, dhjetor 2008).
14. Adri Nurellari-Botuar tek gazeta "shqip" Tirane 2010.
15. Ilić G., Reforme Evropske Unije – Institucionalni aspekti., Beograd 2004
16. Sadiku M., Transicioni dhe Reformat Institucionale në Kosovë, Riinvest, Prishtinë 2007
17. <http://www.evropaelire.org/content/article/2042938.html>
18. <http://www.telegrafi.com/?id=46&a=4272>
19. <http://www.setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/sq/features/setimes/roundup/2008/10/10/roundup-bs-04>
20. <http://www.noa.al/index.php/ekonomi/90-ekonomi/987-raporti-i-ri-i-fmn->
21. http://www.bbc.co.uk/albanian/regionalnews/2008/11/081126_berzh_alban

KUD 33

OPTIMIZACIJA LOKACIJE POTROŠNJE PUTEM VORONOI DIAGRAMA

*Dr.sc. Asib Alihodžić,
Dr.sc. Almir Alihodžić,
Mr.sc. Adis Alihodžić,*

Abstrakt

Rad prikazuje lokacijske probleme optimizacije koji se mogu rešiti preko Voronoi dijagrama. Osam vrsta kontinuiranih lokacijskih problema optimizacije je formulisano, a ti problemi se rešavaju kroz obični Voronoi dijagram. Problemi o kojima će biti više reči u radu su sledeći: najudaljenije tačke Voronoi dijagrama, težinski dijagram Voronoi, dijagram mreže Voronoi, Voronoi dijagram s konveksnom udaljenošću funkcije, linija Voronoi dijagrama i dijagram polja Voronoi.

Ključne reči: voronoi model, voronoi dijagram, fortune's algoritam

Uvod

Pretpostavimo da se nalazimo u nekom regionu na kojem želimo da otvorimo super-market. Neka se u tom regionu nalazi sem niza drugih objekata(kuće, fabrike, bolnice, škole itd.) i niz gotovo istih mini-marketa koji će biti neposredni konkurenti tek novo-otvorenom super-marketu. Postavlja se pitanje, kako odabrati sigurnu lokaciju na tom regionu da bi ostvarili najveći profit? Da bi dali odgovor na ovo pitanje, najpre razmotrimo koje sve pretpostavke treba da ispunjava novi market :

1. Cena robe (usluge) mora biti **“gotovo”** ista kao i u svim obližnjim super-marketima;
2. Cena isporuke robe do željenog mesta jednaka je: cena robe + cena transporta robe;
3. Cena transportovanja do željenog mesta jednaka je: euklidska udaljenost od supermarketa do željenog mesta puta fiksna cena po jedinici udaljenosti ;
4. Potrošači pokušavaju da minimiziraju krajnju cenu za dobijanje robe(usluge).

Napomenimo da gore navedene pretpostavke često nisu zadovoljene.
Npr : roba može biti u nekom od mini-marketa jeftinija u odnosu na ostale,

zatim unutar regiona transportni troškovi od jednog mesta x do drugog mjesta y **gotovo** uvek ne predstavljaju linearnu euklidsku udaljenost :

$$Dist(x, y) = \sqrt{\sum_{i=1}^n (x_i - y_i)^2}, \text{ za } x = (x_1, x_2, \dots, x_n) \text{ i } y = (y_1, y_2, \dots, y_n)$$

Glavni cilj teme koju obrađujemo baziraće se na tome kako da gornji model geometrijski interpretiramo. Gornje pretpostavke induciraju podelu područja na regione (regioni su trgovačka područja za neka mesta, gde bilo koji region sadrži tačno jedan mini-market za to mesto) tako da ljudi koji žive u istom regionu svi posećuju recimo isti mini-market. Naše pretpostavke impliciraju da ljudi kupuju robu u najbližem trgovačkom mestu što je i prirodno. Ovo znači da trgovačko područje za dato mesto (koje je fiksno) je bliže tom mestu nego bilo kojem drugom. Drugim rečima, osoba koja pripada tom mestu ne može biti bliža drugom trgovačkom području za drugo mesto.


Model koji svakoj tački pridružuje najbliže mesto zove se **Voronoi model**. Podela inducirana ovim modelom zove se **Voronoi dijagram** od datih mesta.

1. Osnovne osobine Voronoi dijagrama

Definicija 1.1: Za graf $G = (V, E)$ kažemo da je planaran ili da se može smestiti u ravan, ako se isti može smestiti u ravan tako da se ivice seku samo u vrhovima.

Primer 1.1: Ilustracija planarnog grafa K_4 i neplanarnog grafa $K_{3,3}$.

Slika 1.1. Prikaz planarnog i neplanarnog grafa




IZVOR: Proračun autora

Definicija 1.2: Region grafa $G = (V, E)$ u oznaci f je deo površi omeđen nekom konturom. Skup regija označavamo sa $F(G)$, gde je V skup svih vrhova, a E skup svih ivica.

Primer 1.2: Ovde je $F(G) = \{f_1, f_2, f_3, f_4, f_5\}$

Slika 1.2. Prikaz regiona kod planarnog grafa



IZVOR: Proračun autora

Definicija 1.3: Stepen vrha v grafa $G = (V, E)$ u oznaci $d(v)$ je broj grana incidentnih vrhu v .

Primer 1.3: $d(v_1) = 3; i = \overline{1,4}; d(v_5) = 4$

Lema 1.1: Za svaki graf $G = (V, E)$ vredi sledeća jednakost:

$$\sum_{v \in V(G)} d(v) = 2|E|$$

Dokaz: Neka je M matrica incidencije od $G = (V, E)$, $|V| = n$ i $|E| = m$, gde je:

$$d(v_i) = \sum_{j=1}^m a_{ij}, \quad a_{ij} \in \{0,1\}, \quad a_{ij} = \begin{cases} 1, & \text{ako je čvor } v_i \text{ incidentan ivici } e_j \\ 0, & \text{inače} \end{cases}, \quad M = \begin{pmatrix} a_{11} & \cdots & a_{1m} \\ \vdots & \ddots & \vdots \\ a_{n1} & \cdots & a_{nm} \end{pmatrix}.$$

Kod matrice M , čvorovi v_i su redovi ($i = \overline{1, n}$), a ivice e_j ($j = \overline{1, m}$) su kolone. Dobijamo:

$$\sum_{i=1}^n d(v_i) = \sum_{i=1}^n \sum_{j=1}^m a_{ij}$$

No, svaka od ivica e_j ($j = \overline{1, m}$) incidentna je sa tačno dva čvora v_i i v_j . Otuda:

$\sum_{i=1}^n a_{ij} = 2$, za $\forall j = \overline{1, m}$. Dakle,

$$\sum_{i=1}^n d(v_i) = \sum_{i=1}^n \sum_{j=1}^m a_{ij} = \sum_{j=1}^m \sum_{i=1}^n a_{ij} = 2 \sum_{j=1}^m 1 = 2m$$


Definicija 1.4: Voronoi diagram od F ($F = \{P_1, P_2, \dots, P_n\}$ -konačan niz od n - mesta) u oznaci $Vor(F)$ je podela ravni u n - regija tako da svakoj ćeliji odgovara

jedno mesto iz F sa osobinom da tačka Q leži u ćeliji kojoj je pridruženo mesto

$$P_k \Leftrightarrow \text{Dist}(Q, P_k) < \text{Dist}(Q, P_j), \text{ za } \forall P_j \in F, j \neq k.$$

Napomenimo da ćelija može biti poluravan ili neki konveksan poligon. Grafička ilustracija gore navedenog data je na sledećoj slici.

Slika 1.3. Prikaz udaljenosti tačke Q u odnosu na P_k



IZVOR: Proračun autora

Definicija 1.5: Bisektor $B(P_j, P_k)$ u ravni za mesta P_j i P_k je simetrala duži $P_j P_k$.

Bisektor B deli ravan na dve poluravni. Otvorenu poluravan koja sadrži P_j a ne

P_k označavaćemo sa $H(P_j, P_k)$, dok otvorenu poluravan koja sadrži P_k a ne sadrži

P_j označavaćemo sa $H(P_k, P_j)$. Ćeliju kojoj odgovara mesto P_k označavaćemo sa


$V(P_k)$. Iz gornje definicije sledi: $R \in H(P_j, P_k) \Leftrightarrow \text{Dist}(P_j, R) < \text{Dist}(P_k, R)$.

Primedba 1.1: Primetimo da vredi sledeće: $V(P_i) = \bigcap_{1 \leq j \leq n} H(P_i, P_j)$, $i \neq j$.

Sledeća grafička ilustracija demonstrira ovu primedbu za $n=3$, tj. kada su

zadati tri mesta: P_1, P_2 i P_3 .

Slika 1.4 Prikaz Voronoi ćelija $V(P_1), V(P_2)$ i $V(P_3)$



IZVOR: Proračun autora

Dakle, svaka i –ta Voronoi ćelija $V(P_i)$ dobija se kao presek $n - 1$ poluravnih.

Definicija 1.6: Područje F je konveksno ako za $\forall x_1, x_2 \in F$ i za $\forall \alpha \in [0,1]$ vektor

$$x = \alpha x_1 + (1 - \alpha)x_2 \in F.$$

Lema 1.2: Presek konveksnih skupova je konveksan skup.

Dokaz: Neka su A i B konveksni skupovi. Stavimo da je $C = A \cap B$ i pokažimo da je C konveksan. Odaberimo proizvoljno $x_1, x_2 \in C$ i $\alpha \in [0,1]$. Pokažimo da $\alpha x_1 + (1 - \alpha)x_2 \in C$. Kako su A i B konveksni i $x_1, x_2 \in C$ sledi $\alpha x_1 + (1 - \alpha)x_2 \in A$ i $\alpha x_1 + (1 - \alpha)x_2 \in B$ otuda $\alpha x_1 + (1 - \alpha)x_2 \in C$.

Definicija 1.7: Skup vektora $x = (x_1, x_2, \dots, x_n) \in \mathbb{R}^n$ koji zadovoljavaju jednačinu $\sum_{i=1}^n a_i x_i = b$ zove se hiperravan.

Hiperravan deli prostor $\mathbb{R}^n$ na dva poluprostora, pa je poluprostor određen

nejednačinama oblika: $\sum_{i=1}^n a_i x_i \leq b$ i $\sum_{i=1}^n a_i x_i \geq b$

Lema 1.3: Hiperravan je konveksan skup.

Dokaz: Sledi odmah iz definicija 1.6 i 1.7.

Lema 2.4: Poluprostor je konveksan skup.

Dokaz: Sledi odmah iz definicije 1.6 i $\sum_{i=1}^n a_i x_i \leq b$ i $\sum_{i=1}^n a_i x_i \geq b$.

Kako su sve poluravni specijalan slučaj poluprostora za $n = 2$, sledi da su poluravni konveksne. Otuda i iz **leme 2** zaključujemo da je $V(P_i)$ konveksno poligonalno područje koje je ograničeno sa najviše $n - 1$ vrhova.

2. Osnovne teoreme o Voronoi dijagramu

Vidimo sa slike 1.3 i slike 1.4 da su neke ivice duži, a neke poluprave.

Specijalno za $n = 3$ imamo sve poluprave sa zajedničkim vrhom (videti slika 1.4). Sledeća teorema daje karakterizaciju gore izloženog.

Teorema 2.1: Neka je F skup od n –tačaka u ravni koje poistovećujemo sa n –mesta u $Vor(F)$ -u. Tada vredi :

i. Ako su tačke kolinearne onda $Vor(F)$ sadrži $n - 1$ paralelni pravi i n –ćelija.

ii. Ako tačke nisu kolinearne tada $Vor(F)$ je povezan graf i njegove ivice su ili duži ili poluprave.

Dokaz : Prvi deo dokaza sprovedemo koristeći zakon kontrapozicije.

Pretpostavimo da naša tvrdnja nije tačna, tj. da $Vor(F)$ ne sadrži $n - 1$ paralelni pravi ili ne sadrži n ćelija.

a. Neka $Vor(F)$ ne sadrži $n - 1$ paralelni pravi. Označimo prave $Vor(F)$ -a redom sa $e_1, e_2, \dots, e_{n-1}$. Tada postoji prava e_i koja seče ostale $e_j (j \neq i)$. Bez umanjenja opštosti možemo pretpostaviti da je $e_i = e_{n-1}$. Kako su e_i Voronoi prave sledi da je e_i simetrala duži $P_i P_{i+1}$. Specijalno e_{n-1} je simetrala duži $P_{n-1} P_n$. Prava e_{n-2} je simetrala duži $P_{n-2} P_{n-1}$. Odavde zaključujemo da je tačka preseka pravih e_{n-2} i e_{n-1} centar opisanog kruga nad trouglom $\Delta P_{n-2} P_{n-1} P_n$. Ovo znači da tačke P_{n-1} , P_{n-2} i P_n nisu kolinearne. Kontradikcija !

b. Neka $Vor(F)$ ne sadrži n ćelija. Neka je broj ćelija od $Vor(F)$ -a manji od n . Tada na osnovu **Dirichletov principa**⁴⁰ bar dva mesta pripadaju istoj ćeliji. Kontradikcija sa definicijom 1.4.

Drugi deo kao i prvi dokazaćemo zakonom kontrapozicije. Pretpostavimo da naša tvrdnja nije tačna. Tada $Vor(F)$ nije povezan ili ivice $Vor(F)$ -a nisu ni duži ni poluprave.

⁴⁰ Dirichletov princip glasi : Ako $n + 1$ bilo kako predmeta rasporedimo u n kutija , onda bar jedna kutija sadrži bar dva predmeta.

- =====
- c. Neka ivice $Vor(F)$ -a nisu ni duži ni poluprave. Neka je ivica e $Vor(F)$ -a prava koja leži na ivici od Voronoi ćelija $V(P_i)$ i $V(P_j)$. Po pretpostavci tačke $P_1, P_2, \dots, P_n$ nisu kolinearne. Možemo smatrati i smatraćemo da su tačke P_i, P_j i P_k temena nekog trougla i da je e simetrala duži $P_i P_j$. Neka simetrala duži $P_j P_k$ seče pravu e u nekoj tački M . Tada deo f prave e (f – je poluprava sa početnom tačkom M koja leži u unutrašnjosti od $H(P_k, P_j)$) ne može ležati na ivici od $V(P_j)$, jer za proizvoljnu tačku Z sa poluprave f vredi: $Dist(P_k, Z) < Dist(P_j, Z)$. No, ovo je kontradikcija sa pretpostavkom da e leži na ivici Voronoi ćelija $V(P_i)$ i $V(P_j)$.
- d. Neka $Vor(F)$ nije povezan graf. Tada postoji Voronoi ćelija $V(P_i)$ koja deli ravan na dva dela. Zbog toga što su ćelije $Vor(F)$ -a konveksni skupovi, $V(P_i)$ sadrži prugu ograničenu sa dve prave. Ovo je kontradikcija sa c).

Lema 2.1 (Euler-ova teorema): Povezan planaran graf sa n –vrhova, m –grana deli ravan na $f = m - n + 2$ regija.

Dokaz: Dokaz ćemo sprovesti indukcijom po broju grana m . Minimalan broj grana koji sadrži povezan graf sa n vrhova je $m = n - 1$. Tada je graf drvo. Pošto drvo ne ograničava ni jednu konačnu oblast, sledi da je $f = 1$. Pa, Euler-ova formula vredi za $m = n - 1$. Pretpostavimo sada da Euler-ova formula vredi za grafove sa $m - 1$ grana. Neka je $G = (V, E)$ graf sa m ($m > n - 1$) grana i neka je f broj oblasti za $G = (V, E)$. Tada graf sadrži bar jednu konturu. Posmatrajmo jednu granu e koja pripada nekoj konturi u grafu $G = (V, E)$. Ova grana je granica za dve oblasti, pa njenim udaljavanjem iz grafa dobijamo graf $G' = G - e$

sa $m - 1$ grana i $f - 1$ oblasti. Primenjujući induktivnu pretpostavku na G' dobijamo: $f - 1 = m - 1 - n + 2 \Rightarrow f = m - n + 2$. Time je lema dokazana.


Teorema 2.2: Broj vrhova u $Vor(F)$ -u je najviše $2n - 5$, a broj ivica je najviše $3n - 6$. Ovde kao i ranije $F = \{P_1, P_2, \dots, P_{n-1}\}$, gde tačke P_i ($i = \overline{1, n}$) poistovećujemo sa mestima u ravni.

Dokaz: Ako su tačke kolinearne, onda je broj vrhova odnosno broj ivica jednak nuli, pa u ovom slučaju dokaz je trivijalan. Pretpostavimo da tačke nisu

kolinearne. Kako $Vor(F)$ ima beskonačne poluprave, nije moguće primeniti *Euler-ovu teoremu*. Stoga, dodaćemo jedan vrh v_∞ negde u beskonačnosti i

spojiti sve beskonačne poluprave $Vor(F)$ -a sa ovim vrhom. Dobiven graf označimo sa $G = (V, E)$ (videti sliku 2.1).

Slika 2.1 Prikaz povezanog planarnog grafa $G = (V, E)$



IZVOR: Proračun autora

Svakom mestu P_i ($i = \overline{1, n}$) pridružena je jeddna regija f u povezanom planarnom grafu $G = (V, E)$. Stoga $f = n$. Primenjujući *Euler-ovu teoremu* na $G = (V, E)$ dobijamo: $f = |E(G)| - |V(G)| + 2$. Na osnovu leme 1.1 imamo: $2|E| = \sum_{v \in V(G)} d(v)$. Za $n \geq 3$ svaki vrh $v \in V(G)$ ima stepen najmanje tri, jer je svaki $v \in V(G)$ dobiven kao presek tri bisektora. Otuda sledi: $2|E| = \sum_{v \in V(G)} d(v) \geq 3|V(G)| = 3|n_v + 1|$, gde je n_v -broj vrhova u $Vor(F)$ -u.

Sada konačno imamo: $2n = 2(2 + |E| - n_v - 1) \geq 5 + n_v$. Dakle, $n_v \leq 2n - 5$.

Sada iz: $|E(G)| = n + n_v + 1 \leq n - 1 + 2n - 5 = 3n - 6 \Rightarrow |E(G)| \leq 3n - 6$.
Ovim je teorema dokazana.

Napomena 2.1: Kao što znamo ivice su delovi bisektora, a vrhovi su presečne tačke bisektora. Kako svi bisektori ne definišu ivice $Vor(F)$ -a, niti svi preseki bisektora ne definišu vrhove $Vor(F)$ -a, teorema 2.3 daće karakterizaciju tih slučajeva.

Definicija 2.1: Najveći prazan krug sa centrom u tački Q u oznaci $C_F(Q)$ je krug koji ne sadrži nijedno mesto $P_i \in F$ u svojoj unutrašnjosti.

Teorema 2.3: Neka je F skup od n tačaka u ravni koje poistovećujemo sa n mesta u $Vor(F)$ -u. Tada vredi:

- Tačka Q je vrh $Vor(F)$ -a $\Leftrightarrow C_F(Q)$ sadrži bar tri mesta(tačke) na svom rubu.
- Bisektor između mesta P_i i P_j definiše neku ivicu $Vor(F)$ -a $\Leftrightarrow$ postoji neka tačka Q tako da $C_F(Q)$ sadrži tačno dva mesta P_i i P_j na svom rubu.

Dokaz: a) ($\Leftarrow$) Pretpostavimo da $C_F(Q)$ sadrži tri mesta (tačke) na svom rubu.

Neka su ta mesta P_i, P_j, P_k redom. Tada su ta mesta temena trougla $\Delta P_i P_j P_k$ oko koga je opisan krug $C_F(Q)$. Dakle, Q je tačka preseka simetrala stranica datog trougla. Kako je $Dist(Q, P_i) = Dist(Q, P_j) = Dist(Q, P_k) = r$ (r – poluprečnik kruga $C_F(Q)$) sledi da Q leži na rubu svake Voronoi ćelije $V(P_i), V(P_j), V(P_k)$.

Stoga je Q vrh $Vor(F)$ -a.

($\Rightarrow$) Neka je tačka Q vrh $Vor(F)$ -a. Tada je Q incidentan sa barem tri ivice $Vor(F)$ -a i sem toga sa barem tri Voronoi ćelije $V(P_i), V(P_j), V(P_k)$. To znači da

vrh Q mora da je jednako udaljen od mesta P_i, P_j, P_k . Tačke P_i, P_j, P_k jednoznačno određuju krug $C(Q)$ sa centrom u Q . Pokažimo da je krug $C(Q)$ isto što i $C_F(Q)$. Pretpostavimo suprotno, tj. $C(Q)$ sadrži mesto P_i u svojoj unutrašnjosti. Tada tačka Q nije centar četverougla opisanog oko temena P_i, P_j, P_k, P_i . Otuda, Voronoi ćelije $V(P_i), V(P_j), V(P_k)$ ne mogu se susresti u Q . Kontradikcija!. Dakle, $C_F(Q)$ sadrži bar tri tačke na svom rubu.

b) ($\Rightarrow$) Pretpostavimo da postoji tačka Q u ravni tako da $C_F(Q)$ sadrži tačno dva mesta P_i, P_j na svom rubu. To znači da $Dist(Q, P_i) = Dist(Q, P_j) < Dist(Q, P_k)$, gdje $k = \overline{1, n}$ i $k \neq j$. Ovo dalje znači da Q leži na simetrali duži $P_i P_j$. Tada je Q vrh ili Q leži na ivici od $Vor(F)$ -a. Prvi deo ove teoreme a) implicira da Q ne može biti vrh. Otuda Q mora ležati na ivici od $Vor(F)$ -a.

($\Rightarrow$) Neka bisektor za mesta P_i i P_j definiše Voronoi ivicu. Sada najveći prazan krug sa centrom u Q (Q -proizvoljna tačka na ivici od $Vor(F)$ -a) mora sadržavati P_i i P_j na svom rubu i nijedno više mesto. Ako bi $C_F(Q)$ sadržavao još neko mjesto P_k na svom rubu, tada bi Q na osnovu prvog dela teoreme a) bio vrh. No, kako je svaki vrh incidentan sa najmanje tri Voronoi ivice, sledi Q je incidentan sa barem tri ivice, što je kontradikcija sa izborom tačke Q .

“Computational Geometry in C, Cambridge”, University Press.

KUD 331.24(496.51)

SKEMA PENSIONALE NË KOSOVË: DILEMAT

*MSc. Bashkim Nurboja
bakinurboja@yahoo.com*

Abstrakt

Në Kosovë skema pensionale ka filluar nga pika zero. Modeli i sistemit pensionale është marr nga Kili me rekomandimet e bankës botërore. Shumë shtete këtë e shohin si një model moderne të pensioneve. Ku, stabiliteti fiskal nuk rrezikohet nga vjetërsia e popullatës që është një problem akut në shtetet e zhvilluara, dhe ku mundësohet krijimi i fondeve për investime në tregjet kapitale dhe financiare. Por, në rastin e Kosovës sa është e arsyeshme që të kemi një skemë të tillë? Ne pohojmë që skema pensionale e Kosovës është e qëndrueshme. Që na rastin e Kosovës është Trusti pensionale. Me politizimin e parave të grumbulluara nga Trusti rritet rreziku për të ardhmen e pensioneve.

Fjalët kyçe: Pension, paguaj gjatë procesit (pay as you go), skema investuese (funded sheme)

JEL Klasifikimi: G23, H55.

1. Hyrje

Në Kosovën e pas luftës, tema e pensioneve ka qenë okupim i të gjithëve. Nëse ke qenë pensionist ke mbetur pa pension, nëse nuk ke qenë pensionist ki menduar se si do të mbi jetojë në kohën kur do të pensionohem. Pensioni në shumë shtete shikohet si investimi i dytë më i rëndësishmi pas shtëpisë. Në Kosovë ndër ligjet e para të cilët kanë kaluar në parlament nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), ka qenë ligji për pensione. Ky ligj përbëhet nga tri komponentë dhe është rekomanduar nga Banka Botërore (BB), ku shteti Kilian është marr si model⁴¹. Qëllimi i sistemit pensional në Kosovë ka qenë arritja e disa objektivave:

- Lehtësimi i konsumit duke i lejuar punëtorët të ndajnë të ardhura për vitet ardhshme të pensionimit

⁴¹ Kili ka qenë një ndër shtetet e para të cilët e kanë përdorur formën e skemes investuese (Kursime pensionale)

- Funksionin e sigurimi duke lejuar pjesëmarrësit të sigurohen kundër riskut i.e. pasiguria e jetëgjatësisë, invaliditetit apo përkrahja e të gjallëve nëse vdekja ndodh.
- Rishpërndarja e pasurisë ndër gjenerata dhe brenda gjeneratës, nga të pasurit tek te varfëritë

Megjithatë, se a do ti arrin këto objektiva sistemi pensionale, koha do të tregoj. Në shumë literatura vërehet se intervenimi i shtetit për ti arritur këto objektiva është i domosdoshëm, për shkak të dështimeve të tregut (informatave asimetrike). Shteti i Kosovës duhet të sigurohet së pari që tregu i anuiteteve të ekzistoj, me një konkurrencë të mirëfilltë. P.sh. në Kosovë vetëm kompania sigurimeve Dukagjini është e licencuar për të shitur anuitete. Me një kompani si ofertuese e anuiteteve, mund të supozohet se çmimi do të jetë mbi koston margjinale; që nënkupton që pensionerët do të nën shërbehen. Këto problem ekzistojnë në skemën pensionale që quhet “investuese” siç për momentin ekziston në Kosovë. Por ekziston edhe formë tjetër e sistemit pensionale që nuk i ka këto probleme por, megjithatë edhe ky sistem ka probleme të natyrave të ndryshme.

Dilema të cilën do të elaborohet në këtë punim është se zgjedhja e Kosovës për sistem investues të pensionit a është e duhur dhe pse politizimi i fondit pensional e rrezikon të ardhmen e pensionit.

Në sesionin e dytë do të shtjellohet literatura për sistemet e pensioneve PAYG dhe “investuese”, rreziqet që ekzistojnë nën këto skema. Në sesionin e tretë do të elaborohet pse Kosovës i konvenon skema “investuese” dhe se si politizimi i fondit pensional rrezikon pensionet. Në fund to të paraqitet konkluzioni.

2. Literatura PAYG vs skemës “investuese”⁴²

Racionaliteti për ofrimin e pensionit në formë private apo nëpërmjet sigurimit social është të ofroj të ardhura gjatë moshës së pensionit. Edhe pse, të ardhurat mund të arrihen nga investimet tjera, në mungesë të pensionit, është vështirë të thuhet se çfarë do të ishin të ardhurat e individit. Qartë, individët do të kishin strategji të ndryshme të akumulimit gjatë jetës në mungesë të pensionit. P.sh. në mungesë të pensionit, pasiguria për jetëgjatësinë, njerëzit që janë risk-avers do të kursenin para më shumë se që është e nevojshme në përgjithësi. Kështu, rreziku nga jetëgjatësi është lindur për ofruesit e pensionit qofshin ata shtetëror apo privat. Veçoria e pensionit është të ofroi të ardhura për ata që pensionohen, megjithatë të ardhurat ndryshojnë nga personi në person. Të ardhurat varen nga kontributi që bëhet në skemën pensionale. Këto kontribute mund të përdoren si investime për konsum të më vonshëm, në rastin e skemës investuese. Apo, në rastin e skemës PAYG këto kontribute përdoren për të

⁴² Në disa literature quhet kursime pensionale, por në këtë punim do të përdoret si term skema investuese.

paguar pensionet e gjeneratës të cilët veç janë duke e gëzuar pensionin. Shihet qartë se ofruesit e pensioneve janë lloj i veçantë i mjeteve të kursimit. Si argument tjetër për ekzistimin e pensionit është rishpërndarjen brenda dhe gjatë gjeneratave, megjithatë, rezultatet e rishpërndarjes janë komplekse dhe të pa qarta (Whitehouse et al. 1994).

Në mënyrë që qeveria me ofrua pension, duhet to ofroj skemë që iu mundëson njerëzve të kontribuojnë dhe t'i garantojnë benefitet. Edhe pse përfshirja e qeverisë është e rëndësishme, shteti nuk ka nevojë të mbledh kontributet dhe të paguaj benefitet. Shteti mundet me të legjitim që entitetet tjera ta bëjnë këtë detyrë (trusti, bankat, kompanitë e sigurimit etj), por shteti në çdo kohë duhet ti ketë nën vëzhgim këto entitete, sepse dështimet e tregut siç është informatat asimetrike mund të qojnë deri të pasojat sociale.

Zakonisht janë dy lloje sistemeve të pensionit: paguaj gjatë procesit PAYG dhe skema investuese (funded sheme). Në vazhdim do të shtjellojmë për veçorit e secilës.

2.1. Skema pensionale “paguaj gjatë procesit” (ang. Pay-as-you-go)

Skema pensional PAYG përdoret nga shumë shtete në botë. Në këtë skemë pensioni iu paguhet gjeneratës së pensionerëve nga kontributet e punëtorëve të tanishëm nëpërmjet taksave i.e. në mënyrë implicite një pjesë e taksave dedikohet për pension. Në këtë skemë benefitet llogariten duke i ndërlidhur të ardhurat gjatë karrierës. Kjo skemë edhe pse është në përdorim në shumë vende, ekzistojnë shumë shtete që dëshirojnë ta ndryshojnë në skemë “investuese”. Arsyeja primare është raporti i varshmërisë⁴³ si rezultat i ndryshimeve demografike, që mund ta bënë këtë skemë të paqëndrueshme. Kjo do të rezultojë në rritje të shpenzimeve publike, si pasojë e menaxhimit të taksës. Këtë argument do të tentoj ta shpjegoj duke e shfrytëzuar modelin e Barr (2000).

Konsidero skemën PAYG në balancë, ku:

$$sWE=PR \quad (1)$$

Ku s = norma e kontributit në PAYG, W = paga mesatare nominale, E = numri i punëtorëve, P = pensioni mesatar nominal, dhe R = numri i pensionerëve. Në këtë skemë ekziston një ndërlidhje e balancume në mes kontributit momental të punëtorëve dhe pagesave të pensionit.

Për ta ilustruar efektin e ndryshimeve demografike, supozoni që një gjeneratë e madhe punëtorëve në periudhën 1 përcjellët nga një gjeneratë e vogël e punëtorëve në periudhën 2. Në këtë rast, gjenerata e vogël në periudhën 2 duhet ta financoj gjeneratën e madhe të periudhës 1. Nga ekuacioni 1 mund të shohim se nëse kemi zvogëlim të natalitetit, E , atëherë rregullimi i bilancit mund të bëhet në mënyra të ndryshme. Një mënyrë është duke i zvogëluar mesataren e pensionit P duke e bartur koston të pensionerët, por kjo thyen premtimin që i është bërë

⁴³ Njerëzit mbi 65 vjeç pjetu më njerëzit nga 18-64.

pensionerëve. Mundësi tjetër është duke e rritur normën e kontributit ,s, duke e kaluar koston në punëtorët e tanishëm. Por, kjo mund të shkaktoj efekt nxitës avers në punë si shkak i efektit të zëvendësimit. Alternativa mund të arrihet duke bërë ndryshime në dy anët e ekuacionit 1. Barr (2000) sugjeron që ligjet duhet të dizajnohen që të inkurajojnë rritjen e produktivitetit për punëtorë. Kjo mund të arrihet në dy mënyra:

1. Rritja e mesatares së pagës nominale W (në ekuacionin 1)- kjo arrihet duke
 - Ofruar teknologji më të avancime nga e cila mund të rritet outputi për punëtor, apo
 - Mundësi për punëtorë të fitoj njohuri të reja relevante për punën e tyre me anë të edukimit
2. Rritja e ofertës së punëtorëve, E, që mund të arrihet duke:
 - Duke shtyrë moshën e pensionimit
 - Ofruar kushte më të mira për femrat e martuara

Si rezultat i mundësisë për të perfeksionuar skemën pensionale PAYG shumë ekonomist preferojnë këtë skemë nga ajo investuese. Stiglitz dhe Orszag (1999) argumentojnë se dëshira që të ndryshojnë skemën nga PAYG në atë investuese nuk ka bazë të qartë teorike. Sipas Feldstein (1995) pohimi që skema investuese është superiore ndaj asaj PAYG është e gabueshme sepse neglizhohen kostot e tranzicionit nga një sistem në tjetrin. Për ta bërë këtë qeveria duhet të mendojë se si të paguaj pensionerët që veç janë në PAYG. Që ta bëjë këtë qeveria duhet të rritë taksat apo të lëshon obligacione. Kjo nënkupton që kosto është e pashmangshme sepse dikush duhet ta paguaj tranzicionit. Më shumë, Boldrini et al. (1999) pretendon se PAYG sistemi është i domosdoshëm për arritjen e efikasitetit dhe qëndrimin e rritjes në periudhë afatgjatë. PAYG skema është më përshtatshme për individët me të ardhura të vogla apo ata që kanë qenë të papunësuar gjatë karrierës.

PAYG skema e cila ekziston në shumë shtete është shumë e vështirë që do të ndryshohet në atë investuese për arsye të kostove të tranzicionit. Megjithatë, më disa ndryshim, PAYG skema do të luajë ende një rol të rëndësishëm në shumë shtete.

2.2 Skema pensionale “investuese” (ang. funded scheme)

Skema pensionale investuese nënkupton një llogari individuale ku punëtori kontribuon një përqindje fikse nga të ardhurat. Shuma e parave që akumulohet në këtë fond investohet në tregje të kapitalit apo në obligacione shtetërore, kjo varret nga niveli i risk-aversionit të menaxhmentit të fondit. Në kohën e pensionimit, pensioni i secilit pensioner përcaktohet nga shuma se është kontribuar në fond në emër të tij, plus të gjitha të ardhurat që janë akumuluar si

=====
 pjesë e investimit të fundit pensional⁴⁴. Nga kjo shihet se për dallim nga PAYG skema investuese e tejkalon problemin e ndryshimit në demografi duke e ndërlidhur kontributin me benefitet. Kështu që, në kohën e pensionimit individ mund ta blejë anuitetin më shumë e tërësishme që është akumuluar në llogarinë e tij. Si skemë pensionale e ashtu quajtur investuese është bërë shumë e dëshirueshme sepse duket që mund të ballafaqohet me qëndrueshmërinë që në skemën PAYG kishte dyshime. Nuk është veç ndryshime demografike që e rrite nevojën për skemën investuese, ka më shumë arsye. Feldstein dhe Rangelova (2001) argumentojnë se nën skemën investuese individët mund ti plotësojnë preferencat duke qenë në gjendje që të alokojnë pasurinë e tyre të pensionit në asete të ndryshme. Për më shumë, Feldstein (1995) ofron listën e kushtëve nën cilat ndryshimi nga PAYG në atë investuese do ta rritë mirëqenien sociale: (i) normë të rritjes së ekonomisë, (ii) norma e kthimit në kapital më e madhe se norma e rritjes së të ardhurave nacionale, (iii) norma e kthimit në kapital më e madhe se norma e kohës së preferencave. Ka evidenca [Aaron (1966), Feldstein (1995), Hemming (1998), Miles (2000) Barr and Diamond (2006)] që tregojnë se kushti (i) dhe (ii) lehtësisht plotësohen. Shumat e mëdha të kursimeve privat drejt tregjeve financiare në dekadën e fundit sugjerojnë që edhe (iii) qëndron. Arsye tjetër për skemën investuese është se kostot e pensionit në të ardhmen mund të llogariten lehtësisht. P.sh. në skemën investuese në momentin e fillimit të kontributit fitohet e drejta për pension, kështu norma e kontributit e reflekton të drejtën e fituar për pension.

Edhe pse kjo skemë duket e dëshirueshme, ka shumë rreziqe që ndeshemi nën këtë skemë:

Rreziku nga tregu i anuiteteve: nën skemën investuese, individ mund të blenë anuitetin me shumë e mbledhur në llogari të tij, megjithatë, kjo varet nga pritshmëria e periudhës së pensionimit (jetëgjatësia në kohën që individ del në pension) dhe norma e interesit që kompania e sigurimit pret të fitojë. Këto variabla janë shumë të pa sigurta. P.sh. dy individ me të ardhura të njëjta dhe kontribute mund të përfundojnë me pensione të ndryshme, varësisht nga norma e interesit në kohën e pensionimit. Siç Callund (1999) ka llogaritur për Kilin, kolapsi i normës së interesit në kohë afatgjate në vitet 1996-1998 ka pasur efekt dramatik në normën e anuitetit. Pastaj kemi rrezikun nga inflacioni që mund ta ulë vlerën e akumuluar, megjithatë, gjatë kohës së kontributeve në fond, menaxherat e fondit mund të përdorin instrumente financiare për tu mbrojtur nga inflacioni. Por, pasi që anuiteti blehet, mbrojtja nga inflacioni në kohën pas-pensionimit është e pa kompletim dhe e shtrenjtë. Miles (2000) sugjeron që kontrata efiçente e anuiteteve e rrite mirëqenien.

Rreziku i investimit: në skemën investuese të gjithë risku bie mbi vetë kontribuuesin. P.sh. gjatë investimeve të parave të akumuluar kemi përformim të mirë të fondit, atëherë fondi juaj do të rritet, por në rast se investimet

⁴⁴ Fondi i akumuluar mund të diversifikohet në portfolio të ndryshme p.sh. obligacione, aksione etj. Atëherë nga këto investime do të reflekton niveli i pensionit në kohën e pensionimit.

përformojnë dobët fondi juaj do të zvogëlohet. Miles (2000) duke shfrytëzuar të dhëna historike nga tregu letrave Evropian tregon që disa grupmosha do të fitojn shumë pak apo ndoshta edhe do të kenë kthim negativ.

Kosto administrative: zakonisht këto shpenzime konsiderohen si sekondare sepse njerëzit fokusohen në performancën e aseteve. Megjithatë, James et al. (2001) ka llogaritur që shpenzimet administrative duket që zvogëlon pensionin për 15 deri 30 përqind. Sipas James rreth gjysma janë shpenzime të marketingut, dhe një pjesë e madhe është komision. Poashtu, zvogëlim në pension ndodhë nëse ndaloni të kontribuoni për shkak të papunësisë, sëmundjes apo invaliditetit. Kjo ndodhë se shpenzimet administrative nuk ndalojnë edhe nëse ndalojnë kontributet.

Nga këto mund të shohim se asnjë skemë nuk është imune ndaj riskut. Megjithatë, skema investuese është më dëshirueshme në këtë dekadën e fundit për shkak se e tejkalon problemin e ndryshimeve në demografi. Më shumë, fondet e mbledhura nga skema investuese kanë luajtur rolë shumë të rëndësishëm në tregjet financiare. Poashtu, në skemën investuese njerëzit mund të përcjellin kontributet të cilat i bëjnë dhe ti konsiderojnë si asete që do ti shfrytëzojnë gjatë pensionimit. Megjithatë, skema investuese përballet me problemet që i përmendem: tregu i anuiteteve, risku nga investimet dhe nga shpenzimet administrative.

3. Skema pensionale në Kosovë

Në Kosovë skema pensionale është e ndërtuar prej tri shtylla. Shtylla e parë⁴⁵ konsiderohet si skeme e Beveridge ku të gjithë njerëzit që arrijnë moshën e pensionit, 65 vjet, duhet të kenë drejt në pensionin shtetëror. Ky nivel i pensionit në Kosovë deri vonë ka qenë 40 euro, ku është parapa që të siguroi vetëm 2100 kaloritë e nevojshme ditore për një person. Arsyeja për këtë përfitim të sheshtë për të gjithë që arrijnë moshën 65 vjet se sa veç atyre që kanë kontribuar në skemën pensionale të Beogradit është bazuar mbi disa implikime: mbulim i përgjithshëm për ata që rrallë kanë qenë të paguar; plotësimi i principit të komponentës së parë, shmangia nga varfëria. Megjithatë, kjo shtyllë përbën janë të ulëta 2 % të GDP në krahasim me shtetet e OECD që shpenzojnë nga 10% deri në 20% të GDP (Snelbecker 2005). Shtylla e dytë e cili konsiderohet si më i rëndësishmi ku punëtorët duhet të kontribuojnë 5% të pagës bruto dhe në të njëjtën kohë ky veprim duhet të ndodhë edhe nga punëdhënësi me 5%. Kjo përqindje mund të rritet deri në 15% nga punëtori dhe 15 nga punëdhënësi në mënyrë vullnetare, por 5% është obligues me ligj. E fundit, shtylla e tretë është forma më pak e zhvilluar në Kosovë që quhet pensioni suplementar, kjo bëhet në baza vullnetare. Ky kontribute në Kosovë mund të bëhet në trustin pensional apo edhe në kompanitë private të cilat janë të licencuar nga Banka qendrore për mbledhjen e pensionit suplementar.

⁴⁵ Në këtë punim bëhet analiza për shtyllën e dytë e cila konsiderohet më e rëndësishmia.

Duke u nisur nga struktura e popullsisë së Kosovës që shihet në tabelën 1, që persona mbi 65 vjeç janë diku rreth 4.7%, ndërsa 63% janë të moshës së punës (Riinvest 2005). Sipas Riinvestit (2005) norma e rritjes së popullsisë 1.6-1.8 % për vit, ku deri në 2015 numri i Kosovarëve pritet të arrijë në 2.4 milion. Edhe pse Kosova ka normën e rritjes më të madhe nga shtetet OECD, megjithatë norma e rritjes ka filluar të zvogëlohet (shif. Fig 1). Kjo është një ndër faktet se skema PAYG nëse jo tash në të ardhmen do të shkaktojë probleme financiare mbi buxhetin e Kosovës. P.sh. nëse sot raporti i varshmërisë kishte me qenë 11 punëtor për 1 pensioner sipas llogarive të UNMIK-ut (shif. Tabelen 2) tregon që me zvogëlimin e normës së rritje së popullsisë ky raport do të zvogëlohet. Si rezultat i kësaj nëse e shikojmë ekuacionin 1 atëherë qeveria duhet të ngrit taksat për gjeneratat e ardhshme që të jetë në gjendje të paguaj pensionet për punëtorët që punojnë në këtë kohë.

Problem tjera që do të shkaktoheshin nëse skema PAYG kishte me qenë në funksion është se raporti shumë i madh në mes atyre që punojnë dhe pensionerëve do të detyronte qeverinë që të krijoj një fond akumulues, ku do të menaxhohet nga qeveria e cila çdo herë është vërtetuar se objektivat janë rizgjedhja në qeveri se sa mirëqenia e popullatës. Për ma shume, punësimi informal do të ndikonte në mënyrë të kundërt punëtorët formal. P.sh. kur qeveria i bën planifikimet sa para i nevojiten të financoj pensionerët, qeveria bazohet në punëtorët formal të cilët paguajn taksa, deri sa ata informal i shmangën taksës, atëherë baza e taksës rritet për këta formal dhe kështu kjo ndikon që punëtorët formal të kalojnë në punësim informal, që në mënyrë më të shpeshme asaj takse.

Table 1. Struktura e popullsisë në Kosovë

Përshkrimi	Numri	Përqindja
Popullata*	2.500.000	100%
Prej 0-15 vjeç	807.500	32.3%
Prej 16-64 vjeç	1.575.000	63.0%
Mbi 65 vjeç	117.500	4.7%
Popullata në Kosovë	2.050.000	100%

* Përfshirë edhe ata që kanë emigruar

Burimi: Vëzhgimi i shtëpiave, Dhjetorë 2002

Number of live births that average women gives during her life




Figura 1. Numri i lindjeve që mesatarisht një femër bën gjatë jetës saj.
Burimi: llogarit e Riinvest

Tabela 2. Parashikimi i numrit të pensionerëve

Viti	2001	2005	2010	2015	2020	2025	2030	2035	2040	2045	2050
Mbi 65 vjeç	131,548	146,436	175,732	209,529	249,456	297,499	334,890	374,888	427,772	500,032	586,085
Pjesë e popullatës	5.8%	6.0%	6.6%	7.4%	8.2%	9.1%	9.6%	10.0%	10.7%	11.9%	13.2%

Burimi: llogarit e UNMIK-ut

Skema pensionale “investuese” në anën tjetër nuk ndikohet nga ndryshimet demografike që nga figura 1 shifet se nuk është immune. Megjithatë, në rrethanat e Kosovës ku pas luftës, institucionet kanë qenë në formim sipër skema investues e detyron qeverinë që të ndërtojë një entitet të pavarur në mirëbesim “Trust” të kontribuesve. Sipas ligjit ky entitet e ka shumë qartë se ku dhe në çfarë asete i lejohet të investoj. Në këtë skemë, nga perspektiva e qeverisë është më mirë se risku ka kaluar në anën e kontribuesve, të cilët nëse investimit nuk ofrojnë kthim të mirë atëherë kjo do të reflekton në pensionin e tyre në të ardhmen, apo e kundërta nëse ofrojnë kthim të mirë ata do të shpërblehen me pension të mirë në të ardhmen. Tjetra, pasi që rrjetin e sigurimit social e mbulon shtylla e parë, shtylla e dytë apo skema investuese bazohet në parimin se sa kontribuon aq edhe do të përfiton kur pensionohesh që në parim është një zgjedhje e drejtë.

Nëse e shikojmë historinë e pas luftës dytë botërore në Kosovë asnjë gjeneratë nuk e ka përjetuar pensionin deri në fund për shkaqe politike. Kjo mund të ndikon në besimin e popullatës dhe ti bëjnë ata që kursimet ti bëjnë në mënyrën individuale a jo duke u bazuar në sistemin pensional. Ndërsa, me

=====

skemën pensionale ku kontributet regjistrohen dhe kthimet apo humbjet nga investimet evidentohen dhe në fund të vitit secili kontribues e merr pasqyrën e vet dhe sheh se pasuri që do ta shfrytëzon në të ardhmen iu ka akumuluar. Kjo kontribuesin do të bënë që të ndihet më konfident për vazhdimin e kontributeve dhe zvogëlon mundësin për kalim në punësim informal. Për më shumë, të dhënat e ndryshme botërore tregojnë që kthimi nga investimet, mesatarisht, është më i madh se norma e rritjes së pagës nominal, që na tregon përfitimit nga skema investuese janë më të mëdha se sa nga skema PAYG. Shume nga këto fakte tregojnë se skema investuese është shumë më e preferuar në rastin e Kosovës se sa PAYG.

Fondet e mbledhura në skemën investuese nuk konsiderohen si fonde për zhvillimin ekonomik të vendet, edhe pse shpesh qeveritë tentojnë ti shfrytëzojnë për atë qëllim. Fondet duhet të kenë objektiv kontribuesin dhe mirëqenien e tij. Në rastin e Kosovës politizimi i fondit pensional e rrezikon pensionet. Duke u nisur nga ligji për pensione që e përcakton çfarë kushte duhet të plotësohen për investim të fondit dhe obligimet ndaj kujdestarëve të këtij fondi, që investimet duhet të bëhet vetëm në ato kompani që janë të regjistruara në tregje të kapitalit nëpër vendet e OECD dhe që janë të ranguara nga agjencitë e vlerësimit të riskut me një risk jo më të ultë se A dhe mund të investohet në instrumente tjera p.sh. obligacione apo bona te thesarit etj. Por të gjitha investimet paraprakisht duhet ta kenë vlerësimin riskut nga agjencitë e riskut. Në Kosovë nuk ekziston tregu i kapitalit, ku kompanitë mundën me u regjistrua dhe të dhënat me qenë transparente. Në Kosovë nuk ekziston asnjë mundësi për investimin këtyre fondeve, për pos në Bankat komerciale. Andaj, me politizimin e fondit ku ngritën zërat se fondi duhet të investohet në Kosovë dhe ti kontribuojë zhvillimit ekonomik, pa u krijuar kushtet, jo vetëm ato elementare që plotësojnë nevojat ligjore, por duhet të krijohen kushtet që përfitimit e fondit të korrespondojnë me riskun.


Komentet që shpesh dëgjohen nga politikanët është se parat duhet të kthehen dhe të depozitohen në banka. Kjo do ta rritet ofertën e parave dhe do të ndikojë në uljen e normës së interesit, dhe në vazhdim do të kemi rritje të investimeve dhe kjo do të ndikojë në rritje ekonomike. Kjo retorik se si politikanët e shohin rritjen ekonomike mësohet në lëndën Makroekonomia në studimet deri diplomime. Por, të gjithë nuk marrin parasysh se ky model në këtë lëndë shpjegohet “caeteris paribus”. E në Kosovë shumë gjëra (infrastruktura ligjore, produktiviteti, inovacionet etj) tjera duhet të përmirësohen që do ta zvogëlofshin normën e interesit. Kemi shembullin e fundit ku qeveria i sjelli 300 milion nga fondi i privatizimit dhe norma e interesit nuk ndryshoj fare. Ndërsa, parat e mbledhura në fond pensional që objektiv e kanë akumulimin sa më të madh për përfitime të kontribuesve duhet të investohen në ato vend dhe në ato asete ku përfitimet janë sa më të mëdha duke e marr parasysh riskun.

Rreziqet që mund të vijnë nga politizimi i fondit që kërkon të investohet brenda Kosovës janë zvogëlimi i pasurisë kontribuesve duke e marr parasysh koston oportune, dhe zhvendosja e të punësuarve formal në punësimin informal.

P.sh. edhe pse është vështirë të parashohim të ardhme, në mënyrë hipotetike mbi disa supozime mund të parashohim të ardhurat e një pensionerët në çmimet e sdit.

Supozimet

- Të ardhurat vjetore 2640€ (220€ mujore, paga mesatare në Kosovë)
- Rritjet nga investimi: Pensioni juaj do të rritet nga 7% në vjet deri në kohën kur pensionoheni
- Inflacioni: Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI)do të rritet nga 2.5% për vjet deri sa të pensionoheni
- Rritja e kontributit tuaj çdo vjetë do të rritet nga 2.5%
- Jetëgjatësia pas pensionim në moshën 65 vjeç është 14 vjet.



*Figura 2. Llogaritja e pensionit në çmimet e sdit
Burimi: Llogaritur nga unë*

Sipas figurës 2 mund të shihet se punëtorët që iu kanë bashkangjitur trustit në moshën 40 vjeçare, kur të pensionohen do të marrin pension 92€ në muaj me çmimet e sdit, kjo shumë është 42% e pagës së sotme. Po ashtu, në fig.2 mund të shihet edhe për gjenerata të ndryshme. Kjo tregon se gjenerata që sot punon dhe është e vetëdijshme se pensioni në të ardhmen vështirë që do ti mbulon nevojat e tyre në kohën e pensionit. Kjo llogari hipotetike po supozon se rritja reale e investimit është 4.5%, që është shumë optimale duke e pasur parasysh nivelin e riskut. Por, nëse i kthehemi kërkesës së politikanëve që parat e fondit të kthehen në Kosovë dhe të investohen në Bankat komerciale që maksimumi i interesit në depozita që do ta paguajnë bankat janë 5.7% në vlerë nominale. Që nëse shikohet në vlera reale, duke e marrë parasysh inflacionin e

=====

këtyre viteve të fundit, investimet do të kishin kthim negativ. Kjo si rezultat do të detyronte kontribuesit që të gjejnë mënyrë të shkëputen nga ky fond, i cili jo që nuk është duke e rritur fondin por është duke e zvogëluar. Si pasojë pensionet do të rrezikohen sepse fondi i kontribuesit do të zvogëlohet dhe kjo do të shtyj kontribuesin që të kalojë në punësim informal, në mënyrë që ti menaxhojë kursimet vetë për të ardhmen.

Përfundimi

Skema pensionale është shumë e rëndësishme për një shoqëri, por ndryshimet që ndodhin në demografi dhe në ekonomi i kanë dhënë rëndësi edhe organizimit të skemës pensionale. Paraqitem se modeli i vjetër i skemës pensionale PAYG edhe pse është në përdorim nga shumë shtete po tentohet të përmirësohet apo ndryshohet skemën investuese.

Në skemën PAYG ndryshimet në demografi kanë luajtur një rolë të rëndësishëm, ku në shumë shtete ka shkaktuar jostabilitet financiar, sepse me vjetërsinë e popullatës shpenzimet buxhetore të shtetit janë ngritur shumë. Si alternativ, paraqitet skema investuese, ku i tejkalon problemin e demografisë por megjithatë edhe kjo skemë i ka riskun e vetë siç janë: tregu i anuiteteve, risku investimeve dhe kostot administrative.

Megjithatë, Kosova si një shtet i ri që si dilemë cilën skemë ta përdorë është vendosur për skemën investuese si model modern për pensione. Ku në edhe mund të pohojmë se është vendim i duhur për arsye se as Kosova nuk është immune ndaj ndryshimeve demografike, ku gjeneratat do të fillojnë të vjetërsohen dhe kjo skemë e tejkalon këtë problem. Për ma shumë, kjo skemë si e tillë është e ndarë nga vendimet shtetërore dhe si objekt kryesorë ka kontribuesin.

Ndikimet politike se fondi investues duhet të investohet në Kosovë rrezikon pensionet në të ardhmen dhe nuk do të ndikojë në rritjen ekonomike deri sa nuk të përmirësohen parametrat tjerë që i nevojiten një ekonomie të mirëfilltë. Për më shumë, nëse fondi pensional investohet në Bankat komerciale në Kosovë ku në kthim real të investimeve do të jetë negativ kjo do të rrezikon zhvendosjen e të punësuarve nga punësimi formal në atë informal.

Literatura

Aaron, H. J. (1966), "The social insurance paradox", *Canadian Journal of Economics and Politics Science*, vol. 32, pp. 371-4.

Barr, N. (2000) "Reforming Pensions: Myths, Truths, and Policy Choices",. IMF Working Paper No. 00/139

Barr, N., and Diamond, P. 2006 "The Economics of Pensions" *Oxford Review of Economic Policy*

Boldrin, M., Dolado, J., Jimeno, J., and Peracchi, F., (1999) "The Future of Pension Systems in Europe: A Reappraisal," *Economic Policy*, forthcoming.

Callund, D (1999), "Chile: Controversy, Difficulty and Solutions," *The Geneva Papers on Risk and Insurance-Issues and Practice*, Vol. 24, pp. 528-33.

Feldstein, M. (1995). "Would Privatizing Social Security Raise Economic Welfare?," NBER Working Paper No. 5281.

Feldstein, M and Rangelova, E. (2001), "Individual Risk in an Investment-Based Social Security System," *American Economic Review*, 91, 4, 1116-1125.

Hemming, R., (1998), "Should Public Pensions be Funded?," IMF Working Paper No. 98/35

James, E., James, S., and Vittas, D. (2001). "Administrative Costs and the Organization of Individual Retirement Account Systems: A Comparative Perspective." in *New Ideas About Old Age Security*, ed. R. Holzmann and J. Stiglitz, Washington DC: World Bank.

Miles, D (2000) "Funded and Unfunded Pension Schemes: Risk, Return and Welfare", CESifo Working Paper Series No. 239.

Orszag, P., and Stiglitz, J., (1999) "Rethinking Pension Reform: Ten Myths About Social Security Systems" *The World Bank, Averting the Old Age Crisis: Policies to Protect the Old and Promote Growth* (Oxford University Press: Oxford, 1994).

Riinvest (2005) "Profili Socio-Ekonomik i Kosovës dhe Sfidat e Zhvillimit" Instituti për hulumtime

Snelbecker, D., (2005) "Pension Reform in Eastern Europe and Euroasia: Experiences and Lessons Learned", USAID Workshop for Practitioners on Tax and Pension Reform Washington, D.C., June 27-29, 2005

Whitehouse, E., Dilnot, A., Johnson, P., and Disney, R., 1994 'Pension Policy in the UK: An Economic Analysis', The Institute for Fiscal Studies.

World Bank (2001) "Kosovo, Federal Republic of Yugoslavia: Economic and Social Reforms For Peace and Reconciliation", Report No. 21784-KOS

KUD 339

ROLI I TREGTISË SË JASHTME DHE ARBITRAZHI

Bekim Kuqi

Abstrakt

Roli dhe rëndësia e tregtisë së jashtme në raport me vendin tonë deri me tani ka pasur ndryshim të madhë sepse tregtia ndërkombetare dukshëm është më e avansuar se sa tregtia e vendit tonë edhe për nga prodhimi, cilësia, si dhe qarkullushmëria e mallit të tyre në vijën e tregtisë ndërkombetare.

Ne e dimë shumë mirë se tregtia ndërkombetare i ka pushtuar të gjitha tregjet e vendëve të ndryshme duke përfshirë edhe vendin tonë, ku i gjithë malli vjen nga jashtë, dhe më cilësi e cila i tejkalon të gjitha kriteret që ne dëri me tani ne pakicë kemi prodhuar një mallë të caktuar, edhe pse janë shumë të pakta.

Ne, këtë punim kam dashur ta pasqyroj rolin dhe rëndësinë e tregtisë së jashtë dhe zgjidhjen e saj me arbitrazh, ku e dim që edhe në shtetin tonë Arbitrazha ka funksionuar më rregullore, por tani e kemi ligjin i cili është hartuar dhe e rregullon edhe raportin në mes shtetit dhe kjo i kontribon edhe sigurisë edhe lehtësisë së lidhjes së një marrëveshje të arbitrazhit si dhe zgjidhjen e kontestit përmes arbitrazhit tregtarë ndërkombetarë.

HYRJE

Zhvillimi i ekonomisë së tregut gjithashtu dëshmon në rolin e shtetit si faktor aktiv në rregullimin e rrjedhave të tregut. Pra roli i shtetit është që ajo në mënyrë institucionale të ndikojë që në treg të sigurohen kushtet për konkurrencë të barabartë, që drejtpërdrejt të veprojë në konjunkturën ekonomike të ndikojë në aftësimin e disa subjekteve ekonomike që në mënyrë të pavarur dhe të barabartë të marrin pjesë në treg, që të stimuloj stabilitetin dhe rritjen e ekonomisë, që t'i rregulloj marrëdhëniet në treg në veprimtari të cilat sipas strukturës së tyre ose sipas rëndësisë së tyre shoqërore nuk janë të përshtatshme për konkurrencë të lirë të tregut.

ROLI I TREGTISË SË JASHTME DHE ARBITRAZHI

Suaza institucionale e rregullimit të tregut mund të parashtrohet në mënyra të ndryshme, por më së shpeshti shfrytëzohen dy koncepte: ai subjektiv dhe objektiv, ose në lidhje me përcaktimin e rregullativës juridike zgjidhjet shfrytëzohen të përziera të njërit dhe konceptimit tjetër.

Sot është vështirë të bëhet ndarja strikte në mes të tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme në kohën e globalizimit të ekonomisë botërore.⁴⁶

Përkufizimi i tregtisë së jashtme nuk është detyrë e lehtë, e në veçanti nëse ato duhet bërë në mënyrë relativisht koncize, për arsye se kemi të bëjmë me veprimtari komplekse dhe terminologjisë specifike si në aspektin ekonomik ashtu dhe atë juridik.

Po ashtu kemi të bëjmë me vështirësi të veçanta metodologjike duke pasur paraasysh se subjektet e ndryshme dhe specifike të afarizmit në tregtinë ndërkombëtare, nivelet e shqyrtimit, si dhe aspektet nën të cilët tregtia e jashtme dhe rezultatet e saj mund të shqyrtohen. Është e rëndomtë që ky problem të zgjidhet me përkufizim konciz dhe të thjeshtë – kuptueshëm të tregtisë së jashtme ose i qaset nga koncepti integral i tregtisë si veprimtari ekonomike dhe trajtohet roli i saj në riprodhimin shoqëror. Më pastaj, me analizë krahasimore dhe të krahasimit të funksioneve ekonomike, të punëve dhe detyrave sqarohet specificiteti i tregtisë së jashtme kundrejt asaj të brendshme.

Koncepti objekti ka aso qasje që juridikisht përcaktohen “punët tregtare” si kushtet e përgjithshme dhe të posaçme për kryerjen e këtyre punëve. Akcenti domethënë vihet në aktivitetet dhe punët e procesit të këmbimit të mallrave dhe shërbimeve.

Këto punë konsiderohen si punë të tregtisë vetëm nëse ligji i ka kualifikuar si të tilla, pa marrë parasysh në cilësinë dhe karakterin e subjekteve të cilat i kryen këto punë. Puna tregtare bëhet bazë e të drejtës tregtare. Sipas këtij sistemi, domethënë, në të drejtën tregtare hynë çdo subjekt ekonomiko-afarist i cili kryen punë tregtare, qoftë të kenë kryer veprimtarinë e tij profesionale, ose pavarësisht nga kjo veprimtari, si jo tregtar.

Nga kjo buron se edhe kushtet e përcaktuara normative, të përgjithshme dhe të veçanta, për kryerjen e atyre punëve, si dhe rregullat e përcaktuara normative të sjelljes së subjekteve të cilët marrin pjesë në punën tregtare, janë të njëjta për të gjitha pjesëmarrësit në këmbimin e mallit dhe kryerjes së shërbimeve. Sipas konceptit objektiv objekti i tregtisë nuk lidhet me subjektet të cilat kryejnë këtë veprimtari, e nga vetë kjo edhe për cilësitë organizative dhe statutore të subjektit.

Në ndarjen shoqërore të punës, tregtia merret me veprimtarinë e qarkullimit, respektivisht me blerjen dhe shitjen e mallit dhe të shërbimeve për nevojat e subjekteve gjegjëse, qoftë për prodhim ose konsum personal. Modalitetet e tregtisë munden me qenë të ndryshme; tregtia e brendshme, tregtia e jashtme, tregtia me mallra, shërbime, tregtia me shumicë dhe pakicë etj. Tregtia është krijuar (ka lind) si rezultat i ndarjes shoqërore të punës.⁴⁷ Mirëpo tregtia njëkohësisht këtë ndonjë të punës e mundëson edhe më tutje e zhvillon nga aspekti teknik, ekonomik dhe aspekteve tjera nga e cila mendohen dhe zhvillohen nevojat dhe nevojat dhe shijet e konsumatorëve, konkurrencës e kurse prodhimtaria iu përshtatet nevojave të konsumatorëve. Mirëpo, përshtatja e

⁴⁶ A. Goldštajn, Pravo međunarodne kupoprodaje, I, Zagreb, 1963, fq. 7-51.

⁴⁷ Shih: C. M. Schmitthoff, Međunarodno trgovačko pravo, Zagreb, 1972, fq. 19-30.

=====

tregtisë – tregut dhe nevojave të konsumatorëve është me rëndësi më të madhe se përshtatja e prodhuesve. Tregtia këto përshtatje mund t'i realizojë në kohë të shkurtër dhe me investime të vogël të mjeteve financiare.⁴⁸

Vëllimi i tërësishëm i këmbimit të ekonomisë së një shteti realizohet në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Vëllimi i tregtisë së brendshme rëndom është më i madh se aji i këmbimit me jashtë. Me rritjen e zhvillimit ekonomik dhe afikasistetit të prodhimit rritet pjesëmarrja e tregtisë së jashtme në realizimin e produktit shoqëror në relacion me tregtinë e brendshme.

Tregtia përfshinë dhe aktivitetet e reja të cilat sipas traditës hyjnë në punë tregtare sepse janë pjesë e tregut të mallrave si dhe e punëve të shërbimeve tregtare të cilat janë në funksion të përparimit dhe të zhvillimit të procesit të këmbimit. Disa nga këto aktivitete janë: punët e bursave; shoqërive aksionare, pronarët, ekspozitat, shitblerja e aksioneve.

Tregtinë e përbëjnë edhe shërbimet tregtare të cilat në mënyrë funksionale janë të lidhura me këmbimin e mallit. Shërbimet me të rëndësishme tregtare janë: punët e agjencive, si dhe shërbimet e lidhjes së kontratave të shitjes dhe të blerjes së mallit në emër dhe llogari të komitentit, punët e ndërmjetësimit dhe afarimit në lidhje ose bartjes së deklarimeve afariste në mes të komitentit dhe të personave të tretë me qëllim të lidhjes së kontratës tregtare, shërbimet e ndërmjetësimit në emër dhe llogari të komitentit me qëllim të lidhjes së kontratës për blerjen apo shitjen e mallit, kryerjes së shërbimeve së servisimit dhe shërbimeve tjera teknike në lidhje me mirëmbajtjen dhe riparimin e mallrave teknike,⁴⁹ shërbimet e bartjes dhe sjelljes së mallit dhe punëve tjera që i përcjellin këto, shërbimet e shitjes komisionare, cilësisë dhe sasisë së mallit, organizimit dhe rregullimit të panairëve, dhe të rregullimit të ekspozitave ekonomike, shërbimeve të tregjeve me shumicë; punëve të organizmit të qarkullimit në tregje dhe burrave të produkteve.

Tregtia e brendshme si proces ekonomik mundëson lidhjen e prodhimit dhe sferës së konsumit në vend. Tregtia ndërkombëtare këtë duhet ta mundësojë në ekonominë botërore. Të dyja degët edhe ajo e brendshmja e edhe e jashtmeja i kanë disa karakteristika të përbashkëta por edhe dallime respektivisht specifika. Edhe tregtia e brendshme edhe e jashtme kryen ndërmjetësim të trefishtë: interpersonal, interlokale dhe intertemporale. Po ashtu, ngjashëm është edhe veprimi i ligjeve ekonomike në aspektin e formimit të çmimeve (shpenzimeve), teknikës së tregtimit, e të ngjashme janë edhe trajtat organizative të tregut.

Dallimet në mes të tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme në aspektin materialo-vlerorë, formalo-juridik dhe konsekuencave tjera krijohen në momentin e kalimit fizik të mallit përtej kufirit e këto janë: jo mobiliteti i faktorëve të prodhimit, sistemi i ndryshëm monetar dhe rreziqet më të mëdha

⁴⁸ Z. Grondov, Tregtia jugosllave në ekonomi të tregut, 1989, fq. 1-13.

⁴⁹ V. Vinter, Trgovački zakon, Osijek, 1912.

financiare, kufizimet politiko-tregtare, largësitë e mëdha territoriale të cilat shkaktajnë shpenzime të rritura transportuese.⁵⁰

Pasi që procesi i tërësishëm i riprodhimit shoqëror përbëhet nga faza e prodhimit dhe fazës së konsumit në mes të cilave zhvillohet shpërndarja dhe këmbimi, vendi i tregut dhe tregtisë është në fazën e këmbimit, të qarkullimit të mallit. Çdo proces i riprodhimit i vështruar nga aspekti i procesit të prodhimit i ka dy faza të qarkullimit: e para i paraprinë procesit të prodhimit dhe e dyta në të cilën realizohet prodhimi.

Nocioni i tregtisë shfrytëzohet si nocion funksional që të cilësoi këmbimin e organizuar të mallit dhe të shërbimeve në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar. Ky nocion përfshinë të gjithë pjesëmarrësit të cilët paraqiten në treg. Po ashtu nocioni i tregtisë shfrytëzohet edhe si nocion institucional që të cilësoj blerjen dhe shitjen e mallit me qëllim të realizimit të fitimit. Nocioni institucional i tregtisë ka të bëjë kryesisht me ndërmarrjet e specializuara tregtare të cilat vetëm blejnë dhe shesin mall. Nocioni funksional dhe institucional e dallojnë tregtinë me shumicë e cila kyç në veti edhe tregtinë e jashtme por edhe tregtinë me pakicë.

Qarkullimi i mallit nga prodhuesi deri te konsumuesi në treg zhvillohet nëpërmes rrugës së shitjes (distribuimit). Kanalet e shitjes i përbëjnë njësitë e brendshme organizative dhe ndërmjetësuesit e jashtëm nëpërmjet të cilëve zhvillohet qarkullimi i mallrave dhe i shërbimeve.

Mirëpo, më së shpeshti në treg paraqiten kanale të kombinuara të shitjes: të drejtpërdrejta dhe të tërthortë. Shkaqet për kyçjen e ndërmjetësuesve në shitje kryesisht janë këto:

1. Ndërmjetësuesit mundën t'i kryejnë funksionet e shitjes në mënyrë shumë më ekonomike dhe racionale,
2. Mundën t'i kryejnë në mënyrë më efikase me shpenzime të njëjta,
3. Vet prodhuesi në shumicën e rasteve nuk është sa duhet i aftësuar që t'i kryejë këto funksione,
4. Ndërmjetësuesi posedon mjete të konsiderueshme financiare që shitjen ta kryejë në mënyrë më efikase.

Duhet cekur se funksionet kryesore të tregtisë realizohen nëpërmjet tregut me ndërmjetësim hapësinor (interlokale), ndërmjetësimi kohor (intertemporale); ndërmjetësimi në mes të konsumatorëve dhe blerësve (interpersonale), ndërmjetësimi në nivelizimin e çmimeve dhe stabilitetit të tyre, ndërmjetësimi në kreditim.

Tregtia është veprimtari unike, e ndarja e saj në atë të brendshme dhe të jashtme është determinuar nga kushtet nën të cilat zhvillohet, kështu që konsiderohet se kjo është çështje konvencionale.⁵¹

⁵⁰ M. Trajković, Saboraćajno pravo, Beograd, 1985, fq. 13-70; prof. dr. Mehdi J. Hetemi, E drejta e komunikacionit (ligjërata të autorizuar), Prishtinë, 2001, fq. 1-40.

⁵¹ Ž. Markušić, Međunarodna trgovina – teorija i politika, “Privredno finansijski vodič”, Beograd, 1979, fq. 7-16.

Edhe krahas problemeve të cekura në përkufizimin e tregtisë së brendshme dhe asaj të jashtme, megjithatë, nocioni i tregtisë së jashtme përkufizohet si këmbim i mallit dhe shërbimeve me botën e jashtme. Tregtia e jashtme në kuptim të gjerë përfshinë këmbimin e të mirave dhe shërbimeve me botën e jashtme në formë të veprimtarisë së vazhduar. Kjo paraqet pjesë të qarkullimit në të cilin këmbimi kryhet asisoji ku objekt i shitblerjes, duke e kaluar vijën doganore e lëshon territorin e shtetit shitës (eksportues) ose hyn në territorin e shtetit blerës (importues).

Ky këmbim përfshinë krahas këmbimit të të mirave materiale dhe të kryerjes së shërbimeve më të ndryshme prodhuese dhe joprodhuese sipas urdhrat dhe për llogari të subjekteve të jashtme (transportin, shpëdicionin, sigurimin, shërbimet bankare, turizmin, informatave ekonomike dhe propagandës, veprimtarive botuese dhe veprimtarive tjera, remontimit, riparimit, veprimtarive ndërtimore, hulumtimeve gjeologjike dhe të ngjashme.⁵²

Duke zhvilluar më tutje përkufizimin e tregtisë së jashtme mund të dallojmë tregtinë e jashtme në kuptim të gjerë dhe të ngushtë. Tregtia e jashtme në kuptim të ngushtë përfshinë ekspedimin dhe importimin e mallit. E kurse tregtia e jashtme në kuptim të gjerë përfshinë krahas këmbimit të mallit dhe qarkullimin e shërbimeve si dhe qarkullimin e faktorëve të prodhimit në formë të veprimtarisë së vazhduar profesionale.

Pikërisht për shkak të rëndësisë së madhe të tregtisë së jashtme për zhvillimin ekonomik të shtetit, për shkak të natyrës së afarizmit të tregtisë së jashtme, shumëllojshmërisë së ndjeshmërisë politike të çdo pune të tregtisë së jashtme, kjo veprimtari është e kontrolluar në mënyrë strikte nga ana e çdo shteti, dhe kryhet në pajtim me konceptin e sistemit ekonomik.

Zhvillimi i afarizmit me botën e jashtme duhet gjithashtu të vështrohet në prizmin e zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë ndërkombëtare, këmbimit dhe bashkëpunimit si komponentë me rëndësi të zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike ndërkombëtare të cilët përfshijnë tregtinë ndërkombëtare dhe politikën e saj, financat ndërkombëtare. Ky zhvillim realizohet “spontanisht” (kryesisht në baza bilaterale), por nën ndikësë dhe kontroll të institucioneve gjegjëse ndërkombëtare (në bazë multilaterale), siç janë Banka Botërore për Rindërtim dhe Zhvillim, Organizata Botërore e Tregtisë, Fondi Monetar Ndërkombëtar etj.

Duke pasur parasysh këtë që e cekëm më lartë, është shumë vështirë të bëhet dallimi ndërmjet nocionit tregtia e jashtme dhe nocioni i afarizmit me botën e jashtme. Në afarizmin me botën e jashtme akcenti vihet në mikro aspekt të këtij afarizmi dhe në lidhmëri e saj me punët e prodhimit, punët financiare dhe punët tjera dhe funksionet e zhvillimit të subjekteve themelore ekonomike.⁵³

Shitblerja ndërkombëtare e mallit dhe shërbimeve zhvillohet në një proces mjaft të përbërë të punës – afarizmit. Kjo sipas fazave përfshinë në suaza të përgatitjeve paraprake të aktit të shitblerjes ndërkombëtare (studimit të tij,

⁵² M. Tešić, v.c., fq. 11.

⁵³ Ž. Markušić, v.c., fq. 10-13.

përparimit të tregut të brendshëm dhe të jashtëm, vuarjes së kontaktit afarist), koncipimit dhe afirmimit të vet punës, përmbartimit të saj në aspektin mallorë dhe financiar dhe likuidimit. Ky proces i punës sot është më tepër i njohur si “afarizëm i tregtisë së jashtme”.⁵⁴

Shkaqet janë të shumta të zhvillimit të gjyqësisë së arbitrazhit. Shkaqet e prosperitetit të këtij institucioni duhet kërkuar në cilësitë e saja, të drejtën të cilën e aplikon, përbërjes së saj dhe procedurës të cilën e aplikon. Por, bazë për zgjerimin e arbitrazhit gjendet në intensitetin e tregtisë ndërkombëtare dhe të kyçjes së shteteve të reja në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave, domethënë zhvillimin e tregut botëror edhe në partner të ri. E tërë bota është bërë fqinjë, sepse mjetet e komunikimit i kanë ofruar popujt e botës deri në atë masë që këmbimi ndërkombëtar është zgjeruar në të gjitha shtetet.⁵⁵

Tregtia e jashtme i krijoi vendit rregulla juridike autonome, të cilat në masën më të madhe janë të pavarura nga sistemet nacionale juridike. Për arsye se të drejtën autonome tregtare mundemi ta gjejmë në kushtet e përgjithshme të shitjes, kontratat e ad’hezionit dhe ato tipe, uzancat dhe doket tregtare. Në përbërjen e kësaj të drejte ndërkombëtare tregtare është pandalur në zhvillim permanent, e të drejtës së kësaj të drejte i pëlqen dhe e favorizon arbitrazha.

Bashkësisë afariste ndërkombëtare arbitrazha i nevojitet që t’i mënjanojë mosmarrveshjet e njëkohësisht i mban marrëdhëniet afariste ku me zgjidhjen e kontestit sipas mundësisë dhe rrethanave mos të rrënohen marrëdhëniet afariste. Për këtë arsye edhe konsiderohet se arbitrazha është institucion i paqes.

Mund të cekim se shumë shkaqe shkojnë në dobi të gjykimit të arbitrazhit në përgjithësi dhe janë të pranuar në përgjithësi dhe janë bërë argumente të pranuar të cilët nuk duhet të arsyetohen në këtë vend, por vetëm të cekim: këto janë profesionalizmi në zgjidhjen e kontesteve, shpejtësia, njëshmëria (sipas rregullit), shpenzime më të vogla, *dona fides* si masë themlore për qasje në lidhje me zgjidhjen e kontestit.

Domethënë krijimi i një të drejte të pranuar tregtare ndërkombëtare, njëkohësisht lënë anash edhe problematikën e kolizionit të së drejtës dhe i jep përmbajtje të re të drejtës ndërkombëtare private. Në vend të drejtës me norma kolizive kjo bëhet e drejtë e transaksioneve me element të huaj, në saje të së cilës po bëhet e drejtë e transaksioneve me element të huaj, në suaza të së cilës e drejta tregtare ndërkombëtare ka rëndësi të posaçme. Pra kjo është rruga për eliminimin e njërit nga problemet më të vështira të tregtisë ndërkombëtare: se si të gjendet e drejta meritore e cila duhet të aplikohet në kontratë. Edhe nëse kjo është paraparë në kontratë, interpretimi i të drejtës nacionale nga ana e gjuqtarëve ose arbitrave të nacionaliteteve tjera krijon vështirësi.⁵⁶

⁵⁴ M. Tešić, Organizimi dhe afarizmi ndërkombëtar i ndërmarrjeve, 1987, Beograd, fq. 2.

⁵⁵ Prof. Dr. Mehdi J. Hetemi, Disa tema aktuale të ekonomisë së tregut: Arbitrazhi gjithnjë ë me i preferueshëm në zgjidhjen e konflikteve në hapësirën e tregtisë ndërkombëtare, Prishtinë, 2005, fq. 5-17.

⁵⁶ T. Varadi, Međunarodno privredno pravo, Budimpešta, 1997, fq. 1841-1849 (e botuar në “P. čivot”, nr, 11-12/1993).

=====

Mirëpo, ndoshta ka ardhur koha që shkencës juridike t'i pranohet ai vend të cilin ajo në realitet e ka në zhvillimin e mendimit juridik, e në veçanti në aspektin e të drejtës tregtare dhe asaj ndërkombëtare tregtare. Lajthitja e laikëve për gjithpërfshirjen e ligjit, paraqesin kohë të kaluar, por edhe iluzioni i ligjdhënësit se normat ligjore mundën me qenë burim i vetëm i së drejtës më nuk ekziston, praktika gjyqësore dhe e arbitrazhit dhe praktika afariste janë bërë krijues të pranuar të së drejtës.⁵⁷

LLOJET E ARBITRAZHAVE

1. Arbitrazhet e të drejtës publike

Detyrë në këto raste e arbitrazhit është që ta nxjerr vendimin lidhur me kontestin i cili është i obligueshëm për punëdhënësin dhe punëmarrësit, respektivisht për pjesëmarrësit e kontratës kolektive.

2. Arbitrazha e të drejtës ndërkombëtare publike

Arbitrazhat e të drejtës ndërkombëtare publike i zgjidhin kontestet në mes të shteteve sovrane. Për të ekzistuar kontesti i arbitrazhës nga e drejta ndërkombëtare publike me rëndësi është që si palë të paraqiten shtetet si bartëse të sovranitetit.

3. Arbitrazha e të drejtës private

Ne këtu i trajtoam arbitrazhat e të drejtës private, d.m.th. ato të cilat bazohen në marrëveshjen vullnetare të arbitrazhit dhe në procedurën e së cilës paraqiten personat e të drejtës civile dhe në kushtet e cekura më lartë edhe shtetet respektivisht institucionet e të drejtës publike.

4. Arbitrazha vendore, e jashtme dhe ajo nacionale

E drejta angleze përkufizon arbitrazhën e brendshme si atë selia e së cilës është në Angli, nëse të dy palët në momentin e nënshtrimit të marrëveshjes së arbitrazhit e kanë pasur përkatësinë nacionale angleze.⁵⁸

Domethënë për arbitrazhën e brendshme, respektivisht arbitrazhën e jashtme është me rëndësi se është e nënshtruar ndonjë të drejte nacionale, dhe atë sipas normës së kolizionit të zgjidhjes së kontesteve, d.m.th. të përcaktimit të ndonjë pike lidhëse. Arbitrazha nacionale konsiderohet ajo selia e së cilës është në shtetin e caktuar, e drejta e së cilit shtet është aplikuar në procedurën e arbitrazhit. Mirëpo, aplikimi i këtij kriteri nuk jep rezultate të kënaqshme, nëse vendi juridik i selisë së arbitrazhit është caktuar në një, e procedura zhvillohet në vendin tjetër, e kurse vendimi është nxjerr në shtetin e tretë.

Kriteri gjeografik në këto situata nuk mundet në mënyrë të saktë të jep përgjigje në pyetjen e nacionalitetit të arbitrazhit. Kjo sidomos për shkak të asaj se vendi i selisë së arbitrazhit mundet të përcaktohet edhe më vonë, pasi të lidhet

⁵⁷ A. Goldštajn, Postupni razvoj međunarodnog trgovinskog prava, Zagreb, 1972.

⁵⁸ Se. 3.7. UKAA, 1979.

marrëveshja e arbitrazhit, si dhe nacionaliteti i arbitrazhës mund të mbetet i papërcaktuar gjithnjë deri në momentin e nxjerrjes së vendimit të arbitrazhit.

PERFUNDIMI

Arbitrazha tek ne është një reform që ka filluar, si reform po e quajmë ligjin i cili është i harmonizuar me vendet anëtarë të Unionit Evropian dhe është më lehtë krijimi i marrëveshjes dhe kjo ndikon drejtëpërsdrejti në ekonominë e vendit tonë.

Gjithashtu e stimulon investitorin në krijimin e marrëveshjeve me të shpejta në procedurë dhe marrje të vendimit. Ku dihet që në zhvillim ekonomik karakteri i shpejtësisë në arritjen e marrëveshjes, si dhe në qarkullimin e mallrave krijohen fitime të mira.

Në pika të shkurta në funksionimin e Arbitrazhes. Arbitri në fushën e tregtisë ndërkombëtare e ka si edhe gjykatësi që ta zgjidhë apo vendos kontestin dhe ta shpallë ndarjen e së drejtës, por për dallim nga gjyqi, ky këtë nuk e bën në emër të shtetit, e as në suaza të ndonjë sistemi juridik nacional. Duke shtruar pyetjen se në kontest a duhet të aplikohet e drejta nacionale, ose e kundërta, ka mundësi që asaj t'i iket dhe të thirret në norma të cilat për kah burimi janë jashtështetërore Fachardi përgjigjet se "Funksioni i Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar është që të orientohet në zgjidhjen e dytë, që me anë të arbitrazhit palët synojnë që t'iu shmangen pengesave dhe konflikteve në mes të gjyqësisë dhe të drejtës, dhe synojnë të gjejnë zgjidhje në pajtim me përpjekjet të cilat iu janë të përbashkëta njerëzve afaristë, në mënyrë që t'iu përshtaten nevojave të tregtisë dhe afarizmit ndërkombëtar".

Emërtimi arbitrazhi tregtar ndërkombëtar në përgjithësi sot është pranuar, jo vetëm në aspektin doktrinar por edhe në praktikën afariste dhe atë të arbitrazhit, por edhe në konventa. Kështu për shembull, Konventa e Evropës për Arbitrazhin Ndërkombëtar Tregtar (e vitit 1961) e ka pranuar këtë term.

Gjatë analizimit të natyrës juridike të arbitrazhit është e nevojshme që të nisemi nga dy karakteristika themelore. Në njërin anë misioni i arbitrit konsiston në zgjidhjen e kontestit, në nxjerrjen e vendimit meritator, në të cilën manifestohet funksioni i saj i juridiksionit, Mirëpo, në anën tjetër, ky funksion i juridiksionit ka edhe burimin e vet kontraktues: Arbitri i merr autorizimet e tij nga dëshira e përbashkët e palëve kontraktuese. Andaj, në komponentin kontraktore ndërlidhet detyrimisht komponenta kontraktore. Nga kjo, në doktrinën bashkëkohore në përgjithësi është pranuar një natyrë mikste juridike e arbitrazhit: Kontraktore sipas burimit të vet; e juridiksionit sipas funksionimit të saj. Domethënë, kompetenca e arbitrazhës është bazuar në kontratën e palëve me të cilën ato ia besojnë arbitrazhit që ta nxjerr vendimin meritator në kontestin e tyre. Pra, kontrata e plotfuqishme me të cilën parashihet kompetenca e arbitrazhit është bërë konstituive e gjykimit të arbitrazhit dhe njëkohësisht bazë e dërgimit të kompetencës së gjyqit shtetëror.

KUD 338(496.51)

KONCEPTI I MËSIMIT ORGANIZATIV

*Mr.sc.Driton Sylqa
dsylqa@gmail.com*

Abstrakt

Kohëve të fundit, aktiviteti afarist për shumë ndërmarrje po bëhet gjithnjë e më kompleks dhe kreativ për arsyen e proceseve dinamike dhe ndryshimeve të shpejta që po ngjajnë në ekonomi. Zhvillimi rapid tekniko-teknologjik dhe rritja e konkurrencës në tregjet globale po i shtyjnë ndërmarrjet që vazhdimisht të ndryshojnë, të ristrukturohen, investojnë në teknologji të reja dhe të minimizojnë koston e prodhimit me të vetmin objektiv – që të mbesin konkurrentë në treg. Kështu që, mësimi organizativ po bëhet me rëndësi të jashtëzakonshme nëse organizatat dëshirojnë të kenë sukses. Aplikimi praktik i këtij procesi premtues është i kushtueshëm pasi që kërkon investime në teknologjitë moderne të informacionit. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh kapacitetin e vogël veprues dhe burimet e kufizuara me të cilat disponojnë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, lind pyetja se a kanë mundësi që këto ndërmarrje të aplikojnë këtë proces modern? NVM-të që të jenë konkurrentë dhe të sigurojnë qëndrueshmëri duhet të përqendrohen më tepër në diturinë e fshehur dhe në shfrytëzimin e trendeve të teknologjisë së informacionit sepse ndikimi i tij është i konsiderueshëm në zhvillimin e mësimi organizativ.

Fjalët kyçe: mësimi organizativ, dituria / njohuria organizative, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

JEL klasifikimi: L20, M1, O3

HYRJE

Bota bashkëkohore e biznesit modern sot përballlet me sfida të ndryshme dhe me një kompleksitet enorm të mjedisit ndërsa ne jetojmë në një ambient që ndryshon në mënyrë rapide. Presionet e sistemeve shoqërore rriten vazhdimisht dhe njerëzit si kurrë më parë janë të shtyer ose e shtyejnë vetveten drejt arritjeve gjithnjë e më të mëdha. Sistemet shoqërore janë të lidhura ngushtë me biznesin dhe njerëzit ballafaqohen çdo ditë me kompleksitetin dhe novacionet.⁵⁹

⁵⁹ Probst & Buchel, “Organisational Learning”, 1997

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme⁶⁰ tanimë konsiderohen si burim i rëndësishëm dhe kontribuues të padiskutueshëm në zhvillimin ekonomik. Ato janë burim kryesor i shkathtësive për udhëheqje të ndërmarrjeve, për punësim, si dhe për zbutjen e varfërisë. Ekzistenca e tyre, mbështetja e vazhdueshme dhe krijimi i NVM-ve funksionale është me rëndësi të veçantë jo vetëm për shtetet në tranzicion por tashmë është parë se ato luajnë rol esencial edhe në ekonomitë e BE-së. Në BE rreth 20 milion NVM përfaqësojnë 90% të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve. Për këtë arsye përkrahja e NVM-ve paraqet njërin nga prioritetet e kryesore të Komisionit Evropian për zhvillim ekonomik, krijim të vendeve të reja të punës, si dhe kohezion ekonomik dhe social.

Proceset e hapura dinamike dhe karakteristikat e ndryshimeve të shpejta bëjnë mjedisin ekonomik të paparashikuar, sa madje edhe në bizneset prodhuese presioni për ndryshime rritet. Punëtorëve iu duhet të performojnë disa lloje detyrash në të njëjtën kohë, të jenë fleksibil dhe të veprojnë në kohë. Kërkesa e konsumatorëve duhet të plotësohet me produkte të kualitetit të lartë. Preferencat e konsumatorëve bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për tu detektuar nga organizatat në mënyrë që t'ju sigurojnë atyre një biznes të suksesshëm.⁶¹

Kompleksiteti i imponuar nga mjedisi është vazhdimisht në rritje e sipër dhe mu për këtë arsye organizatat janë të shtyra të ndryshojnë në mënyrë që t'i përshtaten kushteve që i kërkon mjedisi. Mjedisi për organizatat është i rëndësishëm dhe ato duhet që në çdo moment të jenë të gatshme të ndërrojnë varësisht nga nevoja që parasheh mjedisi. Por, a mund të ndërrojnë të gjitha organizatat? A janë të gjitha organizatat inteligjente apo disa janë më pak e disa më shumë? Për t'ju përgjigjur këtyre pyetjeve lypset një shtjellim më i hollësishëm në mënyrë që të kuptohet më mirë procesi i mësimit organizativ

1. ÇKA ËSHTË MËSIMI ORGANIZATIV?

Mësimi organizativ është më tepër se sa një metaforë. Ajo në vete përmban aftësinë e organizatës për të rritur kapacitetin e veprimit si dhe aftësinë për të ndryshuar. Shumë studime praktike pohojnë se organizatat të cilat ndryshojnë më parë se sa konkurrentët e saj me siguri se do të kenë përparësi konkurruese. Prandaj me të drejtë thuhet se procesi i mësimit organizativ fillon në bazë të aftësive të saj për të ndryshuar. Organizatat të cilat dështojnë në implementimin e suksesshëm të ndryshimeve organizative dhe që dështojnë në kultivimin e potencialit të tyre për t'u zhvilluar, mund që së shpejti ta gjejnë veten në mesin e humbësve. Nga shumë autorë pohohet se në të ardhmen mësimi për organizatën do të jetë i vetmi atribut që do t'i sigurojë asaj përparësi konkurruese.⁶²

⁶⁰ Ne tekstin e mëtejshëm të këtij punimi do të përdoret shkurtesa NVM.

⁶¹ World Economic Forum, "Globalization of alternative Investments", Annual Report 2008;

⁶² de Geus, 1988

=====

Është thënë nga shumë autorë se krijimi i njohurive dhe mësimi organizativ janë çështje kyçe për t'u ballafaquar me sfidat e së ardhmes pasi që tani kemi hyrë në të ashtuquajturën “era e diturisë”. Kur përmendet termi njohuri si dhe krijimi i tyre atëherë lënë të kuptohet se është fjala për dituritë e personave individualë që përbëjnë edhe bazën kryesore të njohurive të organizatës në përgjithësi.

A është e mundur që organizatat të mësojnë? Ishte kjo një pyetje kyçe që shumë mendimtarë dhe ithtarë të ekonomisë klasike si dhe psikologët tradicionalë e kanë parashtruar duke kërkuar përgjigje konstruktive. Ata thonë se individët janë ata të cilët mësojnë sepse kanë trurin, sepse janë qenie biologjike. Ndërsa, organizatat si të tilla nuk mund të mësojnë. Që këtu fillon diskutimi lidhur me mësimin që bëjnë individët dhe mësimin organizativ në mënyrë që t'i jipet një mbështetje e fortë këtij koncepti.

1.1 Definimi i konceptit të mësimit organizativ

Argyris, që njihet si person i cili dha kontribut të çmuar në zhvillimin e konceptit të mësimit organizativ, thekson se ky koncept është një aftësi që të gjitha organizatat duhet ta zhvillojnë.⁶³

Mësimi organizativ edhe pse ka një mbështetje të fortë në mësimin individual nuk përbën shumën e njohurive individuale. Ajo ka të bëjë më tepër me bashkëveprimin e ndërsjellë në mes të anëtarëve të organizatës. Ky interaktivitet bën që të ndryshohet baza e njohurive apo diturive të organizatës si një tërësi. Nisur nga ky këndvështrim pason edhe përkufizimi i mëposhtëm:

“Mësimi organizativ është një proces përmes së cilit baza e njohurisë dhe vlerave organizative ndryshojnë, që prijnë drejt përmirësimit të aftësisë për zgjidhjen e problemeve dhe kapacitetit për veprim”⁶⁴

Siç shihet nga ky definicion theksi vihet në “proces”, i cili nënkupton zhvillimin e vazhdueshëm. Pra, kemi të bëjmë me një proces i cili përfshin ndryshimin e njohurive organizative që njëherit paraqet esencën e inicimit të procesit të mësimit. Nga ky shtjellim na bëhet e qartë se koncepti i mësimit organizativ është një proces që shpjegon dhe përshkruan ndryshimin kontinuel dhe dinamik.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe biznesit organizatat përballen me lloj-lloj situatash. Në njërin anë nga këto situata pasojnë eksperiencia të ndryshme që në këtë kontekst mund të kenë kuptim të karakterit të mirë dhe jo të mirë. Përvojat e mira gjithmonë kanë tendencë përsëritëse pasi ato përshkruhen edhe me suksese apo rezultate pozitive, ndërsa ato jo të mira tentojnë të redukohen apo edhe mundësisht të eliminohen. Mirëpo, kjo nuk do të thotë me çdo kusht se përvojat e mira mund të kenë sukses në çdo situatë pavarësisht nga

⁶³ Argyris Chris, “On Organisational learning”, 1999, fq. xiii

⁶⁴ Probst dhe Buchel, “Organisational learning” 1997, fq 15

kushtet e ekspozuara. Në anën tjetër kemi dituritë individuale të punonjësve apo anëtarëve të organizatës që janë të shumëllojshme. Me një menaxhim të mirë dhe bashkëkohor këto dituri individuale do bëhen transparente për të gjithë punonjësit në organizatë, me ç'rast shkëmbimet reciproke të njohurive rezultojnë në beneficionet e organizatës si tërësi. Pra, të gjitha këto modele sjelljesh që janë treguar si të sukseshme medoemos duhet që të memorohen apo të regjistrohen. Ruajtja apo memorimi i përvojave, njohurive dhe modeleve të suksesshme ka domethënie të madhe sepse në këtë mënyrë baza e njohurisë organizative do të rritet. Njohuria që memorohet në dosjet e organizatës, memorimi i veprimeve dhe akteve të ndryshme, vendimeve, normave dhe rregullave bëjnë që organizata ta bëjë veten të kuptueshme për të tjerët dhe për vetveten quhet njohuria organizative.⁶⁵

Në një masë të madhe mësimi zë vend në nivelin individual, pastaj ngjan në nivel grupi për t'u zgjeruar së fundi në nivelin organizativ. Prandaj, është me rëndësi vitale për organizatën që njohuria të memorohet në një sistem informativ brenda organizatës në mënyrë që çdo punonjës të ketë mundësi qasjeje në të. Në të kundërtën, nëse individ i ik nga organizata mund të paraqiten probleme sepse me ikjen e tij organizata do t'i humb njohuritë dhe dituritë e atij individ.

1.2 Dituria e fshehur si pjesë përbërëse e konceptit

Çdo njohuri dhe dituri që individët posedojnë nuk mund të ruhet në sistemet informative të organizatës. Këtu bëhet fjalë për njohuritë dhe dituritë që individët i fitojnë gjatë eksperiencës së ushtrimit të një detyre. Kjo dituri sipas disa shkencëtarëve japonez quhet **dituri e fshehur** e që nuk mund të shprehet me fjalë. Si p.sh. edhe pse ne dimë se si drejtohet biçikleta ne nuk mund ta shpjegojmë se si e bëjmë atë.

Kontribut të madh mbi diturinë e fshehur pra që nuk mund të përshkruhet me fjalë dhe diturinë e qartë apo që mund të shpjegohet kanë dhënë autorët Nonaka dhe Takeuchi. Ata bukur sqarojnë me një shembull konkret se si dituritë e fshehura mund të bëhen transparente për të tjerët. Shembulli ka të bëjë me një kompani bukëpjekëse japoneze në të cilën një individ me përvojë shumëvjeçare bënte bukë dhe pjekurina shumë të shijshme. Puna e tij dallohej shumë nga të tjerët, edhe pse të gjithë punonin me të njëjtën recetë dhe me të njëjtin princip. Askush nuk mund ta zëvendësonte punën e tij kualitative. Pasi që vet performanca e tij nuk mund të mbulonte kërkesën dhe produktet brenda organizatës dallonin shumë nga kualiteti, menaxherit i rrodhi ideja që në prani të 20 punëtorëve të tjerë mjeshtri i bukës të demonstrojë gatesën dhe procesin e pjekjes së pjekurinave. Mjeshtrit iu deshtë që disa herë të përsëris mënyrën e tij identike për të vërejtur të tjerët se esenca qëndronte në lakimin e duarve të mjeshtrit. Ai për 15 minuta pandërprerë sjellte brumin nëpër shuplaka dhe me

⁶⁵ Michael Stankosky, "Creating the discipline of knowledge management", 2005;

gishtërinjtë ngjeshte atë duke e zgjeruar në çdo të sjellë. Punëtorët e tjerë u deshën që mënyrën mistike të gatesës ta përsërisnin disa herë derisa arritën suksesin e njëjtë me atë të mjeshtrit. Dituria e fshehtë tani më u bë e qartë për të tjerët.⁶⁶

Pra, këtu qëndron thelbi i njohurisë së fshehur e cila nuk mund të bëhet transparente. Është më se e domosdoshme që këto njohuri të fshehura apo misterioze që posedohen nga punonjësit, të bëhen të qarta për të tjerët në mënyrë që të ngritet njohuria organizative.⁶⁷

Shuma e proceseve mësimore në mes të individëve në organizatë paraqet mësimin organizativ. Siç u pa nga shembulli i mësipërm, ishte mësimi ai i cili bëri që dituria e pashpjeguar të bëhej e qartë dhe transparente për të tjerët. Dituritë e fshehura duhet bërë të qarta, është një porosi me domethënie të madhe. Sipas këtyre autorëve kjo paraqet edhe esencën e suksesit japonez e cila me vite të tëra ishte misterioze për botën perëndimore.

Këtu shihet lidhja e ngushtë në mes të mësimit dhe diturisë. Njëherë kur mësimi të zë vend fitohet dituria e re dhe pastaj dituria lirisht mund të konsiderohet si një rezultat i procesit mësimor. Për më tepër, mësimi organizativ është pra një proces që përbëhet nga mbledhja, procedimi dhe memorimi i informatave.

2. NDRYSHIMET ORGANIZATIVE

Zhvillimi organizativ është ngushtë i lidhur me ndryshimet organizative. Ndryshimet që ndodhin sot në sferën sociale janë bërë pothuaj përditshmëri. Ato rrjedhin si pasojë e trysnisë së një rrethi të gjerë faktorësh, e që kanë një ndikim të madh jo vetëm në jetën e njerëzve, por edhe organizatave ekonomike. Organizatat e biznesit duke ndjerë efektin pozitiv apo negativ të ndryshimeve, përpiqen të jenë pro-aktiv në parashikimin e tyre në mënyrë që të parapërgatiten për ndryshimet eventuale në të ardhmen.

Nëse lexojmë literaturë mbi menaxhmentin modern të dhjetë viteve të fundit lehtë mund të hasim në qëndrimin se një organizatë mund të veprojë në mënyrë të suksesshme vetëm me anë të bashkëveprimit me mjedisin e gjerë të jashtëm, pjesë e së cilës është edhe vet. Struktura dhe funksionimi i organizatës duhet të reflektojë dhe t'i përgjigjet natyrës së mjedisit në të cilën operon. Faktorët e ndryshëm si, kushtet e pasigurta ekonomike, konkurrenca e egër globale, niveli i intervenimit qeveritar, mungesa e burimeve natyrore, si dhe zhvillimet rapide në teknikë dhe teknologji, krijojnë një mjedis të paqëndrueshëm. Në mënyrë që organizata të sigurojë mbijetesën si dhe suksesin

⁶⁶ "The knowledge – creating company: how Japanese companies create the dynamics of innovation", 1995

⁶⁷ Argyris dhe Schon, "Organisational Learning II – Theory, Method and Practice" 1996, fq 12

në të ardhmen, ajo duhet t'ju adaptohet kërkesave të jashtme, me një fjalë duhet që vazhdimisht të ndryshojë. Presioni kryesor për ndryshime vjen nga ambienti i jashtëm, prandaj organizata duhet që në çdo moment të jetë e përgatitur për t'u ballafaquar me kërkesat e një ambienti të ndryshueshëm⁶⁸.

Me ndryshim organizativ mund të kuptohet çdo përpjekje e menaxherëve për të transformuar gjendjen aktuale, duke përfshirë brenda saj një spektër të gjerë që fillon me ndryshimet më të thjeshta (përmirësimi teknologjik, përshtatja e ambientit për komunikim më të madh në mes të stafit, etj) e deri te ndryshimet radikale apo ato më komplekse dhe më të ndërlikuara, siç janë ristrukturimet e përgjithshme, ndryshimi i sistemit të prodhimit, modifikimi i strukturës dhe sjelljes organizative, krijimi i departamenteve të reja, etj. Ndryshimi organizativ është një çështje mjaft preokupuese për menaxherët, të cilët kanë për detyrë t'i parashikojnë nevojat për t'u përballur me problemet në të ardhmen, t'i planifikojnë dhe realizojnë ato në funksion të arritjes së synimeve të organizatës.⁶⁹

2.1 Ndryshimet e planifikuara organizative

Ndryshimet e planifikuara prezantojnë tentimet e qëllimshme për të përmirësuar efektivitetin operacional të organizatës. Objektivat kryesore që theksohen nga organizatat moderne mund të përmbledhen si orvatje drejt:

- Modifikimit (përmirësimit) të modeleve të sjelljes së punëtorëve në një organizatë; dhe
- Përmirësimit të aftësive të organizatës për t'u përballë me ndryshimet në mjedisin e saj.

Një program për ndryshim të planifikuar dhe performancë të përmirësuar përfshin një model prej tre fazash i cili është një proces në shërbim të modifikimit të sjelljes.

- **Shkrirja e gjendjes momentale** – përfshin reduktimin e forcave që përpiqen të përforcojnë sjelljen në formën aktuale të saj. Në këtë fazë poashtu përfshihet edhe njohja e nevojës për ndryshime, si dhe vlerësimi për domosdoshmërinë e përmirësimeve;
- **Lëvizja përpara** – ka të bëjë me zhvillimin e qëndrimeve të reja apo sjelljeve të reja, si dhe implementimi i ndryshimit të paraparë;
- **Ngrirja e sërishme** – përfshin stabilizimin e ndryshimit në nivelin e ri, si dhe përforcimet nëpërmes të mekanizmave përkrahës si p.sh. politikatat, strukturat, normat, etj.

⁶⁸ Claudia Baca, "Project manager's spotlight on change management", 2005

⁶⁹ Shyqri Llaci, "Manaxhimi i Biznesit", 2000, fq 204-216

Lidhur me procesin e mësipërm, sipas French, Kast dhe Rosenweig, ekzistojnë tetë elemente specifike të përpjekjeve për ndryshimet e planifikuara.⁷⁰ Në vijim prezantohet modeli tre fazash, si dhe elementet specifike të ndryshimeve sipas planit:




Figura 1. Procesi tre-fazësh i zbatimit të ndryshimit sipas planifikimit.
Adaptuar nga French, Kast, dhe Rosenzweig, “Understanding human behaviour”

Një strategji e ndryshimit mund të bëhet nëpërmes të adoptimit të modelit të sistemit, në të cilin model organizata shihet si një sistem i tërë i përbërë nga shumë variabla apo nën-sisteme. Variablat mund të identifikohen në shumë mënyra që përfshijnë: qëllimin, teknologjinë, strukturën, njerëzit dhe menaxhmentin. Këto variabla shërbejnë si pika kyçe lidhur me ndryshimin organizativ. Ndryshimi mund të inicohet me modifikimin e ndonjëres nga variablat apo me kombinimin e tyre. Në praktikë ndryshimi i ndonjë variable implikon ndryshimin e variablave të tjerë.

Prandaj implemetimi i ndryshimeve mund të shihet si një zgjedhje e strategjisë për modifikimin e qëllimeve, teknologjisë, strukturës, njerëzve apo menaxhmentit. Asnjë njësi në organizatë nuk është ujdhesë dhe ndryshimet e planifikuara në një pjesë të organizatës kanë efekt në pjesët tjera. Prandaj, është tepër e rëndësishme që me ndryshimin e një pjese të planifikohet ndikimi i saj eventual në pjesët tjera përbërëse në mënyrë që të mos ndodhin befasi.⁷¹

⁷⁰ French, W.L., Kast, F.E., dhe Rosenzweig, J.E., “Understanding human behaviour”, f. (569), Harper and Row, 1985,

⁷¹ Wilson, B., “The Challenge of Change”, 1987, në Mullins. L., “Management and Organisational Behaviour”, 1994.

3. NXITËSIT E MËSIMIT ORGANIZATIV

Emërohen si nxitës të gjithë ata faktorë që shërbejnë si promotorë apo gjenerues të procesit të mësimit organizativ. Kjo pjesë identifikon nxitësit (inicuesit) e mësimit organizativ e që janë të dy llojeve.. Njëri lloj ka të bëjë me individët apo grupet ndërsa, lloji tjetër i nxitësve të mësimit organizativ konsiderohen të jenë sistemet memoruese të cilat përdoren nëpër organizata. Shkaktarët e mësimit janë të domosdoshëm për rrjedhën e procesit të mësimit organizativ sepse ata bashkëveprojnë njëri me tjetrin për të mundur kështu jetësimin e mësimit. Veç kësaj, nxitësit ndihmojnë procesin e mësimit në një organizatë duke i kaluar barrierat e mësimit. Them kështu sepse pa i kapërcyer të gjitha barrierat që pengojnë zhvillimin e procesit të mësimit organizativ ky proces nuk mund të ketë jetë të gjatë apo vështirë se do të zhvillohet. Në vijim prezantohen katër tipet e shkaktarëve të këtij procesi.⁷²

3.1 Individët si nxitës

Me individët si shkaktarë mësimi organizativ fokusohet në baza individuale të kapitalit human të organizatës si dhe, në motivet, në interesin dhe në vlerat e individëve që formojnë bazën për proceset kognitive, e që kjo shpie drejt mësimit. Individët në një organizatë janë ata të cilët komunikojnë në mes veti, shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat në mes tyre dhe në këtë mënyrë formojnë bazën e teorisë vepruese. Teoria vepruese në këtë kontekst nënkupton të gjitha rregullat, proceset dhe procedurat në të cilat organizata ndërton parimet dhe mënyrat e të vepruarit. Komunikimi në mes të anëtarëve të organizatës është një shprehje e mësimit kolektiv të individëve që zë vend nëpërmes të diskutimeve, dialogjeve, dhe nëpërmjet të interaktivitetit të individëve qofshin ato formale apo jo-formale. Njohuria e re e krijuar mund të zbatohet pastaj me lehtësi për t'u ballafaquar me probleme të natyrave të ndryshme apo edhe për t'i zgjidhur ato në mënyrë efikase. Komunikimi dhe diskutimet kontribuojnë të arrihet një marrëveshje në mes të individëve e mandej bëhet e mundur që të zhvillohet një njohuri personale dhe në fund krijohet një pasqyrë e përgjithshme për realitetin e organizatës. Prandaj edhe thuhet se pa diskutime, argumentime dhe konsensus final, rezultatet e mësimit individual janë të pavlera.

3.2 Elita si nxitës

Kur flasim për Elitën nën kontekstin organizativ medoemos se iu referohet të gjithë atyre personave me autoritet dhe pushtet në organizatë që zakonisht janë të pozicionuar në nivelet e larta menaxhuese. Elita si e tillë ka

⁷² Ian Brooks, "Organisational Behaviour", 2003

=====
 influencë në proceset vendim-marrëse si dhe ka aftësi për të detektuar (zbuluar) kur dhe çfarë ndryshimesh organizative janë të nevojshme në mënyrë që të ndërmarrë aksione të përshtatshme. Kjo mund të ndodhë atëherë kur liderët karizmatik ndryshojnë strukturën, lidhshirë dhe duke i përcaktuar objektivat e reja. Ndryshimi i lidhshirë, që njëherit përfaqëson një ndryshimin esencial, shpesh funksionon si nxitës i mësimit organizativ. Kjo nënkupton gjithashtu se dituria e elitës konsiderohet si burimi më i madh i përcaktimit të ndryshimeve dhe vendimeve organizative. Mësimi organizativ shpesh nxitet me shfaqjen e këtyre ndryshimeve. Në këtë mënyrë mësimi dhe autoriteti (pushteti) konsiderohen se janë të lidhura ngushtë dhe si rrjedhojë elita dhe liderit autoritativ shihen si shkaktarë apo nxitës të mësimit organizativ.

3.3 Grupet si nxitës

Grupet si nxitës të mësimit janë ekipet e ndryshme brenda organizatës që përbëhen nga individë me role dhe aftësi specifike. Grupet e ndryshme siç janë, grupet inovatore dhe aleancat e ndryshme mund të jenë gjeneratorë të vërtetë të mësimit organizativ. Këto grupe nuk nevojitet të kenë autoritet por mund të jenë grupe kreative si p.sh. grupet e rrjetit në organizatë. Anëtarët e këtyre grupeve duhen të jenë të lirë për të menduar, mësojnë dhe punojnë kurdoherë që ata kanë nevojë. Ata janë grupe të vet-organizuar që kontribuojnë në ndryshimin e diturive aktuale dhe rridefinimin e kontekstit të tyre. Ata mund t'i japin sugjerime menaxhmentit si dhe ato duhet medoemos të konsiderohen nga vendim-marrësit. Është shumë e rëndësishme se anëtarët e këtyre grupeve arrijnë marrëveshje në njëri tjetrin sepse kjo çon drejt ndryshimit të njohurive bazë, e me këtë bëhet e mundur edhe zhvillimi i mësimi organizativ. Konsensusi në mes të anëtarëve të grupit mund të shpiejë në gjenerimin e diturisë së re. Kjo dituri mund të sfidojë normat dhe vlerat ekzistuese dhe korniza referuese e organizatës mund të ndryshojë. Në këtë mënyrë mësimi organizativ mund të nxitet. Sipas Garrat-it, këto grupe kanë karakteristikat vijuese:⁷³

- Ata duhet të kenë një rol specifik
- Atyre ju duhet kohë dhe hapësirë për të reflektuar mbi realitetin e tyre
- Ata duhet t'i përdorin aftësitë e tyre personale
- Duhet të jenë të vetëdijshëm se mësimi është një proces i vazhdueshëm

⁷³ Garrat, 1990

Grupet që kanë këto karakteristika konsiderohen si nxitës vendimtar të mësimit organizativ. Kështu, këto karakteristika do t'ju mundësonin grupeve që t'i kalonin barrierat e mësimit organizativ.

3.4 Nxitësit në formë të sistemeve sociale

Sistemet sociale si nxitës të mësimit organizativ pasqyrojnë deponimin e diturive dhe njohurive apo memorjen e saj. Teoritë e cilat merren me sistemet sociale si nxitëse të mësimit organizativ kryesisht kanë të bëjnë me grumbullimin dhe standardizimin e përvojave të mësimit që shfaqen si rregulla, norma, artifakte dhe sisteme. Organizatat perceptohen që posedojnë me sisteme që iu mundëson atyre t'i memorojnë përvojat, dituritë dhe vlerat. Në këto sisteme poashtu ruhet edhe aspektet e ndryshme që i përkasin kulturës organizative, si p.sh. sjelljet e ndryshme në organizatë të punëtorëve, marrëdhëniet e tyre, etj. Lidhur me këtë, procesi i mësimit mund të jetësohet pasi që informatat dhe njohuritë e reja ruhen në memorien e këtyre sistemeve dhe më pastaj transformohen në rregulla, norma dhe procedura. Këto ndryshime ngjajnë pavarësisht nga anëtarët e organizatës. Ky proces i mësimit siguron që baza e njohurive vazhdimisht të modifikohet, pasurohet dhe rifreskohet. Kështu që, me modifikimin e bazës së njohurive dhe me zhvillimin e vazhdueshëm të kësaj baze, organizata mund të ngrisë bazën e saj të njohurive dhe në këtë mënyrë gradon mësimin organizativ.

4. BARRIERAT E MËSIMIT ORGANIZATIV

Strukturat e fiksuara mund ta pengojnë procesin e mësimit sepse mësimi i shkatërron njohuritë në format e saj ekzistuese. Ky qëndrim potencohet mu për atë se strukturat fleksibile organizative janë më të përshtatshme për ndryshime dhe adaptime ndaj rrethanave që i imponon ambienti. Prandaj, nëse dëshirohet që mësimi organizativ të zë vend, baza e njohurive duhet të ndërrohet dhe të zëvendësohet me një bazë të re njohurish. Me këtë rast shpesh thuhet që njohuritë ekzistuese duhet të fshihen plotësisht dhe të ndërtohet një bazë e re. Por, shumë organizata përpiqen t'i rezistojnë ndryshimeve për arsye të performancës së mirë të tyre. Rezistimi për të ndryshuar është identifikuar si vështirësi për shlyerjen nga mendja të njohurive të vjetra.⁷⁴ Sidoqoftë, është shumë e vështirë të hiqet dorë nga njohuritë e vjetra që janë fituar gjatë një kohe të konsiderueshme. Mendohet se vetëm nxitësit e mësimit organizativ mund të gjenerojnë procesin e shlyerjes së njohurive të fituara nga përvoja.

Megjithatë, shumica prej organizatave fillojnë me procesin e mësimit organizativ vetëm atëherë kur përballen me vështirësi të ndryshme si, krizat financiare, rënia e qarkullimit, apo ndryshimet e udhëheqjes. Këta faktorë konfirmojnë pamjaftueshmërinë e kapacitetit veprues dhe aftësinë për zgjidhjen

⁷⁴ William W.Lee & Karl J.Krayer, "Organising Change", 2003;

=====

e problemeve. Përgjithësisht, për këto arsye organizatat mund t'i ndërrojnë strukturat e vjetra, njohuritë, konceptet dhe programet e vjetra me të reja.

Në literaturë njihen disa barriera të këtij procesi të cilat grupohen si në vijim⁷⁵:

- Modelet defensive të organizatës
- Normat, privilegjet dhe temat tabu
- Shtrembërimi i informacionit

4.1 Modelet defensive të organizatës

Sjelljet e individëve gjatë rrethanave të vështira dhe kërcënuese bëjnë që të mos lëshohet situata nga kontrolli për asnjë çmim. Këto sjellje të punëtorëve janë të njohura si paaftësi e të kualifikuarve. Ky term përdoret për të shpjeguar përpjekjet e punëtorëve për t'ju shmangur situatave kërcënuese. Në procesin e shmangies nga këto situata njerëzit shpesh gënjëjnë dhe trillojnë gjëra. Pra kjo sjellje e individëve ndodh për shkak të ruajtjes së “fytyrës” apo karakterit personal.

Rutinat defensive ngjajnë atëherë kur individët injorojnë apo i kalojnë gabimet e ndryshme që ndodhin në organizatë dhe nuk flasin për to me kolegët e punës apo me eprorët e tyre. Rutinat defensive krahasohen me “Ekonominë e zezë” dhe me “Mafinë”. Këto lloj rutinash mund të quhen mekanizma që shfrytëzohen nga individë të caktuar për të mbrojtur veten e tyre. Ato mund ta shkatërrojnë organizatën ngadalë dhe ta reduktojnë shkallën e efikasitetit të tyre. Këto rutina mund të shihen si pengesë apo barrierë e konsiderueshme për aplikimin e procesit të mësimit organizativ. Hap i rëndësishëm kundër këtyre rutinave është ndërhyrja dhe frenimi i tyre nga ana e menaxhmentit. Sidoqoftë, është shumë e vështirë të luftohet kundër tyre sepse ekziston rreziku i dështimit dhe pastaj gjërat mund të acarohen edhe më shumë.⁷⁶

Imagjinimi i gjërave - i referohen sjelljeve të caktuara të individëve që ju mundëson atyre ta mbrojnë vetveten duke u shtirë si të verbër (që nuk kanë parë asgjë) apo duke i fajësuar të tjerët për gabimet e natyrave të ndryshme që ndodhin brenda organizatës. Kjo lloj sjelljeje është shumë e rrezikshme sepse mund të bëhet pjesë e kulturës së organizatës. Kjo bën që punëtorët mund ta ndjejnë veten jo mirë dhe jo të sigurt në organizatë. Imagjinimi i gjërave emërtohet edhe si sëmundje, pasi që mund të lëshojë rrënjë dhe të bëhet sjellje e rëndomtë e anëtarëve të organizatës. Kjo sëmundje mund të shërohet duke e trajtuar sindromën, si dhe duke i sulmuar shkaktarët drejtë në kokë.

⁷⁵ William W.Lee & Karl J.Krayer, “Organising Change”, 2003;

⁷⁶ Argyris, 1990, pp. 25-30

4.2 Normat, privilegjet dhe temat tabu

Këto barrierat janë një grup tjetër i barrierave që identifikohen si mekanizma për të penguar procesin e mësimit. Normat mund të jenë barrierat në rastet kur individët/grupet nuk guxojnë të devijojnë nga rregullat për shkak të vërejtjeve publike. Normat mund të marrin formën e kodit të veshjes, marrëveshjet e punës, si dhe forma të tjera të ngjashme të sjelljeve brenda në organizatë.

Privilegjet dhe temat tabu gjithashtu e bëjnë mësimin të vështirë. Ato kanë të bëjnë me moralin dhe zakonet (pjesë të kulturës organizative), që është shumë e vështirë të ndryshohen apo të evitohen. Ndonjë person i privilegjuar mbase nuk heq dorë lehtë nga privilegjet që i gëzon, si dhe temat tabu janë të rrënjësura në mendjet e njerëzve dhe është tepër vështirë të shndërrohen në tema të lira e të diskutueshme.

4.3 Shtrembërimi i informacionit

Gjithashtu si barrierat e tjera, edhe shtrembërimi i informatave pengon procesin e mësimit në organizatë. Kjo barrierë ka të bëjë me çrregullimin e rrjedhës së informacionit apo mos transmetimin e drejtë të informatës personave të caktuar. Një sistem informativ i varfër në organizatë gjithashtu mund të paraqes pengesë për aftësinë e të mësuarit. Informata mund të bllokohet, filtrohet apo thjeshtë nuk mbërrin në kohën dhe vendin e duhur. Në disa organizata informata shtrembërohet apo edhe nuk transmetohet fare tek vendim-marrësit për shkaqe të ndryshme, e që mund të jenë: hierarkia e theksuar, burokracia e tepruar, aspekti i specializimit të punëve, centralizimi i autoritetit, frika e punëtorëve nga pasoja e informatës së saktë, marrëdhëniet jo të mira në mes të personelit, etj. Në disa raste, informata e pakëndshme mund të mos përfillet gjithashtu. Mu për këto arsye menaxherët nuk kanë vështirësi real për organizatën dhe pastaj ballafaqohen me vështirësi dhe pasoja. Kur menaxherët janë të vetëdijshëm për pasojat që rrjedhin nga këto barrierat atëherë është më lehtë të ndërmerren masa që në fillim në mënyrë që ato të reduktohen maksimalisht apo edhe të evitohen plotësisht.

PËRFUNDIMI

Me qëllim që organizatat e sotme të ballafaqohen me kompleksitetin duhet të rrisin njohuritë e tyre. Këto njohuri përveç që duhet të shtohen dhe pasurohen në vijimësi ato duhet të ristrukturohen e të ndryshohen vazhdimisht, varësisht nga rrethanat dhe kushtet e caktuara. Mu për këto arsye aftësia për të mësuar është me rëndësi të jashtëzakonshme. Në këtë kontekst, organizatat nevojitet që të fokusohen dhe kapacitetet e tyre t'i orientojnë drejt mësimit.

Me procesin e mësimit organizativ krijohen njohuri të reja të cilat i mundësojnë organizatave të mbajnë ritmin e tyre të zhvillimit dhe kështu qojnë në një qëndrueshmëri afatgjate të arritjes së qëllimeve. Pasi që njohuria shpesh është një burim i vetëm i mundshëm, ndërmarrja duhet ta trajtojë me kujdes dhe ta përdor atë me mençuri. Kjo njohuri mund të merr disa forma. Për shembull, është njohuria për konsumatorët apo ajo për proceset e prodhimit. Ajo mund të jetë rezultat i edukimit formal apo thjeshtë një intuitë. Në qoftë se kjo njohuri mbetet në ndërmarrje dhe bëhet pjesë e entitetit social, ndërmarrja dhe anëtarët e saj mund ta përdorin dhe të përfitojnë nga ajo.

Vetëm mësimi i vazhdueshëm dhe krijimi i njohurive mund të ndihmojë në sigurimin e suksesit afatgjatë të ndonjë ndërmarrjeje. Për këtë, NVM-të duhet t'i bëjnë njohuritë e tyre të përdorshme për të tjerët. Rrjedhimisht, mësimi organizativ është pra një proces që shpie drejt krijimit të njohurive organizative, të cilat i mundësojnë asaj të zhvillojë muskujt për të përballur me sukses me sfidat që i imponohen nga jashtë.

Literatura

1. Argyris, Chris, "On Organizational Learning", 2nd Edition, Massachusetts, Blackwell, 1999;
2. Bob Nelson & Petter Economy, "The management bible", 2005;
3. Claudia Baca, "Project manager's spotlight on change management", 2005
4. Ian Brooks, "Organisational Behaviour", 2003;
5. Michael Stankosky, "Creating the discipline of knowledge management", 2005;
6. Nonaka, Ikujiro/ Takeuchi, Hirotaka, "The knowledge-creating company: how Japanese companies create the dynamics of innovation", New York, Oxford University Press, 1995;
7. Robert E. Johnston, Jr, J. Douglas Bate, "The power of strategy innovation", 2003;
8. Senge, Peter, "The Fifth Discipline – The Art & Practice of the Learning Organization", London, Doubleday/Currency, 1990;

9. Stewart, Thomas A., "Intellectual Capital – The New Wealth of Organizations", London, Nicholas Brealey, 1998;
10. Stevenson, Lois/ Lundström, Anders, "Patterns and trends in entrepreneurship/SME policy and practice in ten economies", Örebro: Swedish Foundation for Small Business Research, 2001;
11. Selmanaj Selman, "Globalizimi dhe Tranzicioni – dilemat dhe sfidat", 2006;
12. Takeuchi, Hirotaka, 2001, "Towards a Universal Management of the Concept of Knowledge", in: Nonaka, Ikujiro, Teece, David J. (Eds.), 2001; "Managing Industrial Knowledge", London, Sage;
13. William W.Lee & Karl J.Krayer, "Organising Change", 2003;
14. World Economic Forum, "Globalization of alternative Investments", Annual Report 2008;

KUD 371.3(496.51)

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në kornizën e kurrikulumit të Kosovës

*Dr. Edmond Beqiri
ebeqiri@gmail.com*

Abstrakt:

Autori këtë punim kërkimor e përgatiti i angazhuar në cilësinë e anëtarit të rregullt të Këshillit Shtetëror të Kosovës për Kurrikula (KSHKK), në të cilin është emëruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, si ekspert dhe përgjegjës për programet e ndërlidhura me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit. KSHKK është themeluar që nga viti 2008 dhe është në fazën e aprovimit të Kornizës së re kurrikulare të Kosovës, pas përfundimit të suksesshëm të diskutimit publik në muajin nëntor 2010. Për më shumë se 2 vjet KSHKK që formohet nga 20 anëtarë eminentë të fushave dhe disiplinave të ndryshme, kryesisht nga 2 ekspertë të lëmenjëve të: matematikës, Gjuhës shqipe, gjuhëve të huaja, TIK, historisë, gjeografisë, pedagogjisë etj. dhe i ndihmuar nga Ekipi Teknik (ET) bëri një punë shumë studioze në ndërtimin e një koncepti të ri për kurrikulin e Kosovës, i cili është i bazuar në kompetencë të studentët. Autorin e ndihmuan anëtarët e ekipit teknik të caktuar nga MASHT, të cilët mblodhën të dhëna në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit në institucionet arsimore të Kosovës. Nga analiza e rezultateve është ardhë deri te përfundimet relevante mbi TIK dhe rolin e teknologjive të informacionit në implementimin e kornizës kurrikulare të bazuar në kompetencë.

Fjalët kyçe: Kurrikulum, teknologji, informacion, kompetencë, komunikim, arsim, ekonomi

JEL Kualifikimi: O030; O032;

1. HYRJE

Kurrikulumi nënkupton tërësinë e fushave mësimore, lëndëve dhe çështjeve ndërkurrikulare që gjenden në një sistem arsimor. Në kuptim më të gjerë, kurrikulumi përfshin edhe aspektet e metodologjisë së mësimdhënies, vlerësimit dhe materialeve mësimore.

Korniza e Kurrikulimit të Kosovës paraqet vizionin për zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulimit në Kosovë, të bazuar në kompetenca dhe që në qendër ka Studentin, duke integruar dhe pasqyruar vlerat dhe parimet thelbësore të të drejtave të njeriut, të bashkëjetesës, të të drejtës shoqërore dhe të gjithëpërfshirjes.

Po ashtu, ajo parasheh zgjidhje kurrikulare, të cilat i kanë parasysh nevojat e studentëve, duke ofruar qasje të barabartë dhe arsim cilësor për të gjithë. Në të njëjtën kohë, Korniza e Kurrikulimit paraqet edhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet zhvillimi dhe zbatimi i kurrikulimit, duke përfshirë harmonizimin e kurrikulimit në arsimimin dhe aftësimin e mësimdhënësve, vlerësimin dhe menaxhimin e shkollës dhe të klasës.

Korniza e kurrikulës së arsimit parauniversitar është një dokument zhvillimor bazë që në shkallë vendi sjell vlerat dhe qëllimet e përgjithshme të arsimit, përcakton se çka duhet të dijnë dhe për çka duhet të aftësohen studentët pas mbarimit të një niveli të caktuar të arsimit, përcakton përmbajtjet mësimore dhe jep udhëzime si të zhvillohen ato dhe si të përcillet dhe vlerësohet cilësia e të arriturave të studentëve dhe puna e shkollave në Kosovë.

Korniza e kurrikulës është bazë për hartimin e të gjitha dokumeneteve tjera kurrikulare, si ato që kanë të bëjnë me kurrikulat lëndore, tekstet shkollore, mjetet dhe materialet mësimore, standardet dhe kriteret për vlerësimin e të arriturave të studentëve dhe të punës së shkollave në përgjithësi.

Në botën bashkohore, procesi i rishikimit dhe hartimit të kurrikulave gjithnjë e më shumë po demokratizohet dhe decentralizohet, duke përfshirë në këtë proces dhe duke bartur përgjegjësinë për ndryshimet, rezultatet dhe cilësinë e kurrikulës në shkolla (tek mësimdhënësit dhe drejtuesit) dhe tek studentët, prindët e komuniteti si dhe tek subjektet tjera që janë përfutës nga arsimi dhe edukimi.

1.1. Kurrikula e arsimit e bazuar në kompetencë me anë të shfrytëzimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit

Për dallim nga qasja tradicionale që kryesisht ishte e orientuar në zgjedhjen dhe strukturimin e përmbajtjeve mësimore në plan-programe, qasja kurrikulare është e bazuar në zhvillimin e kompetencave të studentët/studentit, si qëllim kryesor të arsimit dhe edukimit.

Qasja kurrikulare në arsim në vend të përcjelljes së dijes nga mësimdhënësi tek studenti, është e përqëndruar në zhvillimin e kompetencave të studentët, që janë të standardizuara në shkallë vendi. Pra, kurrikula duhet të

=====

përcakton se çka duhet dhe çka mund të mësojë dhe të dijë studenti i moshës së caktuar; cilat aftësi, shkathtësi dhe qëndrime duhet dhe mund t'i zhvillojë dhe formojë ai, në një periudhë të një cikli zhvillimor, që rigorozisht nuk kufizohet në kohë në periudhën prej një viti shkollor.

Kjo qasje mundëson matjen, vlerësimin dhe notimin e të arriturave të studentëve në nivel vendi, vlerësimin e rezultateve të përgjithshme në arsim dhe ndihmon në orientimin e drejt të politikave arsimore drejt përmirësimeve të vazhdueshme dhe arritjes së rezultateve kulmore në arsim dhe edukim.

Qasja kurrikulare u siguron institucioneve shkollore dhe mësimdhënësve një autonomi më të madhe në dizajnimin e kurrikulave dhe në punën e tyre në përgjithësi, por njëkohësisht rritë dhe nivelin e përgjegjësisë së tyre për rezultatet dhe cilësinë e të arriturave të studentëve dhe të shkollave.

Korniza e kurrikulës mundëson futjen e lëndëve të reja mësimore dhe të temave të reja ndërdisiplinare si dhe largimin e lëndëve dhe temave që konsiderohen të tepërta dhe të vjetëruara.

Ndërkaq, zhvillimin dhe implementimin e reformave në arsim korniza e kurrikulës i projekton si një qasje të kombinuar nga lartë-poshtë dhe nga posht-lartë, në harmoni me politikat arsimore në shkallë vendi, ku marrin pjesë e bashkëpunojnë në mënyrë konstruktive të gjithë faktorët e interesuar relevantë të shoqërisë kosovare. Vetëm kështu, reforma e arsimit mund të shndërrohet nga vizioni në realitet të përditshëm shkollor.

Kurrikula e orientuar në zhvillimin e kompetencave të studentët, aktualisht është trend evropian dhe botëror i politikave arsimore. Kështu, për të iu përgjigjur me sukses sfidave të shoqërisë së dijes dhe tregut global, Unioni Evropian me dokument të veçantë ***“Recommendation of the European Parliament and of the Council of 18 December 2006 on Key Competences for lifelong learning, 2006/962/EC”***, ka përcaktuar tetë kompetenca bazë për mësim gjatë gjithë jetës:

1. Komunikimi në gjuhë amtare
2. Komunikimi në gjuhë të huaja
3. Kompetenca matematike dhe kompetenca themelore në dije e teknologji
4. Kompetenca digjitale
5. Të mësosh si të mësosh
6. Kompetenca sociale dhe qytetare
7. Kompetenca për iniciativë dhe ndërmarrësi
8. Vetëdija kulturore dhe e të shprehurit.

Zhvillimi i këtyre kompetencave është një ndër qëllimet parësore të politikave arsimore të vendeve të Unionit Evropian dhe i vendeve tjera që synojnë integrimin në UE.

Kosova si vend i pavarur dhe sovran që është jetësisht i interesuar që në një të ardhme të afërt të integrohet në UE, duhet që këto kompetenca t'i inkorporojë në kurrikulën e vet arsimore. Për më tepër, përveç vlerave dhe

traditës arsimore që është trashëguar nga e kaluara gjatë hartimit të politikave arsimore dhe gjatë zhvillimit të kurrikulës, duhet bazuar edhe në dokumentin e mësipërm dhe në dokumentet tjera të rëndësishme evropiane.

Sipas dokumentit në fjalë, kompleksiteti i botës në të cilën po jetojmë sot, shtron nevojën që arsimimi dhe edukimi nuk duhet redukuar dhe kufizuar vetëm në periudhën e shkollimit formal, por duhet vazhduar gjatë gjithë jetës së një individi.

1.2. Rrethanat e reja në Kosovë dhe rëndësia e arsimimit në fushën e TIK

Republika e Kosovës është shteti më i ri në Evropë, që ndodhet në mes të Evropës Juglindore. Ajo ka shpallur pavarësinë me 17 shkurt 2008, pas gati dhjetë vjet administrimi nga Kombet e Bashkuara (KB) dhe tri vjet bisedash mbi statusin me ndërmjetësim e aktorit ndërkombëtar. Popullsia e Kosovës llogaritet të jetë rreth 2 milionë që jetojnë në një territor prej 10,908.1 km² (Enti i Statistikave të Kosovës).

Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet tjera në fuqi garantojnë të drejtën e çdo qytetari në arsim në përputhshmëri me mundësitë dhe nevojat e tij/saj.

Kosova është shoqëri e re, dinamike dhe shumëetnike. Pothuajse një e katërta e popullsisë vijon çdo vit njërin nga nivelet formale të arsimit. Sa për ilustrim të kësaj që u tha, dy tabelat e mëposhtme paraqesin numrin e nxënësve që vijojnë arsimin fillor, të mesëm të ulët apo të mesëm të lartë gjatë viteve 2002-2008.

Tabela 1. Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët gjatë viteve 2002-2008





Tabela 2. Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë gjatë viteve 2002-2008



Burimi: Enti i statistikave të Kosovës

Një ndër synimet kryesore të arsimit në Kosovë është zhvillimi i dijes, shkathtësive dhe qëndrimeve që i kërkon qytetaria demokratike. Kjo do t'u mundësojë të rinjve që të jenë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm. Vëmendje e posaçme në kuadër të arsimit për qytetari demokratike do t'i kushtohet edhe karakterit shumëetnik dhe shumëkulturor të shoqërisë kosovare, duke u mundësuar studentëve që të përballen në mënyrë konstruktive dhe pozitive me dallimet, si dhe duke u mundësuar atyre të kultivojnë dhe respektojnë të drejtat e tyre dhe të drejtat e të tjerëve.

Shoqëria kosovare tani është rilidhur me zhvillimet e fundit në shkencë, teknologji dhe kulturë. Mundësitë për një dialog të ri ndërmjet sistemit arsimor të Kosovës dhe sistemeve tjera progresive të arsimit në botë, tani kanë një shans të ri. Në këtë kuptim, një synim tjetër i rëndësishëm i arsimit në Kosovë është pajisja e studentëve me informatat më të reja dhe shkathtësi funksionale të cilat do t'u ndihmojnë që të përballen me sfidat e një shoqërie të nxënies dhe me perspektivat e të nxënës në një botë të ndërvarur.

Studentët do të aftësohen për të shfrytëzuar në mënyrë kreative dijen dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja; që të angazhohen në mënyrë individuale dhe në bashkëpunim më të tjerët në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve, si dhe të ushtrojnë shkathtësitë për të mendim të pavarur dhe kritik.

Studentët do të jenë në gjendje të ndërlikojnë dijen teorike me aktivitetet praktike, do të kenë qëndrim pozitiv ndaj të të nxënës si dhe do t'i zbatojnë dijet e nxëna dhe shkathtësitë e zhvilluara për studime të mëtejme, punë dhe jetë private e publike.

Studentët do të përkrahen që të zhvillojnë vetëbesimin dhe motivimin pozitiv, si dhe të shfrytëzojnë të drejtat e tyre. Ata do të përkrahen që të kultivojnë kërshtërinë e tyre si dhe qëndrimin pozitiv ndaj ndryshimeve, përkritazi me idetë, fenomenet, personat, kulturat etj.

1.2 Konteksti ndërkombëtar dhe global

Sfidat dhe mundësitë e tjera me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare përfshijnë:

- **Shoqëria e dijes dhe e ekonomisë.** Për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe shoqërore gjatë dekadave të fundit, qasja në dije (veçanërisht përmes TIK) sot është e pakufizuar, gjë që ka kontribuar në demokratizimin e qasjes dhe shfrytëzimit të dijes në mbarë botën. Sot dija, gjithnjë e më tepër, shihet si një mjet i rëndësishëm i prodhimit dhe mirëqenies. Për shkak të kësaj qasjeje virtualisht të pakufizuar ndaj informatave dhe nevojës për t'u përballur me kontekste dhe sfida të reja, shkollat duhet t'u ndihmojnë të rinjve, që krahas kompetencave e përgjithshme për jetë dhe punë, të zhvillojnë edhe kompetencat adekuate për qasje dhe përpunim të informacionit në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.
- **Rritja e ndërvlerësive dhe lëvizshmërisë.** Në sajë të ndikimit të aspekteve të ndryshme të globalizimit (për shembull, në sferën e komunikimit, kapitalit, udhëtimit, arsimit, kulturës, migrimit, stilit të jetesës) të gjitha vendet e botës sot janë gjithnjë e më të ndërvleruara. Kjo ka ndikim në identitetin individual dhe kolektiv dhe në atë se çfarë perceptohet si "universale" apo "ndërkombëtare" krahasuar me atë që konsiderohet tradicionale, "vendore" dhe "kombëtare". Më shumë se kurdoherë më parë të rinjtë duhet të jenë në gjendje t'i përshtaten ndryshimeve të shpejta dhe të paparashikuara, si për shembull kriza e fundit ekonomike dhe financiare, shpërndarja e sëmundjeve ngjitëse dhe konfliktet e vazhdueshme.
- **Të mësosh të jetosh së bashku.** Raporti i vitit 1996 i Delors et al. për UNESCO-n, "Të mësosh të jetosh së bashku" paraqet një ndër sfidat kryesore në një botë të hapur dhe të ndërvleruar, përfshirë menaxhimin konstruktiv të dallimeve, zgjidhjen paqësore të konflikteve, tolerancën, respektin për vetveten, respektin për të tjerët dhe mirëkuptimin ndërkulturor si dhe komunikimin efektiv. "Të mësuarit për të jetuar së bashku" është një prioritet edhe për Kosovën, kur kihet parasysh procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, në të cilin Kosova synon të marrë pjesë aktive. Kjo përfshin promovimin e vlerave dhe të praktikave që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen, qytetarinë demokratike dhe të drejtat e njeriut në kontekstin e jetës publike, profesionale dhe private.
- **Zhvillimi i qëndrueshëm.** Në një botë gjithnjë e më të globalizuar në të cilën cilësia e jetës në tokë për gjeneratat e tanishme dhe ato të ardhshme është e kërcënuar, studentët duhet të pajisen me dije, shkathësi dhe qëndrime për t'u kujdesur me përgjegjësi për ambientin e krijuar nga natyra dhe nga dora e njeriut, në mënyrë që t'i shmangen shpërdorimit të burimeve dhe praktikave të tjera të papërgjegjshme. Kjo kërkon që të

rinjtë të vetëdijesohen, jo vetëm për parimet dhe përvojat e kohezionit shoqëror dhe gjithëpërfshirjes, por edhe për atë se si të luftohet varfëria, marginalizimi, diskriminimi dhe padrejtësia në mënyrë sa më efektive.

2. Teknologjitë e informacionit dhe parimet e Kornizës së Kurrikulumit

2.1. Roli i teknologjive të informacionit në mësimdhënien dhe mësimnxënien me studentin në qendër dhe gjithëpërfshirja

Korniza e kurrikulumit reflekton qasjen e bazuar në të drejtën për arsim në harmoni me vlerat dhe përvojat e respektimit të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Ajo merr parasysh situatat specifike të studentëve si dhe nevojat e mundësitë individuale për të kontribuar drejt zhvillimit të plotë të secilit studentët.

Në përputhje me këtë parim, Korniza e kurrikulumit promovon (a) të nxënë që reflekto përvojat paraprake të fëmijëve, interesat dhe mundësitë e tyre, (b) të nxënë që është kuptimplotë (p.sh. i orientuar në zgjidhje praktike të problemeve) dhe (c) përfshirje aktive të studentëve në përzgjedhjen e përvojave të të nxënit, duke qenë të vetëdijshëm për rëndësinë e përvojave të caktuara dhe në gjendje për të vlerësuar dhe vetvlerësuar rezultatet e të nxënit.

Në KK gjithëpërfshirja është marrë në kuptimin më të gjerë të fjalës përfshirë të gjitha rrethanat të cilat pengojnë qasjen në arsim cilësor dhe dallimet që manifestohen në forma të ndryshme (si pakicat; grupet në pozitë të pafavorshme ekonomike; fëmijët me nevoja të veçanta; fëmijët e kthyer nga diaspora dhe ata që ndodhen në diasporë; studentët e viseve të largëta; studentët e talentuar dhe me dhunti; studentët që përjetojnë sëmundje dhe trauma; studentët me probleme në sjellje).

Nëpërmes shfrytëzimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit Korniza e kurrikulumit mundëson zgjidhje të modifikueshme për t'i trajtuar dallimet e studentëve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar kështu në zhvillimin e plotë të potencialeve mësimore të secilit individ. Duke i pasur parasysh nevojat individuale dhe stilet e të nxënit, përvojat mësimore në shkollë do të nxisin motivimin për mësim si kusht për përmirësimin e vijueshmërisë së shkollës dhe nivelit të arritshmërisë së studentëve.

2.3. Teknologjitë e informacionit te mësimdhënia dhe mësimnxënia e integruar

Korniza e kurrikulumit promovon të nxënë të plotë që integron dhe reflekton ndërlidhjet dhe ndërvlerësitë si në natyrë dhe në botën e krijuar nga njeriu, ashtu edhe në dijen dhe informacionin që ne kemi për to.

Për të mundësuar një qasje të tillë korniza e kurrikulumit parasheh si vijon:

- Organizimin e përvojave mësimore në fusha të gjera mësimore në kuadër të të cilave përmbajtja lëndore është e ndërlidhur me çështjet ndërkurrikulare dhe kontribuon në zhvillimin e kompetencave kryesore;
- Përforcimin e ndërlidhjes ndërmjet fushave të ndryshme mësimore;
- Fuqizimi i të nxënit të integruar përmes integritit të kurrikulumeve lëndore, për shembull integrimi i shkencave natyrore dhe integrimi i shkencave shoqërore në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët;
- Ndërlidhja kuptimplote ndërmjet aspektit konceptual dhe dimensioneve praktike, si zbatimi i dijes dhe shfrytëzimi i shkathtësive të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale;
- Integrimi i fushave të reja kurrikulare që reflektojnë zhvillimet në sferën shoqërore, ekonomike, kulturore apo të shkencës (si **teknologjia e komunikimit dhe informimit, mësimi elektronik, vetëdijesimi mbi mediat, shkathtësitë jetësore**);
- Perspektiva e të nxënit gjatë gjithë jetës: kurrikulumi do t'i përgatisë studentët që të përballen me sukses në jetën e tyre të përditshme me sfidat e vazhdueshme dhe mundësitë që ofron një shoqëri dhe ekonomi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mësimi për të nxënë, aftësive për **shfrytëzimin e teknologjive të reja** dhe kompetencat për vlerësimin dhe
- procedimin efektiv dhe të ndërgjegjshëm të **informacionit**.

2.3. Roli i TIK te fleksibiliteti dhe mundësia për lëvizje

Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe Korniza e kurrikulumit lejon marrjen e vendimeve në nivel shkolle dhe në mënyrë të decentralizuar (afërsisht 10%-20% të kohës shkollore). Duke u bazuar në parimet dhe normat e autonomisë së shkollës, shkollat do të jenë në gjendje që të vendosin se si ta shfrytëzojnë këtë kohë në mënyrën më të mirë për të kontribuar drejt përvetësimit të dijes dhe zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve sipas resurseve lokale, nevojave dhe veçantive të bashkësisë ku vepron shkolla dhe prospekteve zhvillimore të tij. Shkollat mund të zhvillojnë edhe elemente shtesë kurrikulare për të përmbushur nevojat e veçanta të studentëve të asaj shkolle si dhe për të reflektuar rrethanat në të cilat shkolla përkatëse vepron.

Fleksibiliteti po ashtu i referohet planifikimit dhe shfrytëzimit fleksibil të kohës shkollore duke mundësuar kështu forma të mësimdhënies ndërvepruese.

2.4. Transparenca dhe llogaridhënia

Me anë të teknologjive të informacionit dhe komunikimit, transparenca dhe llogaridhënia në mënyrë shumë efektive i referohen edhe sistemit të arsimit në tërësinë e tij edhe procesit të zhvillimit dhe zbatimit të kornizës së kurrikulimit.

Procesi i zhvillimit të Kornizës së kurrikulimit është mbështetur në qasje gjithëpërfshirëse, duke i përfshirë të gjitha palët e interesuara. Procesi i zbatimit do të monitorohet dhe vlerësohet në pajtim me kriteret e cilësisë, duke marrë parasysh informatat kthyes dhe sugjerimet e pranuar nga përfituesit dhe palët e interesit.

Shkollat dhe mësimdhënësit do të përfshihen në procesin e rishikimit të kurrikulumeve ekzistuese dhe të zhvillimit të kurrikulumeve të reja. Shkollat do të përkrahen në mënyrë të drejtpërdrejtë për të siguruar një zbatim cilësor të kornizës së kurrikulimit dhe kurrikulumeve të reja, por edhe do të jenë përgjegjëse për mënyrën e shfrytëzimit të mundësive dhe të resurseve në dispozicion për sigurimin e nivelit të kënaqshëm të arritshmërisë së studentëve.

3. Roli i TIK në realizimin e qëllimeve të arsimit dhe rezultatet e pritura (kompetencat e studentëve)

3.1 Qëllimet e arsimit

Formulimi i qëllimeve dhe objektivave të arsimit në Kosovë ka parasysh realitetin e shoqërisë kosovare pas shpalljes së pavarësisë, në kuptim të zhvillimit demokratik, përparimit të ekonomisë dhe hapjes ndaj botës. Qëllimet e arsimit në Kosovë janë:

- Zhvillimi personal
- Kultivimi i identitetit individual, përkatësisë shtetërore dhe mirëkuptimit ndërkulturor
- Promovimi i të drejtave të njeriut dhe qytetarisë demokratike
- Përgatitja për jetë, punë dhe zhvillim të qëndrueshëm

3.1.1. Zhvillimi personal: Arsimi do të përkrahë zhvillimin e personalitetit të studentëve dhe potencialin e plotë të aftësive të tyre.

Arsimi do të kontribuojë në zhvillimin e plotë të potencialit të individit nga perspektiva që favorizon qasjen për zhvillimin e plotë të personalitetit, pa paragjykime dhe të pavarur. Studentët do të përkrahen në zhvillimin e tyre si individ, duke balancuar zhvillimin e aspektit intelektual, emocional dhe motorik të personalitetit të tyre, duke përforcuar vetëbesimin, motivimin pozitiv dhe kapacitetin për të shfrytëzuar në mënyrë të duhur të drejtat e tyre e duke respektuar identitetin dhe të drejtat e të tjerëve.

3.1.2. Kultivimi i identitetit individual, përkatësisë shtetërore dhe mirëkuptimit ndërkulturor: Arsimi do të nxisë vetëdijesimin kulturor dhe mirëkuptimin ndërkulturor, si dhe sensin kompleks të identitetit shumë-shtresor.

Arsimi do të zhvillojë te studentët respektin ndaj prindërve dhe mësimdhënësve të tyre, identitetin e tyre kulturor, gjuhën dhe vlerat, si dhe ndaj vlerave të Republikës së Kosovës dhe Kushtetutës së saj.

Arsimi do të ndihmojë studentët që të njohin dhe respektojnë identitetin e tyre lokal, etnik e kombëtar, si dhe do t'u mundësojë atyre që të jenë të hapur për pasurimin e identitetit të tyre personal përmes ndërvarshmërisë së botës së sotme. Studentët do të përkrahe që të kuptojnë se identiteti jo vetëm që dallon njerëzit, por përfshin edhe atë që i bën ata pjesë të një bote më të gjerë. Konceptet e identitetit më të gjerë, shumështrësor, do të jenë mundësi për pasurim të identitetit personal dhe shoqëror dhe nuk paraqesin rrezik për asnjë identitet individual, lokal apo kombëtar.

Ndërtimi i identitetit fillon në familje dhe në komunitet dhe vazhdon të kultivohet gjatë tërë jetës. Të gjitha përvojat e reja janë të lidhura me ato paraprake. Arsimi duhet t'i aftësojë studentët që të kuptojnë dhe vlerësojnë traditën e familjeve dhe shoqërisë ku jetojnë, si dhe të ju mundësojë atyre që të jenë të hapur ndaj historisë dhe kulturës së bashkësive tjera etnike dhe të shteteve tjera.

3.1.3. Promovimi i të drejtave të njeriut dhe qytetarisë demokratike:

Arsimi do të zhvillojë njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime që i kërkon qytetaria demokratike me qëllim të nxitjes së gjithpërfshirjes, të drejtës shoqërore dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke u bazuar në respektimin për të drejtat njerëzore dhe lirinë elementare të secilit.

Një nga të arriturat më të rëndësishme të dhjetëvjetëshit të fundit është fillimi i një procesi të vërtetë demokratik në Kosovë, në kuptim të ngritjes së një strukture të fuqishme dhe institucioneve demokratike. Kjo ndërlidhet me ringjalljen e shoqërisë civile dhe ndjenjës së dinjitetit individual dhe shoqëror.

Arsimi ka rol të madh në pajisjen e fëmijëve dhe të rinjve me njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera të nevojshme për angazhim kompetent dhe të përgjegjshëm në jetën e tyre private, publike dhe profesionale dhe për t'u bërë qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm të një shoqërie demokratike, pluraliste, të drejtë dhe koherente.

Edukimi për qytetari demokratike do të jetë pjesë e kurrikulimit, me vëmendje të posaçme në karakterin shumëetnik dhe shumëkulturor të shoqërisë kosovare, në mënyrë që t'u mundësojë studentëve të përballen në mënyrë konstruktive dhe pozitive me çështjet e dallimeve. Edukimi për qytetari demokratike do t'u mundësojë studentëve edhe njohjen, kultivimin dhe respektimin e të drejtave të tyre personale dhe të drejtave të të tjerëve, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuhësore, kulturore, religjioze, gjinore, e moshës, përgatitja shkollore dhe situata ekonomike e tyre.

Studentët do të përkrahen në zhvillimin e përgjegjësisë për vete, për të tjerët, për shoqërinë dhe për mjedisin. Zhvillimi i përgjegjësisë nënkupton zhvillimin e kapacitetit për ndërmarrjen e iniciativës dhe marrjen e vendimeve, përmbytjen e detyrave dhe obligimeve, si dhe vetëdijesimin për pasojat e veprimeve personale dhe kolektive.

3.1.4. Përgatitja për jetë, punë dhe zhvillim të qëndrueshëm: Arsimi do t'i përgatisë studentët për jetë dhe punë, duke i pajisur ata me kompetenca të nevojshme për t'u përballur me sfidat dhe mundësitë e së sotmes, në një shoqëri komplekse të bazuar në dije dhe ekonomi globale dhe për të kontribuar për një zhvillim të qëndrueshëm.

Shoqëria kosovare tani është e lidhur me zhvillimet ekonomike, shoqërore, shkencore, teknologjike dhe kulturore në Europë dhe botë. Duke pasur parasysh këto zhvillime, qëllim tjetër i arsimit është pajisja e studentëve me dije aktuale dhe të vlefshme dhe shkathtësi funksionale, të cilat u mundësojnë atyre që të përballen me sfidat e shoqërisë së dijes dhe ekonomisë globale, si dhe me prospektet e mësimi gjatë tërë jetës në një botë gjithnjë e më të ndërvarur, në të cilën mësimi për të jetuar së bashku dhe për zhvillim të qëndrueshëm janë sfidat thelbësore.

Studentët do të familjarizohen me ushtrimin e të drejtave dhe përgjegjësi brenda familjes, bashkësisë, botës së punës dhe jetës publike si dhe do të përkrahen që të marrin vendim adekuat për karrierën e tyre. Ata po ashtu do të udhëzohen për të kuptuar rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe do të inkurajohen që të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm në nivelin lokal dhe global.

Studentët duhet të jenë në gjendje të lidhin dijen me aktivitetet praktike, të zhvillojnë qëndrim pozitiv për mësimin dhe të aftësohen për të zbatuar njohuritë dhe shkathtësitë e përvetësuara në studimet e mëtejme, në punë, si dhe në jetën e tyre publike dhe private. Studentët do të aftësohen për të përdorur në mënyrë kreative njohuritë dhe shkathtësitë e tyre në situata të ndryshme dhe kontekste të reja, për t'u inkuadruar në mënyrë individuale dhe në bashkëveprim me të tjerët në zgjidhjen kreative të problemeve dhe për të menduar në mënyrë të pavarur dhe kritike. Ata do të inkurajohen për të zhvilluar kureshtjen dhe hulumtimin, si dhe të demonstrojnë qëndrime pozitive dhe konstruktive drejt dallimeve, në kuptim të ideve, fenomeneve, personave dhe të kulturave.

3.2 Koncepti i “kompetencave” si rezultate mësimore


Duke marrë parasysh kompleksitetin e botës me ndryshime të shpejta, ekziston një interes i gjerë për zhvillim të kurrikulumit të bazuar në kompetenca si një mënyrë për të nxitur të mësuarit produktiv dhe relevant. KKK është përcaktuar për *perspektivën e bazuar në kompetenca* me qëllim që të adresojë nevojat e ndryshme të studentëve për zotërimin e kompetencave kryesore, që do t'u mundësojnë të përballen me sfidat aktuale dhe sfidat e parapara të shoqërisë kosovare dhe të opinionit më të gjerë.

Theksimi i “kompetencave” nuk nënkupton mohimin e dijeve; qasja e bazuar në kompetenca supozon që gjatë definimit të rezultateve të pritura të kurrikulumit dhe të procesit mësimor si dhe gjatë përzgjedhjes dhe organizimit të përvojave mësimore të integrohen në mënyrë të balancuar njohuritë parësore dhe vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë. Qasja e bazuar në kompetenca dallon nga

qasjet që promovojnë mësim jorelevant, rutinor, të bazuar vetëm në memorizim dhe reprodukim të njohurive të parapërgatitura.

Figura e mëposhtme paraqet sistemin e kompetencave ku përfshihen, dijet, shkathtësitë, qëndrimet, vlerat, emocionet dhe rutinat.

Fig 3. – Sistemi i “kompetencave”; çfarë përfshijnë kompetencat?



Kompetencat kryesore janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura nga mënyra se si ato ndikojnë dhe përforcojnë njëra-tjetrën nga perspektiva e ‘personalitetit të plotë’.

4. Përfundimi me Rekomandime

Në bazë të analizës së rezultateve të punës 2-vjeçare në Këshillin Shtetëror për Kurrikula të Kosovës, autori erdhi në përfundim se rëndësia e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe të komunikimit në zhvillimin e kurrikulave të bazuara në kompetencë të studentëve është e rolit vendimtar.

Për këtë qëllim është e nevojshme që përveç pajisjes me teknologji të informacionit dhe të komunikimit të shkollave dhe institucioneve tjera arsimore, menjëherë të gjithë mësimdhënësit e Republikës së Kosovës të trajnohen të përdorin teknologjitë e reja hardverike dhe softverike në mënyrë që të mund të realizojnë programet me anë të të cilave do të mund të zhvillojnë tek studentët e tyre:

- Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit
- Kompetencat e të menduarit

- Kompetencat për të mësuar
- Kompetencat për jetë, punë dhe mjedis
- Kompetencat personale
- Kompetencat qytetare

Vetëm në këtë mënyrë do të arrihet që nxënësi dhe studenti të bëhet:

- Komunikues efektiv
- Mendimtar kritik
- Student i suksesshëm
- Kontribuues produktiv
- Individ i shëndetshëm

Referencat

1. Beqiri, Dr. Edmond, "ECTS në Universitetin e Prishtinës", Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2002
2. European Commission (2007). Electronic skills for the 21st century: fostering competitiveness, growth and jobs. <http://europa.eu/scadplus/leg/en/lvb/l24293.htm>
3. European Commission (2003). eLearning: Better eLearning for Europe. Directorate General for Education and Culture. Luxembourg. Office for Official Publications of the European Communities. http://www.elearningeuropa.info/directory/index.php?page=doc&doc_id=7641&doclng=6
4. Korniza e Kurrikulumit të Kosovës, Drafti i dytë në diskutim publik, MASHT prill-nëntor 2010
5. Lankshear, C., Snyder, I. and Green, B. (2000). Teachers and Technoliteracy: Managing Literacy, Technology and Learning in Schools. London: Allen & Unwin
6. Martin, A. (2006). Digital literacy needed in an "e-permeated" world - progress report of DigEuLit project. http://www.elearningeuropa.info/directory/index.php?page=doc&doc_id=6973&doclng=6
7. Mayes, T. & Fowler, C. (2006). Learners, Learning Literacy and the Pedagogy of e-Learning. In Martin, A. & Madigan, D. (Eds.) Digital Literacies for Learning, London: Facet, 26-33
8. Sørby, M. (2003). Digital Competence: from ICT skills to digital "bildung", Oslo: ITU, University of Oslo
9. Street, B. (1984). Literacy in Theory and Practice, Cambridge: Cambridge University Press

10. UNESCO (2006). Education for All Global Monitoring Report 2006, Paris: UNESCO Publishing. Retrieved 5 March 2008 from: www.unesco.org/education/GMR2006/full/chapt6_eng.pdf
11. Wood, E., Willoughby, T., Rushing, A., Bechtel, L. & Gilbert, J. (2005). Use of Computer Input Devices by Older Adults *Journal of Applied Gerontology*, 24, 419-438
12. Webber, S. and Johnston, B. (2000). Conceptions of information literacy: new perspectives and implications. *Journal of Information Science*, 26(6), pp.381-387.

=====

KUD 005: 338.246.025.88(496.51)

**MENAXHIMI I NDËRMARRJEVE TË PRIVATIZUARA NË KOSOVË,
KUSHT DHE MUNDËSI E RRITJES SË BIZNESEVE DHE PUNËSIMIT**

Prof.Dr.Fatos Ukaj
fatos_ukaj@yahoo.com

Abstrakt

Koncepti i transformimit të pronës është një “fenomen” me të cilin janë ndeshe edhe ndeshen të gjitha llojet-tipet e njohura të organizimeve ekonomike, në rastin e Kosovës pas viti 1999 kemi orvatjet dhe fillimin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore. Privatizimi u vlerësua nga ekspertet dhe liderët kosovar si domosdoshmëri për çuarjen përpara të tranzicionit dhe shtyrjes përpara të zhvillimit ekonomik në Kosovën e dal nga grabitja, bllokimi ,sanksionet me se 10 vjeçare nga ana e institucioneve të Serbisë. Mungesa e lirisë politike dhe e mundësisë se menaxhimit të pronës në industrinë dhe ekonomin e Kosovës e solli gjendjen e bizneseve buze rrënimit të bazës materiale por edhe të vete burimeve njerëzore si resurs primar për zhvillimin e aktiviteteve qoftë në tregun e brendshëm qoftë në tregun e jashtëm. Avancimi në procesin e privatizimit të kapaciteteve ekonomike në Kosovë duhej që të behej në kohën sa ma të shkurte , duke u bazuar në dëshirën dhe planet e administratorëve të ndërmarrjeve shoqërore (UNMIK-DTI, AKM,AKP), por siç ndodhe shpesh me planet e hartuara shpejt e shpejt, u vërejte dhe u bë e qarte se kjo është një sfidë si për institucionet ndërkombëtare ashtu edhe për institucionet qeverisë Kosovare që janë të ngarkuara me zhvillimin ekonomik të Kosovës. Privatizimi ndërmarrjeve shoqërore bëhet me metodën e Spin Off-it, ku nga ndërmarrja shoqërore në bazë të autorizimeve nga rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/13 dhe ligjit mbi Agjencionin Kosovar te Privatizimit (AKP) Nr-03/L-067, bëhet bartja e Pasurisë së ndërmarrjes shoqërore (të luajtshme dhe të paluajtshme) në një ndërmarrje të re (Newco) e cila regjistrohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe pastaj kjo ndërmarrje e re nëpërmes tenderit shitet dhe privatizohet duke e krijuar Qiradhënien për 99 vjet për tokën që e kanë Ndërmarrjet Shoqërore. Ekziston edhe modeli i përparuar i privatizimit me Spin Off-Special ku në të vërtet zbatohen rregullat e Spin offit të rregullt plus kushtëzimet me:

1) zotimin për investimin në ngritjen e kapaciteteve brenda dy viteve, dhe 2) zotimin për numrin e punëtorëve që do të punësoj Brenda dy viteve. Me e rëndësishmja që ndodhi e që nuk shkoj në favor të zhvillimi që keq menaxhimi, menaxhimi joprofesional, kontrolli i dobët (asfare) i menaxhmentit të ndërmarrjeve shoqërore, rrëshqitja e vazhdueshme drejt bankrotimit, rënia e rolit udhëheqës të menaxhmentit, humbja e motivimit nga ana e menaxherëve për arritjen e rezultateve në biznes. Kjo situatë nuk ishte aspak premtuese dhe

njëkohësisht e solli aktivitetin e ndërmarrjeve shoqërore në nivelin e vegjetimit apo mbijetesës nga denja me qira e hapësirave aty ku pat interes për të, rënia e aktivitetit solli edhe deri të humbja reale e vlerës së bizneseve.

Fjalët Kyçe: Privatizimi, menaxhimi, rritja ekonomike, ndërmarrjet, tranzicioni.

JEL Classification: L2, L26, M13

1. Hyrja

Menaxhmenti dhe të punësuarit në ndërmarrjet shoqërore pas vitit 1999 ishin të vetëdijshëm për mangësitë, dhe pengesat para tyre, por kishin vullnetin që pas një periudhe 10 vjeçare të rifillojnë me aktivitetet e tyre të ndërprera dhunshëm, me ndërmarrjet dhe pasurin e tyre të dhunuar dhe shfrytëzuar pamëshirshëm nga ana e menaxhmenteve të dhunshme të emëruara nga administrata serbe e kohës. Menaxhmenti i ndërmarrjeve shoqërore pra kishte vullnetin dhe dëshirën që të vazhdojnë aktivitetin por njëkohësisht hasen në vështirësit nga të cilat veçojmë:

- largimi 10 vjeçar nga aktiviteti i menaxhimit,
- ndërrimi i ambientit të punës dalluar nga koha kur ata ishin menaxher të suksesshëm,
- struktura organizative jo e qarte, pas viti 1999,
- numër I madh I punëtorëve, vjetrimi i forcës punuese dhe teknologjisë se instaluar,
- mungesa e aftësive dhe njohurive nga marketingu,
- grumbullimi I borxheve të papaguara,
- mungesa e ligjeve dhe rregulloreve për zhvillimin e biznesit,
- bllokimi i komunikimit me tregun rajonal, përkatësisht ndryshimeve në ato tregje ku ndërmarrjet kosovare kane qene prezentë ,
- konkurrenca e madhe,
- mungesa e përkrahjes financiare, logjistike dhe institucionale për menaxhmentin dhe biznesin në përgjithësi,



Fig.1 Te dhënat kanë të bëjnë me rezultatet e AKP në privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore gjer në muajin dhjetor 2009.

Ne ndërmarrjet shoqërore kosovare kane ekzistua potencialet ndërmarrëse (afariste), por në të shumtën e rasteve nuk janë vu në funksion, kjo për shume arsye por në e konsiderojmë mos organizimin dhe mbështetjen e vogël apo asfare nga institucionet përgjegjëse (qofte ato ndërkombëtare apo vendore). Identifikimi dhe vënia në funksion e këtyre potencialeve ndërmarrëse duke e kombinuar me reinzhinjeringun total dhe teknikat tjera moderne për rritjen e potencialeve të ndërmarrjeve do të kishte dhënë sigurisht një drejtim tjetër zhvillimit të ndërmarrjeve por edhe ekonomisë kosovare në tersi. Ketë po e shtrojmë si çështje pasi që në përgjithësi mendojmë se në Kosovë nuk ka me vend për „eksperimente“ të pritjes deri sa të ndodhe diç, por duhet punuar intenzivisht në shfrytëzimin e çdo mundësie për përfitime deri sa të vie koha të ndodhe aktiviteti i planifikuar, siç është rasti këtu me ndërmarrjet shoqërore në të cilat në pritje të privatizimit çdo gjë dhe çdo plan është lënë pa zbatua , e pikërisht këtu është humbe koha dhe ka ardhë deri të humbja e vlerës reale të ndërmarrjeve.




Fig.2 Struktura e Menaxhmentit nëpër Ndërmarrjet Shoqërore para privatizimit, dhe të dhënat kryesore.

Produktiviteti i ulte, kombinuar me neglizhencën, dhe mungesën e iniciativës së menaxhmentit të ndërmarrjeve shoqërore e ka sjellë situatën që edhe ekonomia kosovare të jete impotente, krahas me resurset, nevojat, kërkesat dhe mundësit. Shumica e menaxherëve kane ardhë në pozita duke ju falënderua „rrethanave“ dhe me pake programit të ofruar dhe referencave të reja, një numër sish kanë qene në pozita sepse kane qene menaxher në vitet 90’ta dhe gjene dhjetëra arsyetime nga me të ndryshmet për mos iniciativën e tyre. Ristrukturimi

nëpërmes privatizimit të ndërmarrjeve është dhe do të jete një proces i dhimbshëm, me të cilin janë ndeshe edhe ekonomit e vendeve tjera në rajon dhe me gjere. E dhimbshëm do të jete pikërisht për të punësuarit e ndërmarrjeve shoqërore të cilët mbasin pa marrëdhënie pune (edhe pse në shumicën e rasteve kjo ishte fiktive), menaxheret që do të gjenden në situatë për të udhëheq ndërmarrjen edhe pas privatizimit por me pronar të ri tash.

2. Ristrukturimi i Ndërmarrjeve ne funksion te Zhvillimit

Ky ristrukturim përmes privatizimit është i rolit kyç për ekonomin kosovare , dhe ky proces nënkupton :

- ndryshimet statusore, organizative, pronësore, që identifikohen si ristrukturimi organizativ, këtu duhet të hyje nevoja e angazhimit të menaxhmentit të nivelit me të larte,
- rregullimi I marrëdhënieve kreditor-debitorë, identifikohet si ristrukturimi financiar që do të mundësoj shlyerjen e obligimeve por edhe mënyrën moderne të menaxhimit financiar,
- ridefinimi I programeve prodhuese-shërbyese, identifikohet si ristrukturimi programor që do ti përshtatet konceptit të pronarëve të ri, por edhe ekonomia kosovare do të dijë se çfarë programe disponon dhe në cilët mund të llogaris,
- ndërrimet tjera që mund të pasojnë varësisht nga angazhimi dhe interesimi I pronarëve dhe menaxhmentit të rij, reinzhenjeringu, adaptimi I menaxhimit modern etj.

Kapitali i cili hynë në ndërmarrjet gjate procesit të privatizimit nuk do të shfrytëzohet për asnjërin nga këto pjese të procesit të ristrukturimit, përpos rregullimit të marrëdhënieve kreditore-debitorë të mbetura nga ndërmarrja. Mjetet e fituara pra do të përdoren për pagesën e burgjeve të vjetra dhe faktikisht nuk do të jene në funksion të zhvillimit të ndërmarrjeve dhe ekonomisë në përgjithësi, kjo është dobësi e vërejtur por e pa përmirësuar deri tani. Kapitali shtese që do dhe duhet të investohet në ndërmarrje pas privatizimit duhet të përballet me faktin e mungese se menaxhmentit cilësor, produktivitetit të ulet dhe jo inventivitetin e shprehur me herët para privatizimit. Kjo nëse pronari i ri vendos që të vazhdoj me strukturën ekzistuese , gjë që edhe ka ndodhe në shume raste të privatizimit.

3. Aftësimi i Menaxherëve për qeverisje moderne

Aftësimi i Menaxhmentit do të shërbente si një instrument në ristrukturimin organizativ të ndërmarrjeve. Ndërtimi i një kulture ndërmarrësi, pra menaxheret duhet të transformohen në frymën e ndërmarrësis, kjo duhet bere se pari për të mos lejuar rënien e mëtejme të aftësisë menaxhuse dhe të shfrytëzimit ma të madhe të resurseve të disponueshme njerëzore. Ky aftësim i

menaxhmentit dhe të punësuarve tjerë është një koncept I aplikuar në vendet që e përjetuan tranzicioni dhe mbështetet në “vullnetin e individit” që është kyç për suksesin e cilit do projekt ndërmarrësie. Me këtë metodë vete ndërmarrjes, menaxhmentit dhe të punësuarve u mundësohet të vene në pah dhe të rrisin potencialin e vete të përgjithshëm profesional. Ky projekt do të duhej të udhëhiqej nga ndërmarrja, mbështetet nga institucionet e qeveris se Kosovës ndërsa të implementohen nga profesionistët e menaxhimit, institutet profesionale dhe konsultantët profesional. Ndërlidhja e qeveris është e domosdoshme në mënyrë që të ndihmohet iniciativa ndërmarrëse e pronarëve të rij të ndërmarrjeve, të ruhet numri I të punësuarve, të shtyhet përpara zhvillimi ekonomik i Kosovës.

Sigurimi i Ekipeve të reja të Menaxherëve, me transformim-privatizim e ndërmarrjeve vihet deri tek një situatë dhe strukturë tjetër organizative dhe udhëheqëse që e karakterizon ekonomin e vendeve me orientim nga ekonomia e tregut. Me transformimin e ndërmarrjeve në shoqëri aksionare por edhe integrimin në korporata paraqitet dhe fiton në rendësi “menaxhmenti në ekip”. Kjo është koha kur nevojiten menaxhere që do të dine që me një kombinim optimal të resurseve të realizojnë fitim, ta bëjnë ndërmarrjen me efikase dhe të përvetësojnë një pjese të tregut për produktet dhe shërbimet e veta. Sigurish se jemi të vetëdijshëm se në kushtet tona ky lloj i kuadrit është resurs I rrallë dhe për këtë arsye duhet veprua në dy drejtime:

- një numër të kuadrit të ri të degëve të ndryshme duhet dërgua në përëndim për fitimin e përvojës, në mënyrë që ato përvoja ti implementojnë pas kthimit në ndërmarrjet tona,
- një numri të kuadrit që ekziston në vendet që disponon me dije duhet dhënë shansi, sepse ata në një afat optimal do të bëhen operacional.

Mënyra me efikase për të arrit stimulimin e menaxhmentit (ekipit menaxhues) për interaktivitet dhe invencion në kryerjen e punëve dhe detyrave do të ishte lidhja e pagës për fitimin e realizuar dhe përmirësimin e afarizmit të ndërmarrjeve, pra duke aplikua proporcionalitet në rritjen e pagës me përmirësimet e ndodhura. Është edhe një mënyrë e cila mund të aplikohet edhe në kushtet kosovare të zhvillimit të biznesit, kjo parasheh dhënien ekipit menaxhues efikas një numër të caktuar të aksioneve të ndërmarrjes nëse I realizojnë rezultatet e projektuara. Kjo do të ishte edhe një mase stimuluese për menaxheret që të ngrisin efikasitetin e afarizmit të ndërmarrjes.

4. Momenti aktual i menaxhimit në ndërmarrjet e Privatizuara,

Gjendja e zhvillimit të aktiviteteve afariste në ndërmarrjet e privatizuara në Kosovë ende është e pa hulumtuar në mënyrë të organizuar, pasi që edhe nuk ka ekzistua ndonjë program paraprak për përcjelljen e fatit të ndërmarrjeve të

privatizuara. Kohen e fundit janë në fillim të implementimit projektet për ndihmë ndërmarrjeve të privatizuara nga organizatat si USAID dhe AER që besojmë se do të kenë efektin bile në njohjen e gjendjes faktike të ndërmarrjeve të privatizuara. AKM si agjencion që ka privatizuar ndërmarrjet shoqërore është e obliguar të përcjell vetëm fatin e ndërmarrjeve të privatizuara me Spin Off Special (Feronikeli, Birraria e Pejës, etj), nga kjo mund të konkludohet se ndërmarrjet e privatizuara tërësisht janë në mëshirën e fatit dhe pronarëve të ri të tyre. Ajo çka është e njohur për ekspertet e ekonomisë është se një rol kyç në zhvillimin e bizneseve kanë dhe do ta ketë „faktori njeri“ të cilit resurs duhet kushtuar shume me shume rendësi se që ju ka kushtua në periudhën para privatizimit të ndërmarrjes. Këtu mendojmë pikësëpari në personelin në funksionet udhëheqëse të ndërmarrjeve, saktësisht i ashtuquajturit „top menaxhmenti“ i cili para privatizimit sipas analizave ka qene njeri prej „fyteve të ngushta“ dhe faktor kufizues në zhvillimin e biznesit të ndërmarrjeve.

Nga ajo që u mblodh në anketën me 45 ndërmarrje të privatizuara nga ana e AKM-së del se është fakt se në shumicën e ndërmarrjeve ka vazhdua aktiviteti afarist, gjë që e demanton të mendimin (vlerësimet paushallë) se blerjet janë bere kryesisht për qëllim të përfitimit të patundshmërisë (toka, ndertës) dhe se nuk ka programe adekuate për zhvillimin e bizneseve në ndërmarrjet e privatizuara. Ne numrin prej 45 ndërmarrjeve të anketuara u vërejt trend pozitiv në punësim, i cili segment i anketës na intereson ma se shumti .

Tabela. 1 Trendët e indikatorëve te punësimit nen ndërmarrjet e privatizuara.

N r.	Qestja e interesit	Ndërma rrjet në rajonin e Gjilanit	Ndërmar rjet në rajonin e Mitrovic e	Ndërmar rjet në rajonin e Pejës	Ndërmar rjet në rajonin e Prishtinës	Ndërmar rjet në rajonin e Prizrenit	Gjithsejt ë
1	Ndërmanje të anketuara	12	8	7	7	11	45
2	Te punësuar në NSH Para privatizimit	705	236	336	179	227	1,683
3	Te punësuar në Newco pas privatizim	490	261	221	310	517	1,799
4	Ndryshimi në % i numrit te punësuarve pas privatizimit(3:4)	70%	111%	66%	173%	228%	107%

Ne tabelle janë paraqit të dhënat duke krahasuar të dhënat për numrin e të punësuarve në NSh para privatizimit dhe numrin e të punësuarve në Ndërmarrjet e reja pas privatizimit.

Nuk ka rezultate pozitive në rritjen e punësimit por trendi është shpresëdhënës dhe inkurajues se zgjedhja e çështjes se vazhdimit të aktiviteteve afariste lidhet edhe me punësimin e forcës punuese e cila për ndryshim nga periudha para privatizimit kur nuk kane realizua të ardhura personale tash realizon pagë reale sipas gjendjes në tregun Kosovar. Nga anketa janë fituar edhe të dhënat tjera që janë inkurajuese dhe ofrojnë informata për lëvizjet pozitive në:

- rritjen e qarkullimit dhe profitit në krahasim me periudhën para privatizimit,
- rritjen e eksportit nga ana e ndërmarrjeve të privatizuara,
- zvogëlimi i shpenzimeve,
- fitimi i certifikatave të kualitetit ISO 9002,
- zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar,
- rritja e numrit të punësuarve,
- angazhimi i menaxhmentit me kualifikime dhe njohuri nga biznesi.

5. Rekomandime:

Ne vazhdim do të japim disa rekomandime për procesin e rëndësishme të krijimit të menaxhmentit modern dhe efikas në ndërmarrjet e privatizuara:

- Menaxhmenti i ri(ndodhe të jete ai i vjetëri) në Ndërmarrjet e Reja të insistoj në promovimin e nevojës për shfrytëzimin maksimal dhe efektiv të pasurive të ndërmarrjeve të privatizuara,
- Menaxhmenti i ri(ndodhe të jete ai i vjetëri) në Ndërmarrjet e Reja të insistoj tek investitorët në promovimin e nevojës për planifikim afatgjatë për investimet në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese dhe shërbyese,
- Menaxhmenti i ri(ndodhe të jete ai i vjetëri) në Ndërmarrjet e Reja të insistoj të faktorët në mjedisin e brendshëm dhe ai i jashtëm, në promovimin e sektorit privat si gjenerator i zhvillimit ekonomik të Kosovës nëpërmes ndërmarrjeve të privatizuara,
- Strukturimi organizativ i ndërmarrjeve duhet veçanërisht në lëmin e udhëheqjes të shikohet dhe trajtohet si çështje esenciale drejt dizajnit të një ndërmarrje e cila do të jete në gjendje të garoj me konkurrencën në tregun vendor por edhe ndërkombëtar,
- Dizajnimi i strukturës së ndërmarrjes të behet ashtu që të jete shumë transparente dhe bindëse vija e koordinimit dhe posaçërisht e Autorizimeve, Autoritetit dhe Përgjegjëseve të menaxhmentit, si ndaj pronarëve ashtu edhe ndaj vartësve të vete.

- Te krijohet një sistem i komunikimit dhe koordinimit të menaxhmentit dhe vartësve duke ikur nga burokratizimi i këtij komunikimi dhe bashkëpunimi.
- Te vlerësohet dhe të vendosen në mënyrë transparente instrumentet e motivimit të menaxhmentit por edhe të punësuarve në ndërmarrje, sepse vetëm posedimi i aftësive për kryerjen e një pune nuk është garanci se puna do të kryhet kualitativisht,
- Te përcaktohen përgjegjësit e menaxhmentit në mbajtjen dhe kultivimin e marrëdhënjëve ndërnjerëzore në ndërmarrje si kusht i realizimit me sukses të projekteve,
- Menaxhmenti i ri (ndodhe të jete ai i vjetëri) në Ndërmarrjet e Reja të insistoj në promovimin e nevojës për formimin e ekipeve të menaxhmentit të nivelit të mesëm me pjesëtarë të shkolluar në frymën e ndryshimeve moderne ne biznes, të cilët do të aftësohen që në një periudhë optimale të marrin mbi vete përgjegjësinë e udhëheqjes së ndërmarrjeve.
- Te përcaktohen mënyrat dhe metodat e matjes dhe kontrollit të sasisë dhe kualitetit të punës, respektivisht shpërblimit të menaxhmentit dhe të punësuarve sipas rezultateve.
- Te aktivizohen ministrit përkatëse të qeveris se Kosovës në vuariën e kontakteve dhe bashkëpunimit me ndërmarrjet e privatizuara në drejtim të ndihmës në aftësimin dhe shkollimin e menaxhmentit, dhe krijimi i parakushteve të volitshme për zhvillimin e biznesit në Kosovë si për investitorët vendor ashtu edhe të jashtëm.

Referencat:

- [1] Prof.Dr.Qamil Taka.:“Organizimi dhe Drejtimi i Biznesit”, Mokra,Tirane, AL. 2008g.,
- [2] Imšir Imširović.: „Menadzment i Menadzer“, Kantonalna Privredna Komora Tuzla i drugi, Tuzla, BiH, 2002g.,
- [3] Gerald V.Post i David L.Anderson.: “Management Informations Systems:Solvong Business problems with information technology”, McGraw-Hill/Irwin, NewYork, 2003g.,
- [4] Krasniqi Armand, Ukaj Fatos , “Menaxhimi i Destinacionit ne Turizëm”, Peje, 2010.

-Publikimet dhe materialet rreth privatizimit në Kosovë (UNMIK,USAID, AER),

-Hulumtimet nga tereni dhe ndërmarrjet e privatizuara,

-Materialet nga informatat e Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP), Raporti vjetor 2009,

KUD 338.48(496.51)

ROLI DHE RENDËSIA E TURIZMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

Dr.sc Fetah Reçica
fetahreqica@hotmail.com

Mr. sc. Bedri Millaku
bedri_millaku@hotmail.com

Abstrakt

Turizmi është veprimtari ekonomike cila sjell, leverdi fitimprurëse për ekonominë e secilit vend, e po ashtu edhe të Republikës së Kosovës si vend në tranzicion. Potencialet e shumta dhe shfrytëzimi i tyre, në shërbim të ofertës së mirëfilltë turistike, kanë peshën, rolin dhe rëndësinë e tyre në zhvillimin ekonomik dhe në përgjithësi të brutoproduktit shoqëror. Në këtë mënyrë do të angazhohet fuqi punëtore dhe do të shkojë në favor të zhvillimit dhe sigurimit të mirëqenies shoqërore të popullsisë vendore dhe në ngritjen e standardit jetësor.

Fjalët kyçe: Turizmi, Zhvillimi ekonomik, Potencialet turistike, Oferta turistike, perspektiva e zhvillimit.

Hyrje

Turizmi në vitet e fundit është zhvilluar në rrethana mjaftë të vështira në aspekte të ndryshme si politike, ekonomike dhe shoqërore. Zhvillimi i turizmit është në lidhshmëri me zhvillimin ekonomik të vendit. Republika e Kosovës me potencialet e sajë mund të jetë vendi me zhvillim ekonomik në të cilin turizmi do të jete njëri prej vendeve ku premtojnë investimet në këtë sektor. Gjithëherë duke marrë për bazë vendet e regjionit si Maqedoninë, Bullgarinë, Kroacinë, Slloveninë, Shqipërinë, ku turizmi është njëra prej sektorëve të ekonomisë i cili ka thithur investime nga investitorët e huaj dhe të qëndrueshëm në këto vende. Edhe Republikës së Kosovës me potencialin e konsiderueshëm turistik i nevojiten investime të shumta për zhvillimin e turizmit. Nevojat për zhvillimin e turizmit janë parësore të cilat japin një kërkesë të qëndrueshme.

Republika e Kosovës me kushtet e saja në disponim paraqet bazë potenciale për zhvillimin e turizmit me degët e tij; Turizmit malor, turizmit balnear, turizmin fshatar, turizmin kongresist, turizmin transit, turizmin kulturor etj. Pra disponon me vlera të shumta të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, me motive të shumta që nga e kaluara e lashtë deri në ditët e sotme.

Roli i turizmit në Republikën e Kosovës dhe rëndësia për ekonominë e vendit

Turizmi është njëra prej veprimtarive me komplekse në shoqërinë e sotme moderne. Ne vendet e zhvilluara ka marrë formën e një industrie të plotë me të cilën ndërveprojnë shumë veprimtari si ; ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtari të dhe aktivitete njerëzore. Roli i turizmit për zhvillimin e ekonomisë është mjaftë i lartë sepse turistët, konsumojnë në vendin i cili vizitohet. Zhvillimi i turizmit në ekonominë e një vendi mund të ketë ndikime të drejtpërdrejta, indirekte dhe multiplikative. Në sferën e ndikimeve direkt që bën turizmi në ekonomi, me të rëndësishme janë ndikimet në produktin shoqëror dhe të ardhurat nacionale, në zhvillimin e veprimtarive ekonomike cilat përbëjnë ekonominë turistike si hoteleria, tregtia, transporti, institucionet kulturore për argëtime etj. Mandej inkuadrimi i popullsisë në punë e cila ka ndikim të drejtpërdrejtë më ngritjen e standardit jetësor, ngritjen e investimeve, në ekuilibrin e shkëmbimit me jashtë si dhe zhvillimin e vendeve dhe rajoneve më pak të zhvilluara.

Efektet e turizmit janë edhe indirekte, në ato veprimtari ekonomike, të cilat nuk marrin pjesë në shërbimet e drejtpërdrejta të vizitorëve, por janë në shërbim të ekonomisë turistike; bujqësia, ndërtimtaria, industria, tregtia etj. Megjithatë Republika e Kosovës me potencialet e shumta turistike, premton të jetë tregu i mundshëm turistik për vizitorët e vendeve të ndryshme. Në turizëm gjerat duhet shikuar në kuptimin me të gjer sepse zhvillimi i tij varet nga faktorët e shumtë të cilët i japin impuls edhe zhvillimit ekonomik. Në mënyrë që oferta të kompletohet dhe të jetë në lidhshmëri proporcionale me kërkesën turistike.

Zhvillimi i turizmit për secilin vend është i lidhur me qëndrueshmërinë politike dhe sociale. Arritja e tyre mund të bëhet në qoftë se kemi rritje ekonomike të qëndrueshme. Rritja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm mund të arrihet vetëm atëherë kur kemi një mjedis të sigurt të sektorit privat. Për vendosjen në vend të një klime makroekonomike të qëndrueshme dhe një ekonomi të tregut duhet të bëhen përpertime në reformat ekonomike të cilat kanë munguar deri në periudhën e pasluftës.

Mjedisi makroekonomik i qëndrueshëm është prej prioriteteve për të përfutur investitorët. Vendi duhet të jetë i sigurt nga veprimet e dëmshme si kriminaliteti, korrupsioni, të cilat ndikojnë në stabilitetin dhe zhvillimin e vendit. Gjithëherë do të ishte e preferueshme që lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nga organet shtetërore duhet të jetë në rëndësi të parë, në atë mënyrë për të krijuar një mjedis i favorshëm për investitorët e jashtëm, por edhe ata të vendit. Republikës së Kosovës i mungojnë politika e mirëfillta turistike. Kjo është e vështirësuar se edhe pas përfundimit të luftës, ende nuk ka një vizion e as një koncept të zhvillimit makroekonomik, por as strategji për zhvillimin e turizmit. Edhe pse ekzistojnë studime të shumta nga banka Botërore dhe organizmat përkatës të Bashkësisë Evropiane për mundësitë e zhvillimit ekonomik të Republikës së Kosovës, të cilës ende i mungojnë indikatorët bazik

makroekonomik për formimin e politikave ekonomike duke përfshirë edhe atë turistik. Deri tani ne përdhën e pasluftës se fundit organet kompetente të Republikës së Kosovës kanë përgatitur dy ligje për turizmin të cilat janë përfshirë veprimtarit hoteliere, atë të agjencive turistike, të ciceroneve turistike etj. Sipas gjendjes së implementimit të tyre, paraqiten vështërsi dhe mangësi.

Mendojmë se në Republikën e Kosovës ende nuk është krijuar një mjedis në të cilin investitorët, vendor dhe ata ndërkombëtar do të fitojnë besimin për të investuar. Kjo kërkon miratim të shpejtë të pakos legislative për të rregulluar aktivitetet e investimeve dhe biznesit komform standardeve ndërkombëtare. Mungesa e strategjive ekonomike është pengesë e zhvillimit dhe investimeve të mirëfillta ndërkombëtare në vend.

Mënyrat e intervenimit të shtetit në shtetet e Evropës perëndimore dhe shtete në tranzicion për zhvillimin e turizmit

Në të gjitha vendet e botës, pa marrë parasysh zhvillimin shoqëroro-ekonomik të vendit, shumë çështje lidhur me turizmin rregullohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ana e shtetit. Turizmi përfshinë sferat e ndryshme të jetës shoqërore si politike, ekonomike, kulturore, sociale, atëherë edhe lënda e politikës turistike e përcaktuar kryesisht nga shteti, përfshinë grupet e aktiviteteve shoqërore të cilat i takojnë politikës sociale, ekonomike, shëndetësore, politike, kulturore dhe elementeve përbërëse të tyre. Në të gjitha vendet ligji i rregullon pjesën më të madhe të raporteve dhe dukurive të turizmit, duke i përfshirë të gjitha veprimtaritë si në hotelieri, transport, të tregtisë, të politikës sociale, shëndetësore, industriale, bujqësore etj.

Në përgjithësi kompetencat më të rëndësishme të organeve shtetërore për turizëm në vendet e Evropës perëndimore dhe vendet fqinje të Kosovës janë :

- Përgatitja e dispozitave ligjore nga lëmi i turizmit,
- Përgatitja dhe hartimi i planeve për zhvillimin e turizmit,
- Monitorimi dhe zbatimi i dispozitave dhe punës së organizatave të rëndësishme turistike,
- Caktimi i politikave të çmimeve të shërbimeve të vendosjes dhe të ushqimit.

Secili vend i cili shfrytëzon potencialet turistike në shërbim të ofertës së mirëfilltë turistike kanë hartuar legjislacionin më të përparuar i cili është në funksion të turizmit. Vendet turistike të Evropës perëndimore por edhe disa vende të Evropës së mesme zhvillimi i politikave turistike është në funksion të ngritjes së infrastrukturës turistike dhe përgjithësisht i jep përparësi zhvillimit të kësaj veprimtarie të leverdishme për ekonominë. Në vendet në tranzicion vendet turistike kanë më shumë vështërsi, por edhe shteti nuk u jep rëndësi zhvillimit të turizmit. Në këto shtete po sa ka filluar të marr hapat drejt zhvillimit. Në

ketë rang radhitet edhe vendi ynë, ku shfrytëzimi i potencialeve turistike paraqet mundësi të mëdha për zhvillimin turizmit.

Disa veçori për ndërmarrjet hoteliere të Republikës së Kosovës

Për periudhën e pasluftës hapja e bizneseve të reja hoteliere është përqendruar kryesisht në biznese të vogla. Si veçori bazë e zhvillimit të biznesit hotelier në Republikën e Kosovës është zhvillimi i tij në formën e bizneseve të vogla, e cila shoqërohet më disa pasoja si; mundësi të vogla për krijimin e vendeve të punës, por edhe me anët pozitive për të ndikuar edhe në uljen e papunësisë; si mundësi relativisht të kufizuara për të ardhurat nga taksat dhe tatimet e ndryshme.

Kjo lëmi ka mangësitë e saj, sepse në bazë të analizave nuk janë të ndërtuara të gjitha bizneset hotelier sipas standardeve. Por ka edhe të atilla që i plotësojnë kriteret për këtë veprimtari sipas standardeve të cilat do të plotësonin ofertën turistike.

Subjektet hoteliere janë në fazën fillestare të formimit të tyre në bazë të kapitalit të tyre privat. Periudha e nga viti 2009 Duke u bazuar në të dhënat me të cilat posedon Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Departamenti i Turizmit, si dhe Enti i Statistikave të Kosovës (ESK), del se në të gjitha komunat e Kosovës veprimtarinë Hoteliere e ushtrojnë 148 hotele të licencuara me gjithsej 2461 shtretër.

Qytetet të cilat kanë më së shumti hotele janë : Prishtina (30), Prizreni (14), Ferizaj (18) dhe Lipjani (12). Nga kjo nuk do të thotë se objektet hotelier nuk janë të shpërndara edhe në qendrat tjera por janë në fazat e licencimit, klasifikimit dhe kategorizimit. Realisht numri i objekteve hoteliere është me i madh. Realisht tani pas implementimit të legjislacionit të fundit turistik, do të bëhet klasifikim dhe kategorizimi i objekteve akomoduese në mënyrë që ato të jenë pjesë e ofertës së mirëfilltë turistike.

Përfundimi

Roli dhe rëndësia e turizmit për zhvillimin e turizmit në Republikën e Kosovës është i madh. Në bazë të potencialeve në disponim, zhvillimi i turizmit mund të jetë njëra prej veprimtarive ekonomike që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit. Kur kemi parasysh vështërsitë nëpër të cilat ka kaluar kjo veprimtari ekonomike së bashku me degët e tjera ekonomike, sot janë krijuar kushte për zhvillimin e saj. Me qenë se Republika e Kosovës ka kushte për zhvillimin e turizmit; Turizmit malor, turizmit balnear, turizmin fshatar, turizmin kongresist, turizmin transit, turizmin kulturor etj. Si përfundim mund të vijmë se në qoftë se i jepet rëndësi edhe roli i tij për zhvillimin ekonomik të vendit do të jetë bukur i madh. Në këtë mënyrë turizmi do të ndikojë në zhvillimin ekonomik të vendit. Sepse shfrytëzimi i potencialeve turistike dhe

=====

oferta e mirfillt turistike do te rris kërkesën dhe ne këtë mënyrë do te arrihet ngritja e standardeve turistike e tera ne te mire te zhvillimit te vendit.

Literatura

1. Adams, P.D. and B.P. Parmenter (1995), "An Applied General Equilibrium Analysis of the Economic Effects of Tourism in a Quite Small, Quite Open Economy," *Applied Economics*, Vol. 27, No. 10, 985-994.
2. Blake, A. (2000), "The Economic Effects of Tourism in Spain," *Tourism and Travel Research Institute Discussion Papers*, No. 2.
3. Magazine of the World Tourism Organization. ISSUE 3/2010.
4. Office for National Statics "Travel trend" Issued by: Office for National Statistics, Government Buildings -Cardiff Road-Newport NP10 8XG.
5. The International Centre for Responsible Tourism (Dr Harold Goodwin) and Scott Wilson Business Consultancy (Stuart Robson and Sam Higton), August 2004.
6. . Coles, T., Hall, C.M. & Duvall, D.T. (2006).
7. Tourism and post-disciplinary enquiry. *Current Issues in Tourism*, 9(5), 293–319.
8. Hall, C. M., Timothy, D. J., & Duval, D. T. (Eds.). (2003). *Safety and security in tourism: Relationships, management, and marketing*. New York: Haworth Hospitality Press.
- 9 Faulkner, B., & Russell, R. (2000). Turbulence, chaos and complexity in tourism systems: A research direction for the new millennium. In B. Faulkner, G. Moscardo and E. Laws, (Eds.), *Tourism in the 21st century: Lessons from experience* (pp. 328–349). L
10. E-International Scientific Research Journal London: The socio – Economic impact of tourism and entrepreneurship in Vigan city. ISSN: 2094-1749 Vol: 1 Issue: 1, 2009.
11. Tourism Victoria (2002) The Tourism Industry Strategic Plan 2002-2006, Available at: <http://www.tourism.vic.gov.au/> (accessed in September 2009).
12. UNCED (1992), Agenda 21, Rio Declaration on Environment and Development, United Nations Conference on Environment and Development, Rio de Janeiro, Available at: <http://www.un.org/> (accessed in July 2009).
13. WTTC (2009b), WTTC Results Show No Time For Rhetoric, World Travel & Tourism Council, PR 12 March 2009, Berlin, Available at <http://www.wttc.org/> (accessed in September 2009).
14. [World Tourism Organisation \(UNWTO\) Statistics Departament](#).
15. World Travel and Tourism Council (2004), Annual Report: Progress & Priorities 2004/05.
16. Tooman, L.A. (1997), "Tourism and Development," *Journal of Travel Research*, Vol. 35, No. 4, 33-40.
17. Smith, S.L.J. (1995), "The Tourism Satellite Account: Perspectives of Canadian Tourism Associations and Organizations," *Tourism Economics*, Vol. 1, No. 3, 225- 244.

- =====
18. Paci, E. (1998), "Report: The World Tourism Organization's Efforts in the Development of a Tourism Satellite Account," *Tourism Economics*, Vol. 4, No. 3, 279-283.
 19. M. Gashi : "Bazat e Turizmit" Universiteti i Kosovës, Prishtinë, 1986.
 20. M. Gashi "Vlerat turistike ne Kosovë" Plani regjional hapësinor i KSAK Prishtinë 1969.
 21. N. Muhaxheri : *Ekonomika dhe Menaxhmenti në Turizëm-Prishtinë* 2005.
 22. M. Gashi : "Uslovi i mogućnosti za razvoj turizma SAP Kosovu, Prishtinë 1977.
 23. M. Gashi : "Osnovni potencijal turističkih vrednosti Kosova", ekspertiza izrađena za potrebe i rade regionalnog prostornog plana Kosova, Priština 1969.

KUD 657 : 005

ROLI I KONTABILITETIT TË MENAXHMENTIT SOT

*Msc. Fidane Spahija,
fidane.spahija@gmail.com*

Abstrakt

Kontabiliteti si disiplinë shkencore, identifikon, rregjistron dhe komunikon informatat që janë relevante, të besueshme dhe të krahasueshme për marrjen e vendimeve nga ana e shfrytëzuesëve. Kontabiliteti i menaxhmentit dallon nga kontabiliteti financiar kryesisht sa u përket përdoruesëve. Informacioni i kontabilitetit menaxherial nevojitet për përdoruesit e brendshëm, ndërsa informacioni i kontabilitetit financiar u drejtohet përdoruesëve të jashtëm. Objektivat e kontabilitetit të menaxhmentit ndërlidhen drejt përmbushjes së objektivave të organizatës. Kontabiliteti i menaxhmentit ndihmon organizatën në marrjen e vendimeve, kontrollim, planifikim dhe raportimin e informatave sa më kualitative. Konkurenca, rritja e shërbimeve dhe përparimet e teknologjisë informative janë faktorë kryesorë që kanë ndikuar në praktikën sa më të madhe të kontabilitetit të menaxhmentit në ndërmarrje. Kjo nënkupton edhe pjesëmarrjen aktive të kontabilistëve menaxherial në proceset kyçe të ndërmarrjes. Sot, roli i tyre është shumë i madh dhe zbatimi i standardeve etike është i obligueshëm.

Fjalët kyçe: Kontabilitet, ndërmarrje, menaxhim, financiar, ekonomi.

JEL kualifikimi: M0, M4, M41.

1. Hyrje

Me këtë punim shkencor bëhet përpjekje të sqarohet roli i kontabilitetit të menaxhmentit sot në ndërmarrje, rëndësia dhe objektivat kryesore të tij, dhe krejtësisht në fund flitet për faktorët që kanë ndikuar në praktikën e kontabilitetit të menaxhmentit dhe rolin e kontabilistëve menaxherial duke ia bashkangjitur disa nga standardet etike të cilave duhet t'u përmbahen.

Objektiv kryesor i punimit është që t'u ofrohet studentëve të FSHAB-it në Pejë, literaturë shtesë mbi lëndën "Kontabiliteti i menaxhmentit".

Për hartimin e punimit janë përdorur literatura të ndryshme vendore dhe të huaja, poashtu hulumtime në internet, media elektronike dhe të shkruara. Metodat e përdorura për të arritur qëllimin e punimit kryesisht janë: analitike, krahasuese, abstraksionit, etj.

2. Nocioni i kontabilitetit dhe llojet e tij

Gjatë zhvillimit të veprimtarive ekonomike është paraqitur nevoja e ndjekjes dhe e evidencimit të faktorëve të ndryshëm gjatë procesit dhe rezultateve përfundimtare. Duke filluar që nga viti 1494, për zhvillimin e parimeve të kontabilitetit të dyfishtë si shkencë e cila ndërlidhet me zhvillimin e shoqërisë, kontribut të madh dha italianin Luka Paciolo. Që nga ajo kohë, por edhe sot, shumë shkencëtarë mundohen të japin një definicion të plotë mbi kontabilitetin. Kështu, në vitin 1940, AICPA (American Institute of Certified Public Accounts), definoj kontabilitetin si “art i rregjistrimit, i klasifikimit dhe i përmbledhjes në një mënyrë kuptimplote e në vlerë monetare i veprimeve, që janë pjesërisht me karakter financiar, si dhe interpretimit të këtyre rezultateve”.⁷⁷

Definicion të përafërt mund ta gjejmë edhe në literaturën amerikane, ku kontabiliteti definohet si “sistem për ofrimin e informatave sasiore, para se gjithash të natyrës financiare, mbi entitetet ekonomike, me qëllim të marrjes së vendimeve sa më të shfrytëzueshme”. Informatat financiare që dalin si rezultat i matjes dhe i raportimit nga ana e kontabilistëve kryesisht u shërbejnë njësive ekonomike. Por ka informata të llojeve të ndryshme që mund tu raportohen palëve të interesuara. Këta përfshijnë menaxherët dhe pronarët e biznesit të cilëve u nevojiten informatat e kontabilitetit për të marrë vendime, investitorët të cilët e shikojnë mundësinë për të siguruar dividendin në fund të periudhës, kreditorët shikojnë mundësinë e pagesës së obligimeve të entitetit, njësitë qeveritare për mundësinë e pagesës së taksave dhe të punësuarit të cilët përmes raporteve e shohin mundësinë e pagesës së pagave të tyre, etj.

Një definicion më praktik për kontabilitetin do të ishte: “Kontabiliteti modern, para se gjithash, është i përqendruar jo vetëm në mbajtjen e librave, por poashtu edhe në veprimtari të tjera duke përfshirë planifikimin dhe problemet e shitjes, të kontrollit, të analizës dhe të revizionit. Kontabiliteti i sotëm përqëndrohet në nevojën ultimative të asaj se kush është shfrytëzues i informatave të kontabilitetit, përkatësisht se shfrytëzuesi i informatave a është brenda apo jashtë pjesëmarrjen në biznes”.⁷⁸

Kontabiliteti si disiplinë shkencore fokusohet në disa hapa kryesor, siç janë:⁷⁹

- Identifikimi dhe matja e informatave,
- Rregjistrimin e informatave të identifikuar dhe të matura në librat e kontabilitetit,
- Raportimin e rezultateve dhe analizën e tyre për nevojat e shfrytëzuesve të brendshëm dhe atyre të jashtëm.

Pra, sistemet e kontabilitetit janë mjeshtri në vete dhe janë krijuar për t'i ndihmuar njeriut në përmbushjen e qëllimeve.

⁷⁷ Ahmeti, Skender, “Kontabiliteti i menaxhmentit”, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2008, fq.12

⁷⁸ Po aty, fq. 14

⁷⁹ Kermit, Wild, Chiappetta “Accounting principle”, fq. 1-11

Kemi disa lloje të kontabilitetit, siç janë: Kontabiliteti financiar, Kontabiliteti i menaxhmentit, Kontabiliteti i kostos dhe Kontabiliteti i taksave.

3. Kontabiliteti i menaxhmentit kundrejt kontabilitetit financiar

Kontabiliteti i menaxhmentit kundrejt kontabilitetit financiar, ka të bëjë me të gjitha llojet e informacionit kontabël që grumbullohen, maten, rregjistrohen, përpunohen dhe u transmetohen menaxherëve të njësive ekonomike. Informacionet që u sigurohen menaxherëve nga kontabiliteti i menaxhmentit kanë të bëjnë me koston e produkteve të prodhuara, për produktet e veçanta në çdo segment të njësisë, me planifikimin dhe kontrollin e operacioneve të ndryshme, me natyrën, vendin dhe madhësinë e të ardhurave për çdo produkt dhe segment të njësisë, me buxhetimin e kapitalit, etj. Kontabiliteti i menaxhmentit dallon nga kontabiliteti financiar për arsye se kontabiliteti i menaxhmentit shfrytëzohet për marrje të vendimeve brenda kompanisë dhe nuk është e thënë të përcjellë çfarëdo rregulle të lëshuar nga trupat e përcaktimit të standardeve. Sa i përket kontabilitetit financiar ka të bëjë me informacionin kontabël, përveç që përdoret nga drejtimi i njësisë ekonomike, kryesisht u komunikohet edhe përdoruesëve të jashtëm të informacionit. Kontabiliteti financiar është ajo pjesë e sistemit të kontabilitetit që merret me matjen dhe raportimin e gjendjes financiare dhe të rezultatit të biznesit gjatë një periudhe të caktuar kohore, në përputhje me parimet e përgjithëshme të pranura të kontabilitetit. Kryesisht siguron informacion në lidhje me marrëdhëniet e njësisë ekonomike me personat fizikë ose juridikë jasht saj, si p.sh., me furnitorët, kreditorët, investitorët, shtetin, etj. Që të dy llojet e kontabilitetit marrin informacione nga sistemi bazik i kontabilitetit të organizatës.

4. Objektivat kryesore të kontabilitetit të menaxhmentit

Kontabiliteti i menaxhmentit shton vlerën e një organizate, duke marrë parasysh këto objektiva kryesore:⁸⁰

- Duke ofruar informata për marrjen e vendimeve dhe për planifikimin nëpërmes pjesëmarrjes aktive të ekipit menaxherial.
- Asistimi i menaxherëve të drejtimit në kontrollin e veprimtarive operative. Pra, ekipi i menaxhmentit duhet të ketë përherë informacione për nevojat operative të konumatorëve, kurse ekipi i menaxherëve të drejtimit dhe kontrollit duhet t'i krahasojnë rrjedhat e koston aktuale me ndikimin e tyre në buxhetine firmës.
- Motivimi i menaxherëve dhe të punësuarëve të tjerë drejt përmbushjen së qëllimeve të kompanisë. Edhe pse shpesh ndodh që qëllimet personale janë në kundërshtim me ato të organizatës,

⁸⁰ Ahmeti, Skender, “ Kontabiliteti i menaxhmentit ”, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2008, fq. 23-25

=====

mirëpo një ndër objektivat e kontabilitetit të menaxhmentit është që t'i motivoj menaxherët dhe punëtorët në realizimin sa më efikas të qëllimit të organizatës.

- Të maturit e performancës së veprimtarive, njësive, menaxheëve dhe punëtorëve në organizatë, me qëllim të arritjes maksimalizimin fitimit. Shumë nga organizatat e njohura e kompensojnë veprimtarinë e shtuar të të punësuarëve në bazë të profitit të arritur të njësisë. Në disa ndërmarrje tjera kjo matet me cilësinë, shitjen ose shpërndarjen në kohë.
- Përcaktimi i pozicionit konkurrues të ndërmarrjes dhe të punuarit me menaxherët e ndërmarrjes për sigurimin e konkurrencës më afat gjatë në treg.

Roli crucial i kontabilitetit të menaxhmentit është të përcaktojë se si organizata do t'i kundërvihet konkurrencës, duke u përpjekur përherë të shkojë përpara në zhvillimin e saj ekonomik.

5. Faktorët që ndikojnë në praktikën e kontabilitetit të menaxhmentit

Gjatë 25 viteve të fundit, trysnia e konkurrencës në nivel botëror, çrregullimet, rritja e industrisë së shërbimeve dhe përparimet në teknologjitë e informacionit dhe të prodhimit, e kanë ndryshuar natyrën e ekonomisë sonë dhe e kanë bërë që shumë industri prodhimi dhe shërbimesh të ndyshojnë në mënyrë dramatike mënyrën se si ato veprojnë. Për këtë arsye, sistemet kontabël, të bazuara mbi veprimtari, u zhvilluan dhe u zbatuan nga shumë organizata. Gjithashtu, u zgjerua fokusi i sistemeve kontabël të menaxhimit dhe të kostos për të lejuar menaxherët t'u shërbejnë më mirë nevojave të konsumatorëve dhe të menaxhojnë proceset e biznesit të firmës që përdoren për të krijuar vlerën konsumatore. Për të siguruar dhe mbajtur një avantazh konkurrues, menaxherët kërkojnë të përmirësojnë performancën e bazur në kohë, cilësinë dhe efikasitetin. Informacioni kontabël duhet të jetë i tillë që të mbështesë këto tre objektiva kyçe të organizatës.⁸¹

5.1. Konkurrenca globale

Përmirësimi i sistemeve të transportit dhe të komunikacionit kanë futur shumë firma prodhuese dhe shërbimesh në tregun botëror. Disa dekada më parë, firmat as nuk e dinin dhe as u interesonte se çfarë prodhonin firmat e ngjajshme me ato në vendet e tjera. Këto firma të huaja nuk ishin konkurrenca, pasi që tregjet e tyre ishin të ndara në distanca gjeografike. Mirëpo, tani si firmat e

⁸¹ Hansen Don & Mowen Maryanne, "Menaxhimi i kostos, kontabilitet dhe kontroll", Universiteti i Arizonës, SHBA, 2008, fq. 5 -7

mëdha dhe ato të vogla ndikohen nga mundësitë që ofrohen nga konkurrenca në nivel botëror. Bankierët e investimeve dhe konsulentët e menaxhimit mund të komunikojnë me zyrat e huaja në çast. Ky mjedis i ri konkurrues e ka rritur kërkesën jo vetëm për më shumë informacione për koston, por edhe për informacione më të sakëta për koston. Informacioni mbi koston luan një rol jetësor në reduktimin e koston, në përmirësimin e prodhimit dhe në vlerësimin e përfitimeve të linjës së prodhimit.

5.2. Rritja e industrisë së shërbimeve

Derisa industritë tradicionale e kanë humbur rëndësinë e tyre, sektori i shërbimeve ka ritur rëndësinë e tij në ekonomi. Sektori i shërbimeve përfshin afërsisht tre të katërtat e ekonomisë dhe të punësimit në SHBA. Në mesin e këtyre shërbimeve janë edhe shërbimet e kontabilitetit. Ekspertët parashikojnë që ky sektor do të vazhdojë të zgjerohet në madhësi dhe në rëndësi me rritjen e prodhueshmërisë së shërbimeve. Rritja e konkurrencës, i ka bërë menaxherët e kompanive më të vetëdijshëm lidhur me nevojat për të pasur një informacion mbi koston, e cila shërben për një planifikim, kontrollim dhe përmirësim të vazhdueshëm të proceseve për vendimarrje.

5.3. Përparimet në teknologjinë e informacionit

Kemi tri përparime të rëndësishme që ndërlidhen me teknologjinë e informacionit.

- E para është e lidhur ngusht me aplikimet e integruara kompjuterike. Me prodhimin e automatizuar, kompjuterët përdoren për të monitoruar dhe kontrolluar veprimet. Tani është e mundur të kontrollohen produktet në mënyrë të vazhdueshme dhe të raportohet sakt informacioni për njësitë e prodhuara, materialet e përdorura, mbetjet e prodhuara dhe kostoja e prodhimit. Programi kompjuterik i planifikimit të burimeve të ndërmarrjes (ERP) ka për objektiv të ofrojë një sistem të integruar, që mund t'i kryejë të gjitha veprimet e një kompanie në kohë reale nga fusha të ndryshme të funksioneve të kompanisë. Automatizimi dhe integrimi e rrisin saktësinë e informacionit dhe menaxherët përfitojnë në maksimum nga këto sisteme komplekse.
- Përparësia e dytë madhore ka të bëjë me disponueshmërinë e mjeteve që kërkohen: disponueshmëria me kompjuterë personal (PC), e programeve analitike më rrjet (OLAP) dhe e sistemeve për mbështetjen e vendimeve (DSS). Për shkak të këtyre përparimeve teknologjike, kontabilistët e menaxhmentit dhe të koston kanë fleksibilitet për t'iu përgjigjur nevojave menaxheriale për më shumë metoda komplekse të koston së prodhimit si koston e bazuara në aktivitet (ABC).

- Përparësia e tretë është lindja e tregtisë elektronike (e-commerce) – formë e çdo biznesi që kryhet duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit. Interneti u lejon blerësve dhe shitësve të bashkohen dhe të kryejnë veprime nga vende dhe kushte të ndryshme. Tregtia me internet i lejon kompanive që të veprojnë si organizata virtuale duke ulur shpenzimet e buxhetit. Shkëmbimi elektronik i të dhënave midis kompjuterëve përmes linjave telefonike mundësohet nga EDI. Ndarja e informacionit midis tregtarëve, ul koston dhe përmirëson marrëdhëniet me klientët, duke çuar kompaninë në një pozitë më të fortë konkurruese.

Këta ishin disa nga faktorët kryesorë të cilët po ndikojnë në praktiken e kontabilitetit në përrgjithësi, duke mos lënë anash rëndësinë e aplikimit të kontabilitetit të menaxhmentit sot në ndërmarrje.

6. Roli dhe standardet e sjelljes etike për kontabilistët menaxherial

Kontabilistët menaxherial furnizojnë menaxhmentin me të gjitha llojet e informacioneve dhe veprojnë njëherësh si partnerë strategjikë në biznes, në përkrahjen e rolit të menaxhmentit në marrjen e vendimeve dhe menaxhimin e veprimtarive të organizatës.

Porsche, Stihl, DaimlerChrysler dhe kompani tjera gjermane e shohin kontabilitetin e menaxhmentit si një disiplinë të veçantë dhe zakonisht punësojnë për kontabilitetin e menaxhmentit aq punonjës sa punësojnë në kontabilitetin financiar ose dhe më shumë.⁸²

Roli i kontabilistëve të menaxhimit në një organizatë është ai i mbështetjes dhe i punës në grup. Ata ndihmojnë personat që janë përgjegjës për arritjen e objektivave bazë të një organizate. Kontabilisti menaxherial është përgjegjës për krijimin e informacionit financiar të kërkuar nga firma për raportim të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo përgjegjësi përfshin mbledhjen, përpunimin, analizimin dhe raportimin e informacionit që ndihmojnë menaxherët në veprimtarinë e tyre planifikuese, kontrolluese dhe vendimarrëse.

Shumë ndërmarrje vendosin një kod etik ose standard sjellje për menaxherët dhe punonjësit e tyre. Një studim i kryer nga *Deloitte & Touche LLP* dhe revista *Corporate Board Members* tregoi se 98 % e korporatave ishin dakord me faktin se ndërmarrja duhet të zbatojë një programin etik.⁸³ Sjellja etike është e lidhur me kontabilistin, pasi që besueshmëria e informacionit kontabël varet nga ndjeshmëria e atyre që përgatisin, raportojnë dhe kontrollojnë këtë informacion. Instituti i kontabilistëve menaxherialë (IMA), ka vendosur kodin dhe standardet etike që duhet t'i përmbahen kontabilistët menaxherialë.

⁸² Hansen Don & Mowen Maryanne, "Menaxhimi i kostos, kontabilitet dhe kontroll", Universiteti i Arizonës, SHBA, 2008, fq.4

⁸³ Hansen Don & Mowen Maryanne, "Menaxhimi i kostos, kontabilitet dhe kontroll", Universiteti i Arizonës, SHBA, 2008, fq.15

Ky kod bazohet në tri parime themelore :

- Në integritetin e personit që përgatit, raporton dhe kontrollon informatat e kontabilitetit,
- Në objektivitetin e informatave të përgatitura, të raportuara dhe të kontrolluara,
- Në pavarësinë profesionale të personit që përgatit, raporton dhe kontrollon informatat.

Të bazuarit në këto parime themelore, mundëson që:

- të menjahohen gabimet e vogëlle etike,
- Të fokusohemi në reputacionin afatgjatë,
- Të përgatitemi për të pritur konsekuencat personale për mbajtjen e pozicionit etik.

Në kodin e mirësjelljes profesionale të përpiluar nga IFAC, cekën edhe disa parime tjera bazë për kontabilistët menaxherialë⁸⁴:

- *Çmuarja*, kontabilisti profesionalë duhet të jetë i sinqertë, i drejtë, i ndershëm në ofrimin e shërbimeve profesionale.
- *Objektivizmi*, Kontabilisti nuk bën të lejojë prejjudikime, konflikte interesash ose ndikim me qëllim që t'i iket objektivizmit.
- *Aftësia profesionale*, nënkupton kryerjen e punëve në mënyrë profesionale dhe me kompetencë.
- *Besueshmëria*, në ruajtjen e informatave dhe mosdhënien e tyre personave të paautorizuar, si dhe mosshfrytëzimi i tyre për nevojë dhe çështje që nuk kanë të bëjnë me interesin e kompanisë.
- *Sjellja profesionale*, me reputacion dhe duke mos e kryer punën që e diskreditojnë atë dhe kompaninë në tërësi.
- *Standardet etike* – duhet zbatuar në përgjithësi varësisht nga vendi ku aplikohen ato standarde.

Roli i kontabilistëve menaxherial është tejte i madh e sidomos për kompanitë prodhuese dhe shërbyese, njëkohësisht zbatimi i standardeve etike nga ana e menaxherëve është i domosdoshëm.

7. Përfundimi

Si rezultat i këtij punimi kërkimor arrita në përfundim se aplikimi i një sistemi të kontabilitetit në ndërmarrje, varësisht nga madhësia e saj, është i obligueshëm, e sidomos në kushtet e sotme të globalizimit, me konkurrencë të madhe dhe me aplikimin e teknologjive të reja informative. Nëse një ndërmarrje

⁸⁴ Ahmeti, Skender, “ Kontabiliteti i menaxhmentit ”, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2008, fq. 28-31

=====

dëshiron të jetë pjesë e kësaj konkurrence dhe të arrijë maksimalizimin e fitimit duhet patjetër të aplikojë sistemin e kontabilitetit dhe jo vetëm me libra por edhe përmes kompjuterit. Duke e pasur parasysh qëllimin e punimit, jam fokusuar më tepër në aplikimin e kontabilitetit të menaxhmentit, kontabiliteti i cili kryesisht duhet të përdoret nga ndërmarrjet prodhuese dhe shërbyese. Me ndihmën e informatave të siguruar nga kontabilistët menaxherialë, ndërmarrja mund t'i arrij shumë më lehtë objektivat e saj.

Por kjo arrihet kur kontabilistët janë profesional, kanë aftësi t'u qasen analizave, t'i kuptojnë të dhënat nga sistemi kontabël dhe u përmbahen standardeve etike të miratuara sipas rregulloreve ndërkombëtare.

Literatura

1. Ahmeti, Skender, “ Kontabiliteti i menaxhmentit ”, Universiteti Iliria, Prishtinë, 2008.
2. Dharmo, Sotirag, “Kontabiliteti financiar”, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1998.
3. Hansen Don& Moëen Maryanne, “Menaxhimi i kostos, kontabilitet dhe kontroll” Universiteti i Arizonës, SHBA, 2008.
4. Kermit, Eild, Chiappetta, “Accounting principle”, SHBA, 2004.

Web-faqe

www.cob-sfau.edu
www.ansëer.google.com
www.wikipedia.com

KUD 327(4/9):65(496.51)

**NDIKIMI I KRIZËS GLOBALE, IDENTIFIKIMI I BARRIERAVE
KRYESORE DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN E
MENAXHIMIT TË BURIMEVE TË FINANCIMIT TË BIZNESEVE TË
VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË**

*Fjolla Trakaniqi,
fjollatrakaniqi@gmail.com*

Abstrakt

Menaxhmi përfshin të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje duke u nisur nga planifikimi, punësimi, drejtimi, bashkërenditja, ekzekutimi e deri te kontrolli i saj.

Në aktivitetet e financimit të ndërmarrjes përfshihet marrja e vendimeve lidhur me financimin dhe shfytëzimin sa më racional të mjeteve në ndërmarrje. Në këto aktivitete njëherit përfshihet edhe zgjidhja e problemeve të cilat janë të lidhura me burimet e financimit, lartësia e mjeteve dhe struktura e mjeteve financiare.

Në Kosovë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të marrin kredi nga bankat dhe atë me kamatë të lartë. Si mjet garantues për marrjen e kredisë nevojitet pengu, hipoteka në vlerën për dy herë më të madhe se kredia. Kredia jepet për veprimtari të ndryshme ekonomike, si për kapital qarkullues ashtu edhe për kapital themelor. Edhe disa organizata mikrofinanciare lejojnë kredi me vlerë më të vogël se sa bankat, me kamatë të njejtë mirëpo me afat më të shkurtër.

Fjalët kyçe: Menaxhimi, financimi, ndërmarrje, kredi, kapital, kamatë, burime të financimit, mjete financiare, aktivitete të financimit.

JEL Klasifikimi: B26, GOO, G01, G29, H12, F24, E52, E43.

1. Hyrje

Menaxhimi i burimeve të financimit hap perspektivë të zhvillimit më të shpejtë të bizneseve të vogla dhe të mesme duke mundësuar ngritjen e efikasitetit të qëndrueshmërisë së këtyre bizneseve.

Problemi kryesor me të cilin po ballafaqohen këto biznese në Kosovë është mungesa e burimeve financiare që njëherit e pengon krijimin e bizneseve të reja si dhe zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

Financimi dhe zhvillimi bashkëkohor i bizneseve të vogla dhe të mesme mund të hapë perspektivë për rritjen e punësimit dhe zvoglimin e varfërisë.

Nga ky aspekt financimi i bizneseve të vogla dhe të mesme duhet të përkrahët në formë institucionale nga administrata qendrore dhe lokale nëpërmes mbështetjes financiare, duke aplikuar stimulim në politikën tatimore, monetare, kreditore, doganore, etj. Studimet e këtij punimi do të bazohen në hulumtimet që mundësojnë identifikimin e faktorëve dhe zgjedhjen metodave për përcaktimin e modelit të qëndrueshëm të menaxhimit të suksesshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme në ekonominë e Kosovës.

2. Ndikimi i krizës globale në burimet e financimit në Kosovë

Në fillim kriza përfshiu ekonominë e vendeve më të zhvilluara kapitaliste, ku dhe ishte me intenzitet më të lartë. Globalizimi i ekonomisë, i tregjeve dhe i financave botërore bëri që kriza, edhe pse lindi e u zhvillua vetëm në disa shtete të pasura e të fuqishme, të përhapej shpejtë dhe nuk kurseu asnjë shtet në tërë botën.

Kështu, kriza ekonomike globale në mënyrë direkte apo indirekte ndikoi edhe në Kosovë, përkitazi me investimet e huaja. Tani vërehet mungesë e investimeve të huaja dhe gjendja ekonomike dhe sociale po rëndohet edhe më shumë.

Republika e Kosovës po përballet me shumicën e problemeve, të cilat i kanë pasur edhe shtetet tjera postkomuniste dhe shtetet që kanë dalë nga konflikti.

Republika e Kosovës është shteti më i varfër në Evropë. Të bësh biznes është e vështirë, Kosova është ranguar e 113 – ta nga Banka Botërore për bërjen e biznesit më 2009.

Bankat komerciale në vend po përcillen me një trend negativ të kreditimit. Është shtuar përqindja e kredive të këqija jopërfomuese. Mirëpo, ka një rritje të kreditimit por në një masë shumë më të vogël se sa viteve të kaluara.

Marrëdhënja midis performancës së biznesit dhe performancës së bankave qëndron në raport proporcional dhe përkeqësimi i gjendjes financiare dhe komerciale tek bizneset reflektohet në përkeqësimin e gjendjes financiare dhe komerciale edhe të bankave.

Planifikimi i joefikas i rrjedhës së parasë është rezultat i krizës por edhe i mos planifikimit të kompanive vendore. Kreditë janë zvogëluar, sepse bankat rezervohen në këtë kohë krize, meqë kanë informacione se kompanitë do të kenë vështirësi për kthimin e kredive, prandaj në kohë krizash bankat janë më konservative, e kjo gjë po ndodhë edhe në Kosovë.⁸⁵

Në Kosovë nuk ka ndonjë përmirësim të financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme e sidomos të financimit të bizneseve fillestare. Është një

⁸⁵ Prof.Dr.Isak Mustafa, “Konferenca e nëntë ndërkombëtare biznesi dhe punësimi”, 2010, Prishtinë, fq.41.

numër i vogël i bankave komerciale në Kosovë për këtë ato kanë një sjellje monopoliste në dhënie të kredive, në afat të kthimit të kredive, janë shumë të shtrenjta dhe jo ekonomike për shumë biznese që kanë nevojë për financim. Sipas raportit të BQK-së në vitin 2009 73.3 % të bizneseve janë pjesëmarrës në kredi bankare ndërsa në vitin 2008 ka pasur 76.3%. Nga kjo shihet se në vitin 2009 ka një rënje prej 3% pjesëmarrje në kredi bankare.

3. Identifikimi i barrierave kryesore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme

Agjencia për mbështetje si dhe institucionet tjera si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, në bazë të hulumtimeve periodike që i kanë bërë, kanë ardhur në përfundim se ekzistojnë barrierat të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme pas hulumtimeve ka arritë të bëjë sistemimin dhe adresimin e barrierave kryesore të cilat për vite të tëra adresohen nga sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë, nga përfaqësues të biznesit dhe autoritete publike shkencore, akademike dhe politike.

Disa nga barrierat kryesore janë:

- Barrierat e përgjithshme,
- Ambienti legal,
- Promovimi i ndërmarrjes,
- Financimi,
- Teknologjia.

Barrierat kryesore në financim janë: pjesëmarrja në kapital dhe kreditë.

Në pjesëmarrjen në kapital ndikojnë:

- Padisponueshmëria e kapitalit vetanak,
- Rrjedha e kufizuar e investimeve të huaja,
- Fitimi i ultë në shumicën e bizneseve.

Te kreditë ndikojnë:

- Lartësia e kolateralit dhe kërkesave për garanci,
- Grejs periudha të shkurtra të kthimit të kredive,
- Shkalla e lartë e interesit,
- Vështirësitë në qasje afatgjate financiare në institucionet kreditore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO) kanë organizuar konferencën e përbashkët me titull: Burimet e financimit për rritjen ekonomike: A ka para të mjaftueshme në Kosovë ?

Korniza makroekonomike për rritjen ekonomike, ishte tema e prezantuar nga z. Renzo Daviddi, kreu i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit

Evropian. Sipas tij qasja në financim është njëra ndër barrierat kryesore për sektorin privat në Kosovë. Kosova ka para që mund të investohen ato duken edhe nga depozitat e larta bankare, por kostoja e financimit është e lartë për shkak të riskut të perceptuar nga bankat.

Ndërsa z.Robert Wright prezantoi temën “Financimi kreditor për sektorin privat”.

Sipas tij tregu në total i huave është 1.3 miliardë euro prej të cilave 73% janë kredi për sektorin e biznesit. Sektori bankar ka 500 milionë euro depozita të pashfrytëzuara. Wright ka thënë se nga aspekti i bankave problematike nuk është vetëm mosshfrytëzimi i këtyre parave por edhe numri i vogël i firmave që përdorin kreditë për të investuar në bizneset e tyre, që në total është 23.5% i bizneseve në Kosovë, shifër kjo ende e ultë krahasuar me vendet e rajonit. Sipas tij sektori i tregtisë prinë me afro 55% të kredive të marra në banka. Ai ka shfaqur vërejtjen e tij se fokusimi në ndërtimtari i ekonomisë mund të ketë pasoja në rast se këto prona që ndërtohen nuk shitën. Gjithnjë sipas z.Wright, në Kosovë ka nevojë për krijimin e mundësive të reja për lëshimin e kredive sidomos në sektorin e shërbimeve komunale, telekomit, shëndetësisë, teknologjisë, për faktin se në këto fusha risku mund të jetë më i ultë etj.⁸⁶

3.1 Pasojat e normave të larta të interesit

Normat e larta të interesit në kreditë e bankave komerciale në Kosovë vështirësojnë financimin dhe zhvillimin e bizneseve, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Prishtinë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike. Bizneset në Kosovë nuk mund të zhvillohen pa mbështetjen financiare të bankave komerciale, por sistemi i financimit të këtyre bizneseve është tejet i shtrenjtë, për shkak të normave të larta të interesit nga kreditë e bankave, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike. Agim Shahini, drejtues i Aleancës Kosovare të Bizneseve, thotë se ngritja e normave të interesit nga bankat komerciale në gjithë botën, është pasojë e krizës financiare botërore, por niveli i normave të interesit në Kosovë, sipas tij, është më i larti. “Në ato vende që ka krizë, e kanë gjetur rrugën që t’i ulin normat e interesit dhe të dalin nga kriza. Bankat në Kosovë e kanë gjetur mënyrën tjetër, që t’i ndalojnë kreditë, t’i rrisin normat e interesit dhe kështu t’i detyrojnë bizneset që të shkojnë drejt falimentimit”. “Kjo do të thotë se bizneset gjenden në një pozitë të vështirë, duke marrë për bazë normat e larta të interesit prej 15 deri në 17 për qind të bankave, duke marrë parasysh politikat tregtare dhe fiskale jo të favorshme dhe duke u nisur nga fakti bazë se fuqia konsumuese në Kosovë për çdo ditë po varfërohet”, thotë Shahini.

Ngjashëm vlerëson edhe Muhamet Sadiku, ekspert për çështje të ekonomisë, i cili thotë se me normat aktuale të interesit në kreditë bankare në Kosovë, është vështirë të ndërtohet konkurrenca e bizneseve. “Këto norma janë

⁸⁶ <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,52,321>

të larta edhe në aspektin e krahasimeve rajonale dhe ndërkombëtare. Do të thotë, kapitali në Kosovë e ka çmimin më të lartë në raport me të gjitha këto zhvillime në tregun rajonal”. “Kemi ardhur në një situatë, ku bankat janë akomoduar me norma të larta të kamatës dhe flitet që kemi sistem bankar të qëndrueshëm, ndërsa kemi biznese të dobëta. Do të thotë, i tërë sistemi bankar dhe formula e financimit të tyre janë joadekuate në raport me nevojat reale të bizneseve në Kosovë”, thotë Sadiku.

Vitin e kaluar, ne kemi pasur rreth një mijë biznese që janë mbyllur dhe kjo është një shqetësim për të gjithë ne. Ky është një argument se duhet të ketë reforma të mëdha në gjithë spektrin, qoftë ekonomik, qoftë atë të ndryshimeve të politikave tregtare, financiare, fiskale. Kjo do ta ndihmonte biznesin”.⁸⁷

3.2 Mundësit e financimit të bizneseve në Kosovë

Hulumtimi i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, mbi qasjen në kapital, nxori në pah shumë çështje, për të cilat ekspertët dhe përfaqësues të institucioneve bankare në Kosovë duhet t’i kushtojnë rëndësi. Kështu u tha në Konferencën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Lekë Musa, tha se bizneset në Kosovë, burimet e tyre të financimit, i shfrytëzojnë, kryesisht, përmes bankave, kursimeve të tyre dhe huamarrjes, duke mos pasur shumë informata rreth burimeve të tjera të financimit që do të ishin më të përshtatshme për ta. “Ende nuk është eksploruar i tërë sistemi financiar, do të thotë, burime të tjera të financimit, përveç atij bankar. Pastaj, si një problem kyç i zhvillimit ekonomik, është identifikuar edhe mungesa e financimit të bizneseve, të cilat sapo lindin. Ndërsa, nga sistemi bankar në vend, është kërkuar që të përmirësohet raportimi financiar, përkatësisht, të përmirësohen raportet e pasqyrave financiarë, me të cilat prezantohen bizneset”, thotë Musa. Ndërsa, sa i përket normave të interesit, hulumtimi thekson se, ato janë të krahasueshme të rajonit. “Si propozime për ulje të normave të interesit, është vetë zgjerimi i bazës së ofruesve të kredive, do të thotë, që të zgjerohet tregu i kapitalit, që të shtohet numri i bankave, liberalizimi i tregut, pastaj jepet si një opcion edhe ndërhyrja nëpërmjet politikave të ndryshme qeveritare, ku ata do të bënin atë që është paraparë në ligjin e ri mbi Bankën Qendrore”, ka sqaruar Lekë Musa, nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Ekspert të kësaj fushe, thanë se, si burime tjera të financimit, që bizneset mund të përdorin janë edhe investimet në aksione si dhe përdorimi i instrumenteve të tjera financiare.⁸⁸

⁸⁷ <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,5,22647>

⁸⁸ <http://www.koha.net/index.php?cid=1,5,14863>

4. Huadhënjet për bizneset e vogla dhe të mesme në Kosovë nga maji i vitit 2008 deri në prill të vitit 2009

Tabela 1: Kreditë bruto për korporata sipas sektorëve.

	Pril l '08	Ma j '08	Qe r '08	Ko rr '08	Gu. '08	Sht '08	Tet '08	Në n '08	Dh j '08	Jan '09	Sh k. '09	Ma '09	Pri. '09
Bujqësia	27. 9	29. 2	30. 4	31. 1	31. 8	32. 2	33. 5	33. 3	33. 3	33. 3	38. 4	39. 3	34. 3
Industri, Energji, Ndërtim	16 2.5	16 8.9	16 9	17 2.8	17 8.8	16 7.0	16 2.9	16 3.4	16 0.2	16 2.4	17 5.3	19 3.9	19 2.4
-Miniera	0.5	0.5	0.6	0.6	0.6	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	4.1	3.7	3.6
-Industri,	10 4.1	10 9.8	10 9.5	11 1.5	11 2.6	10 0.6	96. 7	96. 4	93. 8	92. 2	10 1.5	11 5.0	11 0.2
-Industri përpunues e (ushqim)	76. 5	79. 2	77. 5	79. 4	79. 5	79. 5	77. 4	77. 2	75. 1	74. 3	78. 4	86. 3	83. 1
-Industri përpunues e(Vaj, Kimikale)	14. 0	16. 8	18. 2	18. 6	19. 7	19. 5	17. 9	17. 7	17. 1	16. 3	21. 3	26. 9	25. 4
-Energjia elektrike,g azi dhe uji	13. 7	13. 7	13. 7	13. 5	13. 5	1.6	1.5	1.5	1.6	1.6	1.7	1.8	1.8
-Ndërtim	57. 9	58. 6	59. 0	60. 7	65. 6	65. 9	65. 5	66. 2	65. 6	69. 3	69. 7	75. 1	78. 6
Shërbime:	60 5.1	62 0.2	64 6.2	65 3.7	65 2.1	66 3.1	69 0.4	71 0.8	70 4.8	70 7.0	70 9.0	70 2.4	71 2.8
-Tregti	46 3.3	47 4.9	49 0.8	48 9.9	49 0.9	49 8.0	49 9.6	50 8.5	50 4.7	50 7.5	54 8.9	53 6.7	52 4.9
-Tregti shitjes me shumicë	40 4.1	41 4.7	42 6.8	42 3.5	42 3.8	43 1.3	43 4.3	44 1.4	43 7.5	43 8.5	46 9.3	45 9.1	44 7.6
-Hotelet dhe restorantet	36. 8	40. 2	42. 4	44. 0	44. 0	43. 6	43. 5	45. 0	45. 1	45. 2	47. 7	47. 6	47. 7
-Tregti tjetër	22. 4	20. 0	21. 6	22. 4	23. 0	23. 1	21. 8	22. 1	22. 0	23. 9	32. 0	30. 0	29. 6
-Shërbime financiare	6.4	6.5	9.6	10. 4	6.6	6.4	5.8	6.0	6.0	5.7	8.7	11. 0	10. 8
-Shërbime tjera	13 5.5	13 8.8	14 5.7	15 3.3	15 4.7	15 8.0	18 4.4	19 5.8	19 4.2	19 3.8	15 1.4	15 4.7	17 7.1
Gjithsejt:	80 0.9	82 3.8	85 1.1	86 3.2	86 8.2	86 7.8	89 1.1	91 1.8	90 2.4	90 6.8	92 7.2	94 0.4	94 4.2

Burimi: Agjencia për mbështetjen e NVM-ve, 2009, Raport vjetor, fq.29.

Nga tabela e mësipërme vërehet se kreditë bruto për korporata kanë një tendencë rritje nga muaji në muaj krahasuar muajin prill të viti 2008 me po të njëjtin muajin në vitin 2009 vërehet një rritje prej 17.9%.

Bazuar në kreditë bruto të korporatave sipas sektorëve nga periudha e muajit prill 2008 deri në periudhën e muajit prill 2009 rritje më të madhe ka sektori i Industrisë përpunuese (vaj, kimikale), me 81.43%. Pas këtij sektori radhitet sektori i shërbimeve financiare me një rritje prej 68.75% krahasuar mes periudhës prill 2008 - prill 2009. Rritja më e vogël është prezente te sektori i minijerave ku krahasuar me muajin prill 2008 në muajin prill 2009 vërehet një rritje për vetëm 7.2%.

Në tabelën e mësipërme ku janë pasqyruar kreditë bruto për korporata sipas sektorëve, te sektori i energjisë elektrike, gazit dhe ujit vërehet një rrënjë për - 66.86 % për prill 2009 krahasuar me periudhën prill 2008.

Tabela 2. Kredit Bruto për Korporata dhe ekonomi familjare.

	Pr ill 0 8	Ma j '08	Qe r '08	Ko rr '08	Gu. '08	Sht '08	Tet '08	Në n '08	Dh j '08	Jan '09	Sh k. '09	Ma '09	Pr. '09
Kredit ë bruto dhe të ngjash me për Korpo rata financi are dhe Jofina nciare dhe ekono mi familj are		1.0 52. 8	1.0 89. 7	1. 11 4.	1.1 24. 2	1.1 30. 2	1.1 60. 8	1.1 87. 9	1.1 83. 4	1.1 88. 6	1.2 11. 2	1.2 29. 8	1.2 3 ...

Burimi: Agjencia për mbështetjen e NVM-ve, 2009, Raport vjetor, fq.30.

Nëse krahasojmë kreditë bruto të ekonomive familjare nga muaji në muaj atëherë rritja më e madhe është në muajin qershor të vitit 2008 ku

=====

krahasuar me muajin maj të vitit 2008 kemi rritje për 3.5% ndërsa rënje kemi në muajin dhjetor për 0.39% krahasuar me muajin nëntor të vitit 2008.

Marrë në përgjithësi tabela e mësipërme paraqet një rritje prej 21.51% nga muaji prill 2008 deri në muajin prill 2009 për kreditë bruto të korporatave dhe ekonomive familjare.⁸⁹

4.1. Kushtet ekonomike të kredive në vitin 2009

Kushtet ekonomike varen nga: lloji i kredive, maturiteti, kamata, shuma maksimale e kredisë, kushtet për marrje të kredisë etj.

Për nga shuma e kredisë klasifikimi i tyre mund të varirojë ndërmjet bankave, por përgjithësisht ato ndahen në të vogla deri në 10 000 euro, të mesme deri në 100 000 euro dhe të mëdha mbi 100 000 euro. Kreditë jepen bazuar në mundësinë që biznesi ka për kthimin e tyre, por gjithashtu përveç pengut të luajtshëm duhet të sigurohen me patundshmëri.

Struktura e kredive sipas sektorëve edhe në vitin 2008 ka mbetur e ngjajshme me periudhat e kaluara. Pjesmarrjen më të madhe në kredi e kanë ndërmarrjet me 76.3 % të gjithsej kredive (77.5% në 2007), ndërsa ekonomitë familjare 23.7% (22.5% në 2007). Në kuadër të kredive të ndërmarrjeve, dominojnë ndërmarrjet që merren me tregti me një pjesëmarrje prej 42.6%. Sektori me pjesëmarrjen më të ultë në kreditë e sektorit bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, përfaqësuar me vetëm 4.1% në gjithsej kreditë. Me gjithë atë, në vitin 2008 vërehet një rritje në kreditë e lëshuara ndaj këtij sektori.

⁸⁹ *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Agjencia për mbështetjen e NVM-ve", raporti vjetor 2009, Prishtinë, fq.29.*

Përfundim

Zhvillimi i menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë mund të kontribuojë në zhvillimin efikas të bizneseve të vogla dhe të mesme në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut.

-financial Statement-raportim financiar1.raport kontabel ku permblihet ecuria financiare e nje subjekti biznesi pergjate nje periudhe te dhene kohore.perbehet nga keto komponente;*bilanci(balance sheet), ku evidentohet gjendja e te nje firme ne dy momente te ndryshme .* evidenca e te ardhurave (income statement) .Quhet edhe evidence e operimit te firmes (operating statement) ose evidence per fitime dhe humbje (profit and loss statement). Evidenton te ardhurat nga shitjet,shpenzimetdhe rezultatin fitim/humbjeqe nje firm ka realizuar pergjate nje periudhe te dhene kohore.

-Finished Goods Inventory –inventare te produkteve te perfunduara ,inventare te produkteve te gateshme.Gjendje mallrash te perfunduara dhe te

gatshme per shitje , qe nje firme ka ne nje moment te dhene.Perfshin mallerat ne dyqane dhe ne pika shitje qe jane ne pritje per tu shitur-Inventories.

ED2

-**Finance/Finance/** 1.fushe e veprimtarise ekonomike qe perfshin mjetet monetare dhe veprimet qe kryhen ne to. 2. Dege e administrates shteterore qe merret me keto mjete dhe veprime.

-**buxhet financiar/ financial budget**

-**financa ;**purchasing powe of money/

-**furnitori,furnizuesi/** supplier, contractor,deliverer,dealer.
publike/public finances

-**kontabilitet financiar/financial** accounting, generalaccounts(
accountings)

-**mjete financiare/funds, capital, finacial facilities.**

Fond aksiones/ investment company(trust)

Fondi Monetar Nderkombetar/International Monetary Fund.

Fondi I sigurimit te depozitave/ Deposit guarantee fund.

ED3.

Finance- noun/ money use to run a business, an activity or a project; finance for education comes from taxpayers,2. the activity of managing money, especially by a government or commercial organization; the Minister of Finance;the finance director, **3.finance-** money available to a person , an organization or country ; the way this money is managed; the government/ public/personal finances

Finance/ verb/ to provide money for a project, SYN. Fund.The building project will be financed by government and by public donators .

Filing/noun/ 1.the act of putting documents , letters etc, into a file.

2.something that is placed in an official record; a bankruptcy filing;

2.2. There are some entries not found in every dictionary causing learners difficulties on finding the right translation such as.

2.2.1. **Hammering the Market**-goditje tregu,rendim tregu.Shitje intensive nga ana e subjekteve te nje tregu apo burse,kur shitesit mendojne se qmimi real I te sigurtave , mallerave, valutave,dhe vlerave qe disponojne, do te bjere-selling short.

This entry can be found only in the ED1 not in the other two dictionaries.

or

=====

2.2.2. Hard Currancy- money that is easy to exchange for money from another money, because it is not likely to lose its value; the hotel insisted that we pay in hard currency.

Found only in ED3

2.2.3. Offshore banking./ Emertim per operatione bankare nderkombetare, te cilat zhvillohen jashte sistemit monetar te vendit, ku ato realizohen. Operacionet bankare offshore realizohen para se gjithash ne vendet financiare evropiane si Londra dhe Luksenburg, si dhe ne Azine Juglindore (tregu Aziatik I dollarit) dhe ne Ameriken e Veriut.

2.2.4. Lease/noun/ an alegal agreement that allows you to use a building, a piece of equipment or some land for a period of time, usually in return for rent; **to take out a lease on a flat**

2. verb- sth to sb. to use or let sb use sth, especially property or equipment , in exchange for rent , or a regular payment; **they lease a land from a local farmer.**

2.2.5.- Lizing* - has no Albanian equivalence found- a borrowing is used instead

ED1: **Leasing** - Thuhet se nje transferim fondi permbushet kur banka e perfituesit (beneficiary) pranon pagesen ne favor te tij, duke ia kryer pagesen dhe shkarkuar detyrimin qe derguesi kishte ndaj perfituesit. Ky rregull eshte I pacenueshem. Rrezik paraqet vetem kur banka ndermjetese e kryerjes se transferimit te fondit falimenton.

2.2.6.- Zakah Fund- Fondi I ndihmes se vullnetshme- Ne sistemin financiar islamik i referohet nje fondi qe krijohet per te ndihmuar familjet ose individet me te ardhura te pakta, te varfer, te papune, etj. Krijohet nga te ardhurat e cdo subject biznesi a individ ne nje mjedis te ekonomise islamike.

2.2.7.- Zollvereign – Bashkim doganor [gjermanisht]. Term qe se pari haset ne shekullin e XIX, duke iu referuar levizjes per heqjen e pengesave doganore dhe nxitjen e unitetit ekonomik te Gjermanise.

3. Conclusion

Using English-English dictionaries is learning the language from professional English teachers in plain english. They can learn what plain English is like as well as what the words they are looking up mean.

I encourage the use of dictionaries and teach learners how to use them by explaining the different abbreviations that are used and with work on the phonetic symbols and 'stress' indications. However, "just as a carpenter needs a hammer, dictionary is the best tool for the job that learners are trying to do." Learners should be dictionary-oriented! Whatever they do in classes somehow is related to a dictionary. the meaning of a word or correct pronunciation of a word or anything like that should be checked by learners in classes. Also learners should write examples to show how a special word is used in real context, to put it in a nutshell, a dictionary can be the best teacher for English learners if they know the right way of using it.

Impossibility of having a proper dictionary offering adequate word in Albanian causes the use of anglicisms which make the process of speaking and understanding the language more difficult. For eg. If we talk about Bonds or Assets to an old man, a child or even an adult who does not understand English, it is really difficult to understand the role or even the difference between the two of them. I think that linguists of both Albanian and English language should work hard and come up with a dictionary which will be a great help to the learners of EBE or ESP dictionaries. A bilingual dictionary is necessary due to the level of the students at the beginning. An english-english one is only used with advanced learners. It is absolutely necessary to use one, very often teachers first have to teach learners how to take advantage of it (dictionary) and take time to work with examples on the different meanings depending on the context.

The use of dictionaries is optional in the classrooms, but those who use it get the privilege of learning new words faster because the process of looking the word up in the book will make it permanent in our brains. e-dictionaries are the new trend that have to be applied in every institute, they are really useful.

Bibliography

1. Cambridge University Press- Ian Mc Kenzie – English for Business Studies
2. John Flower – Build your Business Vocabulary
3. www.BritishCouncil.com
4. Ilir Hoti- Fjalor enciklopedik
Anglisht-Italisht-Shqip per Banken, Biznesin, Ekonomine- trilingual
English-Italian-Albanian Encyclopedic Dictionary of Economics, Banking and Business-trilingual- January 2001
5. Maksim Konini- Fjalor Ekonomik
Shqip-Anglisht –Gjermanisht-1997
6. A.S. Hornby- Oxford Advanced Learner's Dictionary
Oxford University Press.2000
7. www.esp-world.info

=====

KUD 005(496.51-2)

**IDENTIFIKIMI I KARAKTERISTIKAVE KRYESORE TË BVM-VE NË
REGJIONIN E PEJËS**

Sokol J. Domniku
sdomniku@gmail.com

Abstrakt

Sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të çdo vendi, e në veçanti për Kosovën që është duke kaluar në fazën e tranzicionit në një kahje drejt ekonomisë së tregut. Në këtë punim do të shfaqen karakteristikat kryesore të organizimit të bizneseve të vogla dhe të mesme (në tekstin e mëtejshëm BVM-ve) në regjionin e Pejës, u bërë përshkrimi i vend ndodhjes së tyre, veprimtarisë, organizimit, menaxhimit si dhe përgjegjësinë ligjore që e bartin. Më tej do të bëhet një analizë dhe një diskutim nga të dhënat e gjetura që mbështeten në një hulumtim empirik të realizuar nëpërmes anketimit të BVM-ve në regjionin e Pejës. Pjesa e fundit do të përfshijë pjesën e rekomandimeve të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kushteve aktuale të BVM-ve qoftë për nga aspekti i jashtëm por edhe ai i brendshëm që kanë për qëllim rritjen e performancës së tyre. Punimi me titullin e lartcekur është shumë aktual duke u mbështetur për nga aspekti i vështirësive që i kanë BVM-të sot, mirëpo edhe për nga aspekti i rolit të tyre si sektor shumë i rëndësishëm në ndikimin e tyre në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik që manifestohet nëpërmes zbutjes së papunësisë, rritjes së prodhimit vendor, përmirësimit të bilancit tregtar, rritjes së shkallës së investimeve në regjionin e Pejës, etj.

Fjalët kyçe: BVM-të, Menaxhim, Organizim, Përgjegjësi ligjore, Veprimtari.

JEL Kualifikimi: R10; R12; R39;

1. Hyrje

Karakteristikat e organizimit të BVM-së në Kosovë janë të shumta, duke filluar nga roli dhe rëndësia e BVM-së, kontributi i tyre në ekonomi, forma e veçantë e mënyrës së operimit dhe organizimit, etj. Sektori i BVM-së luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik për çdo vend në botë, e sidomos për Kosovën që është duke kaluar në fazën e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut ku pothuajse të gjitha firmat e biznesit klasifikohen si biznese të vogla ose të mesme. Vitet e 90-ta për biznesin kosovarë ishin jashtëzakonisht të vështira. Hapësira afariste ku ata vepronin ishte e mbushur me ligje diskriminuese dhe ndërhyrje arbitrare të zyrtareve të atëhershëm të një sistemi okupues. Mundësitë për zhvillimin e biznesit privat ishin shumë të vështira e në veçanti për gjininë

femërore. Megjithatë, përkundër kushteve të jashtëzakonshme të operimit, kosovarët edhe në atë kohë treguan se posedojnë atributet e ndërmarrësit, siç ishte guximi dhe gatishmëria për tu ballafaquar me një shkallë të lartë të riskut. Në vitin 1999 me përfundimin e luftës në Kosovë, rrethanat për krijimin dhe zhvillimin e firmave të biznesit ndryshuan dukshëm duke krijuar mundësi shumë më të favorshme.

Duhet cekur se BVM-të demonstrojnë një shkallë të lartë të novacioneve, fleksibilitetit dhe adaptimit ndaj ndryshimeve të cilat ndodhin në rrethinë. Prandaj, duhet vënë në dukje ndikimin e BVM-së në rritjen e punësimit në vend si dhe në përgjithësi në nxitjen e zhvillimit ekonomik duke nënkuptuar dinamizmin e ekonomisë. Në shumicën e vendeve të botës ndikimi i BVM-së është pozitivisht i jashtëzakonshëm me ç'rast ky ndikim manifestohet në rritjen e punësimit, rritjen reale ekonomike, reduktimin e varfërisë, nxitjen e kërkimeve shkencore, novatorizmin, etj.

Prandaj, synim kryesor i këtij punimi është që me grumbullimin, paraqitjen dhe prezantimin e të dhënave teorike dhe empirike, është arritur të konstatohet mënyra e organizimit të BVM-së e në veçanti të vijmë deri te konkludimet dhe analizat e trendit zhvillimor dhe organizativ të BVM-së në regjionin e Pejës.

Përgjithësisht në këtë punim synohen të arrihen këto qëllime:

- të bëhet njohja e kapacitetit dinamik të BVM-së
- të potencohet rëndësia e BVM-së në ushqyerjen e zhvillimit shoqëror në Kosovë
- të paraqiten të dhënat empirike në lidhje me krahasimin e gjendjes së BVM-së në Kosovë për nga aspekti i llojit dhe i veprimtarisë së tyre dhe krahasimit në periudha të caktuara kohore.
- Të ofrohen rekomandime që mund të kenë ndikim në përmirësimin gjendjes së BVM-ve të regjionit të Pejës.

Aspekti teorik do të krijojë një tablo bazë për kuptimin e koncepteve themelore të BVM-ve, përderisa të dhënat empirike do të ofrojnë të dhëna në lidhje me pozitën dhe gjendjen e BVM-ve në regjionin e Pejës duke përshkruar karakteristikat kryesore të tyre.

2. Kuptimi dhe klasifikimi i BVM-së

Pasi që pothuajse në të gjitha vendet në të cilat dominon sistemi i ekonomisë kapitaliste ose edhe asaj socialiste, përcaktimi dhe definimi i BVM-së nuk është i njëjtë në të gjitha vendet me ç'rast edhe lirshëm mund të konstatojmë që nuk ka ndonjë përkufizim të përgjithshëm rreth definimit të BVM-së. Janë dhënë shumë përcaktime sasiore dhe cilësore rreth kësaj problematike nga organizata dhe institucione të ndryshme shkencore akademike dhe financiare. Shtypi në mënyrë të vazhdueshme e përkufizon biznesin e vogël si një biznes me më pak se 100 punëtorë, ndërsa “SBA” (*administrata e biznesit*

të vogël) e përkufizon “si një biznes që zotërohet, vepron në mënyrë të pavarur dhe nuk vepron mbi fushë veprimtarinë e tij”.

Në Francë termi biznes i vogël nënkupton ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, mirëpo ky term përjashton kompanitë të cilat i kanë më pak se 10 të punësuar. Në vende të tjera si Britania e Madhe dhe Danimarka, standard për klasifikimin e bizneseve e kanë numrin e të punësuarve mirëpo e marrin parasysh edhe nivelin qarkullimit. Nga kjo nënkuptojmë se në një vend që një biznes i caktuar klasifikohet si i vogël, në vendin tjetër mund të radhitet dhe klasifikohet si biznes i mesëm. Konkretisht, një biznes i vogël në Britaninë e Madhe (me më pak se 200 të punësuar) në Danimarkë klasifikohet dhe konsiderohet si biznes i mesëm. Shembull tjetër e kemi shtetin e Tajlandës e cila bizneset e vogla i konsideron ato biznese të cilat i kanë të punësuar më pak se 50 punonjës, përderisa biznes të mesëm ato të cilat i kanë të punësuar prej 50 – 200 punonjës.¹⁴⁶

Në vijim në tabelën 1, do të prezantohet mënyra e klasifikimit të BVM-së sipas standardit të Bankës botërore dhe Unionit Evropian¹⁴⁷:

Tabela 1. – Klasifikimi i BVM-së sipas: Bankës botërore dhe Unionit Evropian

Nr.	Emërtimi	Nr i Punëtorëve (Banka Botërore)	Nr i punëtorëve (sipas UE-së)
1.	Mikro-ndërmarrje	1 – 5	1 – 9
2.	Ndërmarrje të vogla	6 – 25	10 – 49
3.	Ndërmarrje të mesme	25 – 250	50 – 249

3. Veprimtaria – Menaxhimi – Përgjegjësia ligjore e BVM-së në Republikën e Kosovës (të dhëna statistikore të nxjerra nga hulumtimi empirik)

Në mënyrë që punimi ti krijohet një karakter më real për nga aspekti i argumentimit të temës së përcaktuar, është bërë një hulumtim i BVM-së dhe kryesisht në bizneset e intervistuarat kanë qenë bizneset e regjionit të Pejës. Këndvështrimi i këtij hulumtimi është të ofrojë të dhëna në lidhje me vendin ku veprojnë BVM-të, veprimtarinë, menaxhimin, organizimin dhe përgjegjësinë ligjore të tyre. Në hulumtim janë përfshirë 82 biznese nga të cilat janë


¹⁴⁶Phapruke Ussahawanitchakit (2008): Review of Business Research, fq. 16

¹⁴⁷ Domniku Sokol: “Bazat e biznesit”, fq. 79

intervistuar firmat nga të gjitha qendrat kryesore të regjionit përfshirë; Pejën, Deçanin, Istogun dhe Klinën.


Nga 82 ndërmarrje¹⁴⁸ gjithsejtë sa janë intervistuar, 73 prej tyre kanë qenë nga qyteti i Pejës me rrethinë në mesin e të cilave biznese të vogla por edhe të mesme me ndikim të madh në ekonominë e Kosovës, 5 firma të biznesit kanë janë intervistuar në qytetësen e Istogut, 3 qytetës e Klinës, si dhe 1 nga qyteza e Deçanit.

Grafiku 1. Vendndodhja e bizneseve të intervistuar



BVM-të sipas llojit të veprimtarisë janë prodhuese, shërbyese dhe tregtare. Nga anketa e 82 firmave del se veprimtarinë tregtare e ushtrojnë 28% të BVM-ve, 12% të BVM-ve janë prodhuese, 28% të BVM-ve ushtrojnë veprimtari shërbyese ndërsa 32% të BVM-ve ushtrojnë më shumë se njëren prej veprimtarive të lartcekura.


Grafiku 2. Veprimtaritë e BVM-së



Nga të dhënat e paraqitura në grafikun 2 vërehet se 32% e BVM-ve ushtrojnë më shumë se një veprimtari ndërsa vërehet shkallë e njëjtë e përqindjes tek veprimtaria shërbyese dhe ajo tregtare përderisa në veprimtarinë prodhuese kemi një përqindje më të vogël të BVM-së.


Grafiku 3. Menaxhimi i BVM-së

¹⁴⁸ Anketë-hulumtim i BVM-ve në regjionin e Pejës; realizuar nga studentët e Kolegjit Iliria – Dega në Pejë (Maj 2010)



Nëse i shikojmë të dhënat nga grafiku 3., atëherë mund të vërejmë rreth 90% të BVM-ve, procesin e menaxhimit të firmave të tyre e bëjnë vet pronarët, përderisa vetëm rreth 7% prej tyre menaxhohen nga menaxherët profesionistë, ndërkaj 23% raste të identifikuar të BVM-ve drejtohen së bashkërisht nga pronarët dhe menaxherët e firmave.


Grafiku 4. Format e organizimit të BVM-së



Në bazë të të dhënave nga hulumtimi i bërë në lidhje me identifikimin e formës së organizimit të BVM-së, del se rreth 90% të BVM-ve i takojnë pronësisë individuale të cilat pasohen me pjesëmarrjen e formës së shoqërisë aksionare me rreth 7% prej tyre përderisa së fundmi rënkohej forma e pronësisë së partneritetit me vetëm 3% të BVM-ve.

Sipas të dhënave të prezantuara në grafikun 5., 82 nga BVM-të janë deklaruar vetëm 46 prej tyre që në përqindje paraqet 56% prej tyre, përderisa 26 prej BVM-ve respektivisht 21% të tyre nuk janë deklaruar fare. Forma ligjore me përgjegjësi të plotë aplikohet nga 21 BVM-të që në përqindje shprehet në 26%, përderisa 35 prej tyre janë deklaruar se kanë përgjegjësi ligjore të kufizuar dhe që në përqindje shprehen në 43%.

Grafiku 5. Përgjegjësitë ligjore të BVM-ve



4. Diskutime dhe analizë

Sipas të dhënave të përfshira në punim e në veçanti gjetjeve, mund të konstatojmë se tregu kosovar dhe ndërmarrësia kosovare përputhet krejtësisht me vlerat e ekonomisë së tregut ku përfshihen iniciativa private, konkurrenca e plotë, si dhe të parimeve të një sistemi të hapur ekonomik dhe kapitalist. Iniciativa private është dominante në të gjitha vendet e shoqërive kapitaliste në kuptimin industrial por edhe në atë të BVM-së, por edhe sistemeve socialiste por në kuptimin vetëm të biznesit të vogël. Tregu kosovar, e në veçanti ai i regjionit të Pejës, dominohet me veprimtaritë të ndryshme ndërmarrëse përfshirë tregtinë, shërbimin por edhe në një masë edhe prodhimin.

Pjesëmarrja e pronësisë individuale është e theksuar në raport me format e tjera të organizimit të BVM-ve, çka dhe përshtatet me statistikat e pothuajse të gjitha vendeve të tjera kapitaliste të cilat kanë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe në vendet të cilat pjesëmarrja e pronësisë individuale është dominante.

Çka mund të vërehet ndoshta si mangësi për nga aspekti i menaxhimit të BVM-ve, është fakti se në numër të lartë BVM-të drejtohen nga pronarët e tyre e jo nga menaxherët të cilët mund të kenë aftësi dhe shkathtësi më të mëdha për ta bërë këtë punë. Kjo nuk duhet nënkuptuar që të gjithë pronarët nuk i kanë këto attribute profesionale, por nëse merret nga shumica e pronarëve, dihet shumë mirë se njëra nga dobësitë kryesore të pronarëve të firmave të biznesit janë aftësitë dhe shkathtësitë e ulëta që ata i posedojnë dhe që në shumë raste këto attribute mund të ndikojnë që vendimet gjegjësisht vendimmarrja të mos jetë efektive dhe kjo ti krijon mundësi bizneseve që të shkojnë drejt një dështimi të sigurt. Autoriteti i plotë në marrjen e vendimeve është njëra nga armët më të fuqishme, mirëpo “zgjedhja e alternativës më të duhur nganjëherë mund të mos jetë edhe zgjedhja e alternativës së duhur”.

Shumica e BVM-ve aplikojnë përgjegjësi ligjore të kufizuar, çka në shumë aspekte ndërmarrësve e posaçërisht partnerëve ose aksionarëve u krijon një përparësi për nga aspekti i obligimeve por edhe i përfitimeve.

Vërehet një numër i konsiderueshëm i BVM-ve që fare nuk janë deklaruar dhe kjo mund të ketë ndodhur si rezultat i dy arsyeve; së pari ata nuk e

kanë idenë për përgjegjësinë ligjore të firmës, dhe së dyti nuk kanë pasur dëshirë të deklarojnë një përgjigje të tillë.

5. Rekomandime

Duke u mbështetur në të dhënat teorike dhe ato praktike, mund të vijmë në konstatimet si në vijim:

1. Duhet të stimulohet organizimi i ndërmarrjeve në formë të shoqërive aksionare (korporatave) si një formë optimale e cila do të ndikonte në investimin edhe të shumave më të vogla të fondeve financiare që zotërojnë individët dhe familjet dhe në të njëjtën kohë do të ndihmonte në financimin e projekteve që nuk mund të financohen vetëm nga burimet vetanake ose edhe nga kreditë bankare.
2. Struktura e BVM-ve sipas veprimtarive ekonomike tregon se duhet mbështetur me politika makroekonomike cilësore ndërmarrjet prodhuese dhe shërbyese, në mënyrë që tregu i vendit të furnizohet nga ndërmarrjet prodhuese dhe shërbyese vendore dhe kjo të ndikojë në përmirësimin e bilancit tregtar në vend i cili në Kosovë është shumë brengosës.
3. Menaxhimi i BVM-ve duhet besuar menaxherëve profesionistë të cilët në bazë të dijes dhe përvojës që e kanë, dinë në mënyrë shumë më të saktë ti identifikojnë nevojat e tregut përfshirë kërkesat e furnizimeve, shitjeve, tregun financiar, etj.
4. Pronarët duhet investuar në vetvete nëse nuk dëshirojnë që biznesin e tyre t'ua drejton dikush tjetër. Kjo nënkupton se ata duhet vijuar trajnime dhe kurse të ndryshme profesionale të fushës së biznesit dhe menaxhimit. Kjo do ty krijonte një mundësi më të mirë që vendimet e tyre të jenë më efektive dhe kjo të ndikojë që performanca e bizneseve të tyre të ketë një shkallë më të lartë të rritjes.

Marrja parasysh e rekomandimeve të mësipërme në mënyrë të theksuar do të ndikonte që të ngritët vetëdija dhe aftësia ndërmarrëse, mirëpo edhe do të krijoheshin kushte më të mira për rritjen e investimeve në vend. Rritja e investimeve në vend do të ndikonte që të shfrytëzohet në mënyrë më racionale potenciali i tregut të regjionit të Pejës mirëpo këtë duhet nënkuptuar edhe në nivelin e ekonomisë kombëtare për nga perspektiva e biznesit dhe e ndërmarrësisë.

6. Referencat

1. Domniku Sokol (2010): “*Bazat e Biznesit*”, Ligjërata të autorizuar, FSHAB – Pejë
2. Phapruke Ussahawanitchakit (2008): Review of Business Research, fq. 16, Cambridge University, ShBA.
3. Anketë – Hulumtim: “*Identifikimi i karakteristikave kryesore të BVM-ve në regjionin e Pejës*”, Realizuar nga studentët e Kolegjit Iliria – Dega në Pejë, Pejë, Maj 2010.

KUD 338.48(496.51)

RËNDËSIA E TURIZMIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK TË KOSOVËS

*MSc. Valdete REXHEPI
valdeterexhepi@hotmail.com*

Abstrakt

Mbështetja në zhvillimin e degëve ekonomike tradicionale, Kosovës nuk i ka sjellur ndonjë efekt madhor në zhvillimin e deritanishëm, kështu që pasurimi i strukturës ekonomike me zhvillimin e degëve të reja ofron një mundësi kualitative të rëndësishme për avansimin e ekonomisë dhe mbarë shoqërisë kosovare. Qëllimi i këtij punimi është theksimi i disa aspekteve të cilat identifikojnë mundësitë dhe rëndësinë që ofron zhvillimi i turizmit në rritjen ekonomike dhe përparimin e shoqërisë kosovare.

Fjalët kyçe: zhvillimi i turizmit, rritja ekonomike, përparimi i shoqërisë

Hyrje

Ndikimi i turizmit në ekonominë e vendeve të ndryshme në botë është i njohur dhe efektet pozitive zakonisht shprehen në bazë të hyrave që ai vend gjeneron gjatë një periudhe të caktuar. Do të thotë derisa vendet tjera pyesin çfarë ka ndodhur nga zhvillimi i turizmit gjatë një viti, ne akoma duhet të pyesim a do të ndodhë apo si do të ndodhë zhvillimi i turizmit tek ne. Duke e ditur se zhvillimi spontan i turizmit nuk mund të sjellë asnjë të mirë në procesin e zhvillimit të mëtejshëm, por edhe se zhvillimi i turizmit në Kosovë nuk mund të jetë faktori kryesor nga i cili varet zhvillimi i vendit, është e nevojshme që përmes gërshetimit të ideve, shkencës dhe bartjes së përvojave të vendeve të huaja, të kontribuohet që zhvillimit të Kosovës ti bëhet një qasje në mënyrë shumë më konstruktive, me më shumë kuptim ndaj procesit shumë kompleks të zhvillimit, dhe që turizmit si veprimtari ti kushtohet rëndësi më e madhe duke u bazuar në efektet direkte dhe indirekte të cilat trashëgohen si në nxitjen e zhvillimit ekonomik ashtu edhe në atë social.

Turizmi dhe zhvillimi ekonomik

Meqenëse zhvillimi ekonomik ka të bëjë me shumë llojshmëri aspektesh, zhvillimi i turizmit si aktivitet ekonomik duhet të trajtohet jo vetëm në aspekt të rritjes ekonomike të vendit, por edhe në aspekt të ndërlidhjes me kualitetin e jetës së banorëve vendës.

=====

Turizmi si aktivitet ekonomik ka filluar të trajtohet diku nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe përfshirja e degëve tjera ekonomike të domosdoshme në zhvillimin e tij, ka bërë që turizmi të mos vlerësohet vetëm si një aktivitet rekreativ apo argëtues për njerëzit, por të trajtohet si një industri në vete e cila gjeneron të ardhura të konsiderueshme dhe krijon vende të shumta pune, e në veçanti stimulon punësimin e gjinisë femërore. Lidhja në mes të turizmit dhe ekonomisë është një proces shumë kompleks, dhe trajtimi i tij kërkon identifikimin e të gjitha lidhjeve që mund të krijohen dhe duhen të krijohen për funksionimin sa më efikas dhe produktiv të sistemit turistik.

Kosova tani gjendet në rrugë për dalje nga krizat si ato politike, të sigurisë, ekonomike, sociale apo të tjera, të cilat kanë dominuar për vite me radhë. Duke u bazuar në parimin se vendi nuk mund të ketë të ardhme të qëndrueshme pa zhvillim ekonomik, por as zhvillim ekonomik të qëndrueshëm pa stabilitet, është mëse e nevojshme që të identifikohen faktorët të cilët kontribuojnë në qëndrueshmërinë e vendit. Një prej faktorëve i cili mund të kontribuojë në daljen më të shpejtë nga krizat e theksuara është edhe zhvillimi i turizmit.

Edhe pse në Kosovë nuk diskutohet shumë për zhvillimin e turizmit, është e nevojshme përdorimi i përvojave për zhvillim të vendeve nga rajoni dhe më gjerë, dhe të analizohen ndryshimet të cilat turizmi, veçanërisht turizmi i qëndrueshëm si industri e llojit të vet, mund ti sjellë jo vetëm vendit tonë si një veprimtari ekonomike, por edhe të gjithë rajonit apo vendeve fqinje. Për të mos i dhënë hapsirë mundësisë që “ligjet e tregut” të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, zhvillimi i Kosovës duhet të bazohet në parimet e strategjisë nacionale për zhvillim ekonomik dhe në strategjinë për zhvillim rajonal.

Globalizimi, integrimet ekonomike dhe integrimet tjera, duhet të konsiderohen të domosdoshme për zhvillimin bashkohor të shoqërisë dhe përparimin ekonomik të vendit. Tani më çdo vend në një mënyrë të caktuar është pjesë e ekonomisë globale! Rregullat e strategjisë nacionale për zhvillim të qëndrueshëm të vendit, duhet të konceptohen ashtu që të jenë kompatible me rregullat evropiane dhe rregullat e zhvillimit global.

Prandaj në Kosovë, zhvillimit ekonomik duhet qasur sipas planit dhe strategjisë, duke i kushtuar theks të veçantë zhvillimit të turizmit, duke pasur parasysh efektet multiplikative të kësaj dege në punësim, zgjerimin e aktiviteteve ekonomike, zhvillimin kulturor, apo krijimin e mundësive për investime direkte të jashtme. Do të thotë, është e nevojshme që përveç strategjisë për zhvillim ekonomik të Kosovës, të hartohet strategji e veçantë për zhvillimin e turizmit, duke pasur parasysh karakteristikat natyrore favorizuese, trashëgiminë kulturore dhe historike, pejsazhet e bukura natyrore, dhe thesaret tjera. Me strategji do të definoheshin parakushtet të cilat duhet të përmbushen që të vërehen efektet për zhvillimin e turizmit në Kosovë.

Rëndësia dhe aktualiteti për zhvillimin e turizmit në Kosovë, qëndron si në arsyet politike, ekonomike, të sigurisë, dhe të tjera, prandaj hulumtimi i potencialeve turistike të Kosovës duhet të ketë karakter strategjik. Duke pasur parasysh se në perspektivë turizmi mund të jetë një nga mbështetësit kryesor të zhvillimit të Kosovës, atëherë hulumtimet duhet të bazohen në faktorët më të rëndësishëm për zhvillim të turizmit. Kjo do të thotë se përveq pasurive natyrore,

niveli i zhvillimit të tanishëm ekonomik duhet të krahasohet me mjedisin, popullsia me nivelin e arsimit, dhe faktorë të tjerë të cilët janë parakushte për zhvillimin e turizmit.

Efektet që mund të sjellë zhvillimi i turizmit në Kosovë

Turizmi është veprimtari që sjell efekte të shumta pozitive direkte dhe indirekte ekonomike, dhe efekte në zhvillimin afatgjatë të secilit vend si destinacion turistik. Që efektet e turizmit të jenë stabile dhe afatgjata dhe të jenë në funksion të zhvillimit të një destinacioni, duhet bërë planifikimin e qëndrueshëm turistik, pavarësisht sa kompleks është ai proces. Është e nevojshme të tregohet se turizmi së bashku me degët tjera, duhet të kenë karakter të qëndrueshëm. Dhe kjo e bën planifikimin turistik të domosdoshëm për tu shmangur nga zhvillimi spontan.

Sistemi i ri i planifikimit vë theksin në identifikimin dhe parashikimin e pasojave të mundshme nga alternativat e ndryshme politike dhe evoluimi i tyre në raport me qëllimet dhe drejtimit e veprimit. Procesi i monitorimit dhe kontrollit të zhvillimit identifikon dallimet në mes të sistemit turistik të planifikuar dhe atij real.

Që të arrihet deri te strategjia e duhur për zhvillim, duhet të definohet niveli i deritanishëm i zhvillimit, të hulumtohen resurset dhe të identifikohen karakteristikat e lokaliteteve në veçanti dhe në tërësi. Hulumtimet duhet të tregojnë:

- Efektet ekonomike të degëve tjera ekonomike dhe në veçanti turizmi si degë të cilës duhet ti kushtohet një trajtim specifik
- Efektet socio-kullore të turizmit në Kosovë si një destinacion turistik me një të ardhme të rëndësishme
- Efektet ekologjike të turizmit në mjedisin jetësor
- Efektet e turizmit në zhvillimin e përgjithshëm të vendit, mirëpo edhe volumi i efekteve në mjedis përmes integriteteve ekonomike, ekologjike, kulturore

Konceptet bashkohore të zhvillimit krijohen në bazë të grumbullimit të informatave të ndryshme për proceset ekonomike, që në mënyrë sa më të kompletuar dhe të besueshme mund të projektohet rruga e zhvillimit të ardhshëm. Informacionet për trendin e bruto produktit të degëve në veçanti dhe bruto produktit në tërësi, tregojnë në probleme të mundshme në realizimin e efekteve shoqërore kualitative. Disa nga industritë kanë pjesëmarrje më të lartë e disa më të ulët në bruto produktin vendor, prandaj krijohet një pasqyrë nga efektet e tilla në bazë të së cilës merren vendime strategjike se cilave degë industriale duhet dhënë prioritet në zhvillimin afatgjatë ekonomik. Duke pasur parasysh se sa kompleks është procesi i zhvillimit, në të cilin ndikojnë shumë faktorë, qoftë individualisht apo në mënyrë grupore, duhet të identifikohen efektet e turizmit si industri në zhvillimin e vendit, por edhe të përcaktohen treguesit që pasqyrojnë jetë gjatësinë e turizmit si mbështetës i zhvillimit të vendit. Gjithashtu duhet të tregohet agragatët makroekonomikë si bruto produkti, eksporti, importi, sa do të ndikojnë në kuantitetin dhe kualitetin e strukturës

=====

ekonomike të vendit . Me krijimin e staregjisë bëhet adaptimi dhe ristrukturimi ekonomik i degëve të veçanta ekonomike me qëllim të realizimit të strukurës ekonomike efikase dhe të gjërë, duke premtuar për zhvillimin e gjeneratave të ardhshme, për punësimin e tyre dhe standardin e lartë.

Duke pasur parasysh kompleksitetin e procesit të zhvillimit, është me rëndësi që në nivel global të ngritet vetëdija për rëndësinë e turizmit, të kuptohet kompleksiteti i turizmit, efektet e tij, rrugët e zhvillimit, të analizohet aplikimi i koncepteve menaxhuese më bashkohore dhe në veçanti koncepti i menaxhimit strategjik integral në menaxhimin e turizmit, si në vendet e zhvilluara ashtu edhe në vendet e pazhvilluara siq është edhe Kosova!

Gjithashtu, në nivel lokal është me rëndësi të kuptohet, procesi i planifikimit turistik, nevoja për mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të ambientit, respektimi i sistemit të vlerave, pasi që modelet e planifikimit në turizëm nuk mund të vështrohen si të izoluara nga jeta e njerëzve. Prandaj, është e rëndësishme që të respektohen karakteristikat e të gjitha lokaliteteve me potenciale turistike dhe zhvillimi i tyre të konceptohet në bazë të resurseve specifike të tyre.

Arsyet orijentohen në pasqyrimin e efekteve të turizmit në zhvillimin e Kosovës, me çka mund të tregohet shfrytëzimi praktik dhe rruga për gjetjen e zgjidhjeve jo standarde për problemet gjatë fazes së zhvillimit.

Në krijimin e strategjisë, problemi qëndron në faktin se sa detalisht mund të analizohen mundësitë për zhvillimin e Kosovës si destinacion turistik. Ky problem mund të bëhet edhe më i ndërlikuar duke marrë parasysh se të gjitha degët tjera ekonomike gjenden në vështirësi të mëdha, kur papunësia është shumë e shprehur dhe kur produktiviteti në punë është shumë i ulët.

Përfundim

Disa nga çështjet themelore në të cilat duhet të bazohet planifikimi strategjik për zhvillimin e turizmit në Kosovë janë: stabiliteti makroekonomik, nxitja e zhvillimit ekonomik, dhe ulja e nivelit të papunësisë. Ndërsa elementet kryesore në të cilat do të bazoheshin matjet e zhvillimit të turizmit, e të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik janë: efektet direkte të krijuara nga qarkullimi i turistëve dhe shpenzimet e tyre, efektet indirekte të krijuara nga shpenzimet përmes të cilave plotësohen kërkesat turistike, dhe nga efektet e stimuluar të cilat shprehen përmes shpenzimeve të cilat krijohen nga banorët vendës të cilët kontribuojnë në zhvillimin e ofertës turistike.

Literatura

1. Burns P., Novelli M. **Tourism development** (2008) British library, London, UK
2. Bouncken R, Pyo S. **Knowledge Management in Hospitality and Tourism** (2002) The Journal of Quality Assurance in Hospitality&Tourism, Volume 3

3. Hara T. **Quantitative tourism industry analysis** (2008) Elsevier, Oxford, UK
4. Jafari J. **Encyclopedia of tourism**, (2000) Routledge, London, UK

KUD 811.18'373.4

FJALA SHQIPE NË VEND TË FJALËS SË HUAJ

Dr. Xhavit Aliçkaj, prof. ass.

Abstrakt

Duke u mbështetur në shkrimet e përditshme gazetareske, në shkrime të ndryshme që kanë karakter studimor dhe në fjalimet, bisedat, intervistat e intelektualëve të profesioneve të ndryshme, vërejmë dukurinë e përdorimi të një numri të madh të fjalëve të huaja, të cilat e dëmtojnë gjuhën shqipe, dhe të cilat kanë mundësi të zëvendësohen me fjalë të burimit shqip.

Në këtë punim po japim një fjalorth të fjalëve të huaja që hasen më së shpeshti dhe fjalët me kuptim shqip që mund të përdoren në vend të tyre.

Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj

Me gjithë të dhënë historike se gjuhët ndikohen prej njëra-tjetrës, pra marrin dhe japin, me gjithë faktin se gjuha shqipe e nënshruar shtresimeve të gjuhëve të pushtuesve të shumtë e të gjatë në këto troje dhe me gjithë faktin tjetër se terminologjia e shpikjeve të ndryshme depërton bashkë me mjetin e shpikur kemi obligim shkencor, kombëtar e moral që ta ruajmë gjuhën tonë nga invadimi (pushtimi) i fjalëve të huaja, sidomos në ditët tona.

Po të ndalemi në historikun e gjuhës shqipe nëpër periudha të ndryshme, po t'i shikojmë përpjekjet e gjuhëtarëve, intelektualëve dhe mësuesve (edhe atyre fetarë) se ç'kanë bërë e ç'kanë rrezikuar për ta ruajtur dhe mësuar gjuhën shqipe dhe kanë ruajtur ndër shekuj, që është sa befasi e madhe aq edhe meritë e tyre, kur dihet me çfarë pushtuesish kanë pasur të bëjnë, atëherë në ditëton tona mbetet ta duam, ta mësojmë, ta begatojmë me forma të ndryshme dhe ta ruajmë nga përdorimi gjithnjë e më i madh i fjalëve të huaja.

Në rastet kur kemi mundësi ta përdorim fjalën shqipe, kur gjuha jonë ka përparuar dhe është begatuar me fjalë të reja dhe ka ende mundësi të gjejmë nga burimi autokton yni, t'u shmangemi fjalëve të huaja, të cilat e lëndojnë, e varfërojnë, e rëndojnë gjuhën tonë të bukur dhe i bëhen si mish i egër në trungun e gjuhës.

Më duket se është bërë modë dhe shprehi e një pjese intelektualësh të përporin fjalë të huaja për të treguar se dinë, se kanë kulturë evropiane ose ndonjëherë edhe me qëllim të errësimit të mendimeve.

Fjalë të tilla përdoren jo vetëm në fjalimet e politikanëve, shtypin e përditshëm, por edhe në shkrime shkencore të fushave të ndryshme studimore, të cilat përkundër faktit që kanë stilin e vet dhe leksikun profesional, duhet bërë përpjekje që të gjendet fjala shqipe e të përdoret në vend të fjalës së huaj.

Prandaj edhe në këtë punim , në këtë revistë shkencore-profesionale, ku dominojnë lëndët nga fusha e ekonomisë, biznesit dhe turizmit do t'i shënojmë fjalët e huaja, të cilat kanë mundësi të zëvendësohen me fjalë shqipe, ku edhe këta lëmenj e gjejnë veten. Tek e fundit gjuha shqipe është e kombit tonë; gjuhë e shkencës dhe gjuhë mësimore, kendej le t'u shërbejë të gjithëve si një kulturë më e begatë gjuhësore.

Për këtë arsye edhe lënda Shkrimi akademik duhet të ketë si parim kujdesin në përdorimin e fjalëve të huaja, të cilat, siç e cekëm, jo vetëm e dëmtojnë gjuhën tonë, por e bëjnë të pakuptueshme.

Pavarësisht nga fushat studimore dhe fjalori specifik i tyre, duhet bërë përpjekje për gjetjen e fjalës shqipe, kur ka mundësi. Për këtë duhet komentuar fjalori i gjuhës shqipe, fjalori i fjalëve të huaja dhe fjalorë terminologjikë të shkencave të ndryshme. Tani këtu po jepim një fjalor të vogël të fjalëve të huaja që mund të zëvendësohen me fjalë shqipe :

	A	
abonoj	=	pajtoj
abuzoj	=	shpërdoroj
abandonim	=	braktisje
adaptoj	=	përshtat
adaptim	=	birëzim
aderoj	=	i bashkohem
abnegacion	=	vetëmohim
abrogim	=	shfuqizim, shlyerje, heqje
adash	=	emnak
afeksion	=	përmallim, përzemërsi
aglutinim	=	përngjitje
akoma	=	ende
aksident	=	fatkeqësi
akomodim	=	rregullim, përshtatje
alternancë	=	këmbim
ambient	=	mjedis
ambientohem	=	mësohem, përshtatem
anomali	=	parregullsi
aparencë	=	dukje, pamje e jashtme
aproksimativ	=	synim, dëshirë
asete	=	pasuri, pronë
auditiv	=	dëgjimor
avansim	=	përparim

	B	
barrierë	=	pengesë
bile	=	madje

brefing	=	konferencë shtypi
bord	=	këshill, komision
brutal	=	i ashpër, i vrazhdë

C

cedin	=	tërheqje, lëshim
-------	---	------------------

D

dakord	=	pajtohem, pranoj, jemi të një mendimi
decidoj	=	vendos
dedikoj	=	i kushtoj, kushtone
deformim	=	shformim
degjenerim	=	zvetnim
dekadencë	=	rënie
dekompozoj	=	shpërbërje
destinacion	=	drejtim, vendarritje
devijim	=	shmangie
deziluzion	=	zhgënjnim
decidiv	=	i vendsour
determinim	=	përcaktim
devotshmëri	=	përkushtim
denoncim	=	kallëzim
diferencë	=	dallim

F

filantrop	=	bëmirës
frakturë	=	thyerje
fertilitet	=	pjellshmëri
fiksim	=	ngulitje
fiasko	=	dështim
fiskal	=	tatimor
fidbek	=	prapaveprim, reagim
flesh	=	shkurt (lajme të shkurta)
frustrim	=	mashttrim, zhgënjim
funebër	=	mortor, përmotshëm

G

grimasë	=	ngërdheshje
---------	---	-------------

glosar	=	fjalës
grant	=	dhuratë, bursë, ndihmë, financë

I

i spostuar	=	i zhvendosur
iluzor	=	i rremë, i kotë
impotent	=	i pafuqishëm, i kapitur
indinjatë	=	zemërim
inkorporim	=	përfshirje, mishërim
insuficiencë	=	pamjaftueshmëri
intencë	=	synim, qëllim
interferim	=	ndërveprim, ndërmjetësim
involvim	=	përzierje
irrelevant	=	i parëndësishëm
itinerar	=	rrugëtim
impenjim	=	përkushtim

D

difensiv	=	mbrojtje e fortë
dislokim	=	zhvendosje (trupash)
disproporcion	=	shpërpjesëtim
distancë	=	largësi
divorc	=	ndarje
divulгим	=	popullarizim
divergjencë	=	mosmarrëveshje
dopio	=	dyfish
draft	=	plan, skicë, projekt

E

ofiçencë	=	gatishmëri, gjendje pune
eklatant	=	i famshëm, i shkëlqyeshëm
ekskluziv	=	i veçantë
eksplіcit	=	i dobishëm, i qartë
ekuivok	=	i dykuptimshëm
ekzagjerim	=	zmadhim, tepri në diçka
ekzigjencë	=	kërkim, nevojë
enorme	=	e parregullt, e jashtëzakonshme
eskalim	=	shkallëzim, përshkallëzim
eveniment	=	ndodhi, ngjarje e rëndë
ekstradim	=	dorëzim

evitim	=	shmangie
eksploatim	=	shfrytëzim
ekuivalent	=	barasvlerë

I

investigoj	=	hetoj
ilaritet	=	të qeshura, me tallje
interceptoj	=	kap, ndërkap
impozant	=	madhështor, hijerëndë
impakt	=	efekt, përplasje
inJORANCë	=	padituri, pa dije

K

kakofoni	=	keqtingëllim
kauzë	=	çështje
kauzal	=	shkakor
kapricipoz	=	tekanjor, njeri me teke
koincidencë	=	përkim, përputhje
konciz	=	i ngjeshur, i thukët
konfidencë	=	mirëbesim
konform	=	në pajtim me , në përputhje me
konsulent	=	këshillues
komponent	=	përbërës
kredibilitet	=	besueshmëri
kompeticion	=	garë
konfondim	=	ngatërrim (i gjërave)
konsensus	=	bashkëpëlqim
kolandim	=	pranim, vërtetim
kolumne	=	rubrikë, shtyllë në gazetë
krucial	=	vendimtar, i ashpër
konstituiv	=	i vazhdueshëm
koshient	=	i ndërgjegjshëm
kredibil	=	i besueshëm
kurent	=	bashkëkohor

L

lider	=	prijës, udhëheqës
leadership	=	kreu, udhëheqësi
lansoj	=	hedh në qarkullim

M

meskim	=	shpirtvogël
megaloman	=	mendjemadh
mocion	=	propozim
mediator	=	ndërmjetës

N

neglizhencë	=	mospërfillje, pakujdesi
nominim	=	emërim

O

oficial	=	zyrtar
opcion	=	zgjedhje
panel	=	trup gjykues, juri
patronazh	=	përkujdesje
penetrim	=	depërtim
perfid	=	dhëlpërak, i pabesë
permanent	=	i përhershëm
performancë	=	kryerje, përfundim i një pune
pragmatik	=	praktik
precedencë	=	përparësi
prestigjioz	=	me cilësi të larta
profanim	=	përdhosje, poshtërim
prolongim	=	zgjatje, zvarritje
prononcim	=	shprehje, deklaram
provizor	=	i përkohshëm
promocion	=	gradim, ngritje në post

R

relaksim	=	çlodhje, pushim
revidim	=	rishqyrtim

S

satisfkaksion	=	kënaqësi, shpagim
spostim	=	zhvendosje
slogan	=	parullë, frazë

solucion	=	sqarim, zgjidhje
sondazh	=	vëzhgim
sublim	=	i madhërishëm

T

tender	=	ofertë, konkurs
trend	=	drejtim, synim
tretman	=	trajnim
triumf	=	ngadhnjim
turbulencë	=	rrëmujë
tutelë	=	kujdeestari (për fëmijë)

V

valid	=	i vlefshëm
versnik	=	moshatar
violencë	=	dhunë
viadukt	=	mbikalim
verdikt	=	vendim

XH

xhentil	=	i sjellshëm
---------	---	-------------

Përfundim

Me shënimin e këtyre fjalëve që përdoren pa nevojë në shkrimet e përditshme ua kemi ofruar një mundësi të mirë të gjithë atyre që do t'i lexojnë, që t'u shmangen sa të kenë mundësi dhe të flasin e të shkruajnë shqip. Mendojmë se kemi fjalë të mjaftueshme që t'i përdorim qoftë në shkrime të lira, gazetareske, po edhe shkencore.

Literatura

1. ASHA e RSH, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Për Pastërtinë e Gjuhës Shqipe, Tiranë 1998
2. Kryeziu, Dr.Bahtijar. Si të flasin e të shkruajmë drejt, libri shkollor, Prishtinë, 2006
3. Murati, Dr.Qemal, Gjuha e mediave, IA.,Prishtinë.2008
4. Shkurtaç, Gjovalin. Si të shkruajmë shqip. Toena, Tiranë 2008

Botues / Izdovac / Editor

Universiteti i Prishtinës

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara të Biznesit – Pejë

ADMINISTRIM BIZNESI

Revistë shkencore shoqërore – ekonomike

KUD 65:338

Nr. 2

ADMINISTRIRANJE BIZNISA

Ekonomsko – društvena znanstvena revija

KUD 65:338

Br. 2

BUSINESS ADMINISTRATION

Economic and Social Scientific Journal

KUD 65:338

Vol. 2

Botimin e kësaj reviste e mundësoi Z Mobile nga Devolli Group



E drejta autoriale mbrohet në bazë të ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës.

=====